
BULETIN INFORMATIV

Korrik 2024

AKADEMIA E SHKENCAVE
E SHQIPËRISË



**Buletin mujor i aktiviteteve të Akademisë së
Shkencave të Shqipërisë**

Korrik, 2024

Përmbajtje

Në kujtim të Akademikut Ismail Kadare.....	6
Njoftim: Ndahet nga jeta në moshën 88-vjeçare shkrimtari, më i shquar shqiptar dhe akademiku Ismail Kadare	7
Nekrologji: Ndahet nga jeta në moshën 88-vjeçare shkrimtari dhe akademiku Ismail Kadare.....	14
Lamtumirë Ismail Kadare! - nga e gjithë bota akademike!	17
Kadareja - busull e përcaktimit europian të Shqipërisë, orifeu i përkatësisë europiane të popullit shqiptar	22
Vepra e Kadaresë do të jetë "buka jonë e përditshme", dhe për këtë do t'i jemi gjithnjë mirënjohës	25
Vepra e Kadaresë ka zgjeruar dhe riformtuar përmasat e munguara të lirisë individuale të çdo shqiptari	28
Fjala e znj. Evis Kushi, zëvendëskryetare e komisionit parlamentar për edukimin dhe mjetet e informimit publik, sot në akademinë solemne në sallën.....	32
Shkrimtari franko-shqiptar u largua prej nesh!	35
Lamtumirë Mjeshtër i dashur, mik i shtrenjtë i Arbëreshëvet!.....	38
Një lamtumirë për Kadarenë nga arbëreshët	40
"Një penë kundër bunkerëve"	42
Vepra e Ismail Kadaresë, reagime nga akademikë dhe studiues.....	50
Sot për Kadarenë, nga Università degli Studi di Palermo	54
La scomparsa dello scrittore Ismail Kadare: un grande vuoto nella letteratura mondiale, nel mondo albanese e nella memoria degli italo-albanesi.....	56
Akademik Dragan K. Vukčević, Kryetar Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Malit të Zi, letër ngushëlluese Kryetarit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Skënder Gjinushit, Kryesisë së ASHSH dhe familjes së shkrimtarit Ismail Kadare	58

Projektet e Albanologjisë / Enciklopedia shqiptare.....	59
“Enciklopedia shqiptare”: gjendja e sotme e punës për përgatitjen dhe dorëzimin e fjalësit (deri në fund të muajit qershor) përmes të dhënave të raportuara nga redaksitë e fushave	60
Mbledhje e redaksisë qendrore të "Enciklopedisë shqiptare"	63
Redaksia e gjuhësisë (Tiranë) dhe redaksia e albanologjisë (Prishtinë) miratojnë fjalësin e përbashkët të fushës për "Enciklopedinë shqiptare"	65
Gati fjalësi i njësuar i redaksive të arkeologjisë dhe lashtësisë: bashkëpunim i suksesshëm i arkeologëve në Tiranë e në Prishtinë	67
Redaksia e ekonomisë, financave dhe tregtisë bashkëbisedim me specialistë të fushave që mbulon.....	70
Redaksitë e gjuhësisë, letërsisë dhe arsimit bashkëvendosin për njësitë enciklopedike në kufi të njëra-tjetrës.....	73
Projekti “Fjalori i madh i shqipes”	75
“Fjalori i madh i shqipes” dorëzohet si vepër tërësore për redaktim deri në fund të muajit gusht.....	76
Takim pune në Institutin Albanologjik të Prishtinës për “Fjalorin e madh të shqipes”	78
Komisionet e përhershme pranë Akademisë së Shkencave	79
U mbajt mbledhja e parë e komisionit të përhershëm të arteve pranë Akademisë së Shkencave.....	80
Aktivitete	83
Përkujtohet 580-vjetori i betejës së Torviollit	84
U zhvillua simpoziumi “Monumentet e natyrës së Shqipërisë dhe vlerat e tyre natyrore, historike, kulturore, shpirtërore dhe turistike”	85
Në Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës u zhvillua konferenca shkencore e përbashkët me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë “Zhvillimi i konstitucionalizmit shqiptar 1912-2024”	98
Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë zhvilloi tryezën shkencore: “Kahe, koncepte dhe metodologji në semantikën gjuhësore - pikëvështrime të sotme”	103
“Kërkimi shkencor në ndihmë të zhvillimit të agroturizmit në Shqipëri” dhe “Ekspozitë pomologjike autoktone”	106

U mbajt ligjërata “Krijuesit e ndaluar në artet pamore: Edison Gjergo (1939-1989) dhe koha e tij” me studiuesen e artit Suzana Varvarica-Kuka.....	112
“Vendbanimet e bashkisë së Korçës: probleme dhe zgjidhje”	118
Kërkimet arkeologjike në vendbanimin neolitik "Lin 3" rikonfirmojnë hershmërinë e tij: më i vjetri në llojin e tij	120
Marrëveshje bashkëpunimi	123
Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Shërbimit Gjeologjik Shqiptar	124
Vlerësime.....	126
Akademia e Shkencave e Shqipërisë uron sopranon shqiptare Ermonela Jaho me famë botërore, anëtare e jashtme e saj, për dekorimin me medaljen “Kalorës i Urdhrit të Arteve dhe Letrave” në Francë.....	127
Botime të reja	128
"Studime antropologjike në etnokulturë" nga Shaban Sinani, botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë 2024	129
"Publicistë të Rilindjes", nga prof. Hamit Boriçi - shtohet një botim tjetër i rëndësishëm në dobi të "Enciklopedisë shqiptare"	132
“Nga religjioni tek letërsia”, për librin e Shaban Sinanit “ Antropologji e religjionit”	133
In memoriam.....	138
Për kryetarin historik të Akademisë së Shkencave prof. Aleks Buda: in memoriam.....	139

**Në kujtim të Akademikut Ismail
Kadare**

Njoftim: Ndahet nga jeta në moshën 88-vjeçare shkrimtari, më i shquar shqiptar dhe akademiku Ismail Kadare



Me pikëllim të thellë në zemër njoftojmë ikjen pa kthim të prijësit historik të letërsisë shqipe prej më shumë se shtatë dekadash; anëtarit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë; anëtarit të Akademisë së Shkencave Morale dhe Politike të Francës; anëtarit të jashtëm të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, anëtarit të jashtëm të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Malit të Zi; fituesit të çmimeve letrare më të rëndësishme në Europë e në Botë ("International Booker Man Prize", "Prince of Asturias Award", "Jerusalem Prize", "Neustadt International Prize", "Nonino", "Park Kyong-ni"); personalitetit që u nderua me mirënjohjet më prestigjioze në Shqipëri e jashtë vendit, në të gjitha kontinentet, shkrimtarit Ismail Kadare; mikut tonë të pazëvendësueshëm, akademikut që i e mbushi me kuptim këtë titull të lartë, me veprën e të cilit u rritën dhe u formuan dhjetëra breza në Shqipëri e kudo që flitet gjuha shqipe.

Ismail Kadare u lind në Gjirokastrë më 28 janar 1936. Qyteti i lindjes e ndoqi përjetësisht kudo që ai jetoi e shkroi, në Perëndim e në Lindje, duke u bërë pjesë e pandashme e krijimtarisë së tij në të gjitha fazat e jetës. Me një opus letrar që përmban mbi 70 vepra, në të gjitha llojet e nënlojet e letërsisë, eseistikës dhe publicistikës, të

panumërta në botime ribotime, Ismail Kadare ka zënë e do të ketë kryet e vendit në historinë e letërsisë shqipe.

Ikja e tij është e pangushëllueshme për Akademinë e Shkencave, për letërsinë shqipe dhe ekuilibret e saj, për gjuhën shqipe dhe folësit e saj, për letërsinë europiane e botërore. Letërsisë shqipe do t'i mungojë kryemjeshtri, letërsisë europiane do t'i mungojë fizikisht zëdhënësi i një kombi e një rajoni; qytetërimit tonë do t'i mungojë shqiptuesi i kumteve të mëdha.

Ismail Kadare është shkrimtari më i rëndësishëm i letërsisë shqipe që prej fillimeve dhe përgjatë pesë shekujve të jetës së saj. Vepra e tij përbën një shtyllë të letërsisë shqipe. Letërsia e I. Kadaresë e ka ndërkombëtarizuar kulturën shqiptare në shkallë europiane e botërore. Gjuhët me të cilat ka folur letërsia e tij janë mbi 50 dhe numri i titujve të botuar e ribotuar jashtë gjuhës amtare është mbi 1500. Vepra e tij studiohet në universitete në kuadër të historisë së letërsisë europiane dhe të asaj botërore. Shkencës së albanologjisë tashmë i është shtuar një degë e re, ajo e kadareologëve, e studiuesve dhe përkthyesve të veprës së tij. Nën ndikimin e kësaj dege të re edhe vendi i gjuhës shqipe në universitete është rritur, me hapjen e katedrave dhe njësive të reja që nga Japonia në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që nga Franca në Rusi. Sot vepra e Kadaresë përkthehet e studiohet edhe në ndonjë vend ku ka pasur kufizime.

Ismail Kadare do të mbetet një autoritet moral për popullin shqiptar, një institucion krijimi dhe mendimi, një referencë themelore për jetën e tij. Vepra që ai ka krijuar është e lidhur me çështje thelbësore të botëkuptimit shqiptar e ballkanas, të ndërveprimit të kulturave dhe vlerave qytetare të rajonit, të evoluimit të identiteteve historike e kulturore. Ajo është një dritare e rëndësishme parësore për të njohur edhe psikozat dhe kompleksat e popujve të Europës Juglindore, aspiratat e vërteta të tyre.

Akademia e Shkencave u shpreh ngushëllimet e veta në këtë çast të rëndë familjes së shkrimtarit Ismail Kadare, studiuesve e lexuesve të panumërt të veprës së tij, bashkësisë akademike e botës universitare, përkthyesve e shqipëruessve kudo në Botë.

Emri dhe vepra e tij do të jenë përjetësisht të pranishme në jetën e shqiptarëve dhe të gjithë Botës.

Tiranë, 1 korrik 2024

<https://www.lemonde.fr/.../ismail-kadare-le-grand...>

<https://www.washingtonpost.com/.../08e7bbfa-3781-11ef...>

<https://www.barrons.com/.../ismail-kadare-a-bright-light...>

www.akad.gov.al

Jetëshkrim letrar i Ismail Kadaresë

Ismail Kadare ka lindur më 28 janar të vitit 1936 në Gjirokastrë. Është personalitet qendror i kulturës shqiptare në gjysmën e dytë të shekullit të 20-të,

protagonist i zhvillimeve më të përparuara në letërsinë shqipe gjatë kësaj periudhe.

Ka kryer studimet e shkollës së mesme në vendlindje. Është diplomuar për gjuhë dhe letërsi shqipe në Universitetin e Tiranës në vitin 1956. Ka studiuar për disa vjet në Institutin "Gorki" në Moskë, por u detyrua t'i ndërpriste studimet për shkak të konfliktit ideologjik në marrëdhëniet shqiptaro-sovjetike. Ndërsa kryente studimet në "Gorki", botoi në rusisht vëllimin poetik me titullin "Lirika", në parathënien e të cilit botuesi Samoilov paralajmëron se autori rrezikohet prej ndikimit të poezisë dekadente perëndimore.

Fillimet letrare të Ismail Kadaresë janë kryesisht në poezi ("Frymëzime djaloshare" - 1954; "Ëndërrimet" - 1957; "Shekulli im" - 1961; "Lirika" - Moskë 1961; "Përse mendohen këto male" - 1964; "Motive me diell" - 1968; "Koha" - 1976). Me kohë proza u bë krijimtari e tij përparësore.

Me emrin e Ismail Kadaresë njësohet ardhja në letërsi e "brezit të viteve 1960", që e udhëhoqi kulturën kombëtare drejt një emancipimi të përgjithshëm. Ismail Kadare dhe shkrimtarë të tjerë të "brezit të viteve 1960" u ndanë prej "të vjetërve" duke ndryshuar rrënjësisht vjershërimin tradicional, në shqetësime, në problematikë dhe në teknikën e të shkruarit. Poezia e Ismail Kadaresë u mbështet në vlerat më të arrira të vjershërimit në varg të lirë (De Rada, Migjeni). Me këtë poezi ndryshoi paradigma e trashëguar e tematikës dhe e mjeteve të shprehjes të letërsisë. Ismail Kadare i dha vlerë poetike fjalorit bashkëkohor të shqipes, leksikut të periudhës industriale. Poezia e tij e ndau vjershërimin shqip prej analitizmit dhe përshkrimit. Sintetizmi dhe fuqia abstraktuese në këtë poezi marrin rolin parësor ndaj retorizmit dhe subjektit, duke refuzuar letërsinë brohoritëse dhe duke ndërlidhur të përgjithshmen dhe individualen.

Ismail Kadare shkroi poezinë e mendimit dhe të ideve. Ismail Kadare ia kushtoi poezinë e tij fatit historik të popullit shqiptar. Ai trajtoi mbijetesën e popullit në sfidat e mëdha të historisë. Shkroi poezi kryesisht epiko-lirike. Ai e vështron të shkuarën jo vetëm si histori qëndrese, por si histori mbijetese të gjuhës, kulturës dhe qytetërimit shqiptar, duke nxitur te bashkëkohësit mendimin se vlerat shqiptare vijnë nga thellësi të largëta të lashtësisë. Poezia e Ismail Kadaresë, ndryshe nga proza e tij, herë-herë paraqitet më e angazhuar politikisht dhe si rregull ka frymë hyjnizuese për etnotipin shqiptar. Kjo mund të jetë arsyeja që, me ndonjë përjashtim ("Në mesditë Byroja Politike u mblodh", 1975) krijimtarinë e Ismail Kadaresë në poezi pak e ka ndjekur mbikëqyrja politike e kohës.

Vepra e parë e rëndësishme e Ismail Kadaresë në prozë është romani "Qyteti pa reklama", vepër që mbeti e pabotuar deri në vitin 2003, duke qenë se në kohën që u shkrua, u arrit të botohej vetëm fragmenti "Ditë kafenesh", në gazetën "Zëri i Rinisë" (1962). "Gjenerali i ushtrisë së vdekur" (1963) përbën veprën e konfirmimit të talentit të Ismail Kadaresë në prozën moderne dhe një pikë kthese në historinë e letërsisë shqipe.

Prej fillimeve deri në periudhën e pjekurisë, në prozën e tij raporti themelor është gjithnjë vetja dhe tjetri, identiteti i shqiptarëve dhe qëndrimi i tyre ndaj të ndryshmit: armikut, pushtuesit, kundërshtarit, fqinjit.

“Gjenerali i ushtrisë së vdekur” është romani i parë në letërsinë e re të Shqipërisë, në të cilën lufta antifashiste u trajtua me largësi kohore dhe emocionale, duke vënë paralele midis së shkuarës dhe momentit historik. Në këtë roman dhe në një varg veprash të tjera të Ismail Kadaresë vendin qendror e zë raporti ndërmjet jetës dhe vdekjes, si shqetësim i përvetshëm i letërsisë. Varri dhe hija (sozia, fantazma) janë fjalë-çelës për të lexuar një pjesë të madhe të kësaj letërsie: “Prilli i thyer”, “Kamarja e turpit”, “Pashallëqet e mëdha”, “Muzgu i perëndive të stepës”(1978), “Vit i mbrapshtë”, “Shkaba”, “Spiritus”, “Hija”, “Pasardhësi”.

Vlerat e jetës dhe çmimi i vdekjes, varrimi dhe zhvarrimi, muranat dhe varret monumentale-piramidale, ringjallja dhe rivdekja (rivrasja) janë nocione themelore artistike në prozën e Ismail Kadaresë. Vdekja shfaqet në këtë vepër në format më të pangjashme: natyrore dhe e dhunshme, vetjake dhe e gjithë bashkësisë, e vërtetë dhe e sajuar, nga fati dhe nga hakmarrja, nga lufta dhe gjyqi, nga sëmundja dhe plakja, si ndëshkim dhe si shpëtim për jetën e tjetrit. Novela “Kush e solli Doruntinën” (1979), për të cilën u zhvillua një diskutim i gjatë në shtypin letrar të kohës, u kujtoi bashkëvendësve ringjalljen, rilindjen, atë vlerë që gjendej në baladat e hershme të tyre dhe që mbante shenjë të humanizmit të Rilindjes Europiane, atë vlerë që krishtërimi ia kishte njohur përjashtimisht Mesisë.

Romani “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” (1963) ka luajtur një rol vendimtar në fatin e letërsisë së Ismail Kadaresë. Me botimin në Francë (1971) të këtij romani ndryshoi horizonti i pritjes jo vetëm i artit të tij, por edhe i pjesës më të talentuar të letërsisë shqipe të kohës. Për herë të parë pas shumë shekujsh, qysh prej Marin Barletit, letërsia shqipe fillon të rifitojë përmasën e vet të merituar ndërkombëtare.

“Përbindëshi” (1965), romani i dytë i Ismail Kadaresë, u botua në revistën letrare “Nëntori” dhe menjëherë u ndalua, për shkak të gjendjes së ankthit që kishte në përmbajtje, të shthurjes kompozicionale, sidomos të përdorimit subjektiv të përmasës së kohës. Romani arriti të botohej i plotë vetëm pas afro një çerek shekulli, në fundin e viteve 1980.

“Kronikë në gur” (1971) është romani i dytë i Ismail Kadaresë që trajton temën e luftës antifashiste, duke iu shmangur pranimit të saj si objekt i drejtpërdrejtë dhe me nota të qarta të një frymëzimi autobiografik. Lufta e interpretuar me sytë e një fëmije i jep mundësi autorit ta shohë atë të shtendosur, me një vështrim "nga poshtë". Në vepër nuk ka rreshtime kundërshtuese luftarake dhe as frymë heroike manifestative. Është një roman në të cilin lufta shihet gati-gati si një lojë, në të cilën komunistët dhe ballistët shfaqen si në role, si në një teatër. Romani është qortuar nga kritika e kohës për ndikime

të surrelizmit dhe të psikanalizës.

Romani “Kështjella” fitoi çmimin e parë në konkursin letrar për 500-vjetorin e vdekjes së Gjergj Kastriotit dhe u botua dy vjet më vonë (1971). Në studimet letrare është quajtur “roman historik”, por dhe “roman i heroit të papranishëm”. Ndonëse gjithë vepra i kushtohet qëndresës shqiptare në fillimet e pushtimit osman, figura e kryeheroit, Gjergj Kastriotit, nuk shfaqet drejtpërsëdrejti. Autori arrin të ngrrejë në këtë roman kultin e bashkësisë në vend të kultit të heroit ose të personalitetit. Romanet e Ismail Kadaresë me temë nga historia të shkuarën e kanë kryesisht si një shkas për të sotmen. Historia përthirret në romanet e tij si një pretekst. Në thelbin e vet romani “Kështjella” nuk mund të receptohet pa pasur në vëmendje dy ngjarje që ndodhën në botën shqiptare dhe në botën e madhe në kohën kur u shkrua dhe u botua kjo vepër. Kjo është koha kur Shqipëria politike vendosi të dalë nga Traktati i Varshavës dhe të shumë intelektualë lindi shpresa e një riorientimi politik properëndimor të vendit. Por njëherësh kjo është koha e pushtimit të Çekosllovakisë prej ushtrive sovjetike. Në rrafshin sipërfaqësor romani i Ismail Kadaresë është një homazh për qëndresën arbërore si qëndresë e një qytetërimi ndaj barbarisë së huaj.

Në rrafshin përmbajtësor romani përmban raportet e një shteti të pushtuar prej një perandorie të re, moderne, sikurse ishte ish-kampi komunist. Në këtë lexim “Kështjella” paraqitet si paradoksi i një rrethimi. Paradoksi qëndron në faktin që kështjellarët, të rrethuarit, përkundër asaj që pritej logjikisht, paraqiten më liberalë se rrethuesit.

Që prej botimit të kësaj vepre në prozën e Ismail Kadaresë zgjedhja midis urës dhe kështjellës, midis qëndresës dhe paqes, midis mbylljes dhe hapjes, duke qenë një nyje fatale tragjike që kishte përshkuar mendësinë e etnotipit shqiptar ndër shekuj, bëhet një temë qendrore. Ura dhe kështjella janë dy fjalë të tjera çelës për të mundësuar kuptimin e veprës së Ismail Kadaresë. Nocioni i kështjellës, si shenjë e mbylljes së vendit, është i pranishëm te “Prilli i thyer” (kulla e ngujimit); te “Krushqit janë të ngrirë”, te “Ndërtimi i piramidës së Keopsit”, te “Piramida”. Në të kundërtën, nocioni i urës gjendet tek “Ura me tri harqe”(1978), “Kush e solli Doruntinën”, “Jeta, loja dhe vdekja e Lul Mazrekut”, “Kushëriri i engjëjve”. Autori, duke e parë këtë dilemë si nyje qenësore të etnotipit shqiptar, parapëlqen të mos e injorojë historinë për aq sa mund të shërbejë si zëdhënëse idesh të reja. Ai ekzaltohet nga ura, nga hapja dhe komunikimi, nga miqësitë e largëta të bujarisë së hershme nëpër Europë, por po aq tronditet prej dhembjeve që u ka sjellë shqiptarëve “fati i urës”. Në thelb, dilema “një urë apo një kështjellë” përmban pyetjen thelbësore të epokës kur Ismail Kadare i shkroi këto vepra.

Me romanin “Dimri i vetmisë së madhe” (1973) Ismail Kadare filloi botimin e një trilogjie, në përbërje të së cilës do të ishin tri përballjet e mëdha shqiptare të gjysmës së dytë të shekullit të njëzetë: me politikën nënshtruese të Beogradit (1948), me arrogancën

sovjetike (1961) dhe me mospajtimet ideologjike kineze (1978). Romani u kritikua për frymë deheroizuese, për ndikim të dekadencës perëndimore dhe mungesë perspektive. U botua i ripunuar në vitin 1977, për të hapur rrugën e romanit tjetër "Koncert në fund të dimrit", i cili pasi fitoi çmimin e parë në një konkurs kombëtar në vitin 1981, nuk u lejua të botohej për disa vjet me radhë, duke u konsideruar një vepër që përmban aluzione të hapura kundër sistemit komunist. "Dimri i madh" është quajtur "një roman me iso", kurse "Koncert në fund të dimrit", që është vazhdim i tij - "një roman polifonik". U botua në vitin 1987. Pjesa e tretë e trilogjisë, e cila nga pikëpamja e rendit kohor duhej të ishte e para, nuk u shkrua dhe nuk u botua kurrë. Romanet janë pasqyrime letrare të dy prej nyjeve më të rëndësishme të historisë së "luftës së ftohtë", në të cilën Shqipëria është subjekt parësor. Sipas kritikës ruse (N. Smirnova), Ismail Kadare "e ka metropolizuar" dhe "oksidantalizuar" Shqipërinë përballë sovjetikëve, duke e modernizuar atë si një shtet perëndimor.

"Nëpunësi i pallatit të ëndrrave" (1979) përfaqëson veprën më problematike dhe më mospajtuese të Ismail Kadaresë me realizmin socialist. Thelbi i romanit është alegoria politike anti-totalitariste, duke marrë shkas prej mënyrës së funksionimit të ish-perandorisë osmane. Romani u kritikua si vepër që dëmtonte socializmin, dhe seria e veprës së plotë në 12 vëllime e autorit u botua pa vëllimin e 11-të, ku duhej të gjendej kjo vepër. "Nëpunësi i pallatit të ëndrrave" njihet si vepër disidente. Në prozën e Ismail Kadaresë rrallë ndodh të respektohen bashkërisht parimet dhe kërkesat e realizmit socialist.

Përmes romaneve me pikënisje nga motivet e prozës popullore, kryesisht të baladave ("Ura me tri harqe" (1978), "Kush e solli Doruntinën" (1979), "Dosja H", "Emblema e dikurshme"), Ismail Kadare ringjalli në botën shqiptare një "Shqipëri tjetër", në të cilën ka elitë dhe aristokraci, ka kontë e princër, që çojnë e marrin kumte me Europën. Braktisja e temave aktuale paraqitet jo vetëm si një refuzim estetik, por në funksion të krijimit të imazhit të një Shqipërie europiane në të shkuarën. Në këtë cikël veprash fjalë-çelës për lehtësimin e të kuptuarit të tyre janë miti dhe realiteti. Ismail Kadare shkroi me sukses veprat në prozë "Viti i mbrapshtë", "Nata me hënë", "Vajza e Agamemnonit" dhe esenë studimore "Eskili, ky humbës i madh" (Tiranë, 1990). "Ftesë në studio" (Tiranë, 1990) konsiderohet vepra e fundit e tij e shkruar para largimit të tij nga Shqipëria.

Në vjeshtë të vitit 1990 Ismail Kadare vendosi të largohet nga Shqipëria dhe të qëndrojë në Paris. Shkrimtari në atë kohë e përlligji këtë largim me "mungesën e ndryshimeve demokratike". Autoritetet e kohës e dënuan largimin e Ismail Kadaresë, por krijimtaria e tij nuk u ndalua. Në vitet 1990 vepra e tij bëhet shprehja më e fuqishme e vlerave gjuhësore dhe letrare të shqipes së njësuar. Letërsia e Ismail Kadaresë pas viteve 1990 bart të njëjtat tipare thelbësore të asaj të mëparshme: frymën etnografike,

shpërfaqjen e identitetit shqiptar, duke përfshirë komplekset etnike dhe është e reflektuar dhe në botime si “Pesha e kryqit” (Paris, 1991); “Piramida”, botuar në variantin në gjuhën frënge në vitin 1992, me përkthim të Jusuf Vrionit. Veprat e Ismail Kadaresë janë përkthyer e botuar në rreth 50 gjuhë të huaja. Ai është shkrimtari shqiptar më i njohur në botë.

Ismail Kadare është laureat i shumë çmimeve letrare kombëtare dhe ndërkombëtare. Që nga viti 1994 Ismail Kadare është anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe anëtar i Akademisë së Shkencave Morale dhe Politike të Francës. Në vitin 2005 ai fitoi çmimin “The Booker Prize Man”.

Prej më shumë se 20 vjetësh ai është rregullisht i nominuar si kandidat për çmimin Nobel dhe disa herë i përzgjedhur në pretendentët e drejtpërdrejtë. Ismail Kadare mban titujt “Nderi i Kombit” (Shqipëri), “Kryqi i Legjionit të Nderit” dhe “Oficer i Legjionit të Nderit” (Francë), si dhe nderime e mirënjohje të tjera.

Nekrologji: Ndahet nga jeta në moshën 88-vjeçare shkrimtari dhe akademiku Ismail Kadare



Me pikëllim të thellë në zemër njoftojmë ikjen pa kthim të prijësit historik të letërsisë shqipe prej më shumë se shtatë dekadash; anëtarit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë; anëtarit të Akademisë së Shkencave Morale dhe Politike të Francës; anëtarit të jashtëm të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës; anëtarit të jashtëm të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Malit të Zi; fituesit të çmimeve letrare më të rëndësishme në Europë e në Botë (“International Booker Man Prize”, “Prince of Asturias Award”, “Jerusalem Prize”, “Neustadt International Prize”, “Nonino”, “Park Kyong-ni”); personalitetit që u nderua mirënjohjet më prestigjioze në Shqipëri e jashtë vendit, në të gjitha kontinentet; shkrimtarit Ismail Kadare, mikut tonë të pazëvendësueshëm, akademikut që e mbushi me kuptim dhe e lartësoi këtë titull të lartë, me veprën e të cilit u rritën e u formuan dhjetëra breza në Shqipëri e kudo që flitet

gjuha shqipe.

Ismail Kadare u lind në Gjirokastrë më 28 janar 1936. Qyteti i lindjes e ndoqi përjetësisht kudo që ai jetoi e shkroi, në Perëndim e në Lindje, duke u bërë pjesë e pandashme e krijimtarisë së tij në të gjitha fazat e jetës. Me një opus letrar që përmban mbi 70 vepra, në të gjitha llojet e nënlojet e letërsisë, eseistikës dhe publicistikës, të panumërta në botime e ribotime, Ismail Kadare ka zënë e do të ketë kryet e vendit në historinë e letërsisë shqipe.

Ismail Kadare është tashmë një figurë identiteti për popullin shqiptar, krahas figurave të tilla si Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, Ismail Qemali e Nënë Tereza. Largimi fizik i tij është pa dyshim humbja më e madhe e letërsisë shqipe; është një humbje e madhe e letërsisë europiane dhe të asaj botërore; humbje e rëndë për akademizmin shqiptar e europian. Ikja e tij është e pangushëllueshme për Akademinë e Shkencave, për letërsinë shqipe dhe ekuilibret e saj, për gjuhën shqipe dhe folësit e saj, për letërsinë europiane e botërore. Letërsisë shqipe do t'i mungojë kryemjeshtri, letërsisë europiane do t'i mungojë zëdhënësi i një kombi e një rajoni; qytetërimit tonë do t'i mungojë shqiptuesi i kumteve të mëdha.

Ismail Kadare është bërë pjesë e vetëdijes qytetare dhe morale të popullit shqiptar, program njohjeje për të huajt të botës së tij, përrues i vlerave më të larta krijuese të vendit të tij. Ai është shkrimtari më i rëndësishëm i letërsisë shqipe që prej fillimeve dhe përgjatë pesë shekujve të jetës së saj. Vepra e tij i ka kaluar me kohë kufijtë e Shqipërisë, të letërsisë dhe gjuhës shqipe, të botës shqiptare, dhe është bërë pjesë cilësore në trashëgiminë e letërsisë botërore.

Për dekada me radhë vepra e Kadaresë ishte burim informacionin për Botën lidhur me realitetin shqiptar krejt të mbyllur. Sot kjo vepër shërben si një pasaportë identiteti dhe si një histori alternative e popullit shqiptar përgjatë shekujve dhe sidomos në kohërat e reja. Njohës dhe interpretues i miteve dhe kodeve tradicionale, njohës i vlerave europiane po aq sa dhe i kufizimeve në të kuptuarit e njeriut shqiptar, ai dekodifikoi dhe i shërbeu "lexuesit tjetër" nyjat më të ndërlikuara të së shkuarës dhe së sotmes së popullit të vet. Shkroi në kushtet e kufizimeve të rrepta ideologjike, u bë dritare për të parë dhe program për të lexuar Perëndimin dhe për t'u njohur prej tij; u dha liri njerëzve kur nuk kishte liri; i provoi të gjitha fazat e raporteve kritike me pushtetet, prej entuziazmit e besimit futurist tek dyshimi, prej dyshimit tek kontestimi, prej kontestimit në refuzim e prej refuzimit në disidencë letrare, duke shkruar letërsi normale në kushte historike jonormale.

Letërsia e I. Kadaresë e ka ndërkombëtarizuar kulturën shqiptare në shkallë europiane e botërore. Gjuhët me të cilat ka folur letërsia e tij janë mbi 50 dhe numri i titujve të botuar e ribotuar jashtë gjuhës amtare është mbi 1500. Vepra e tij studiohet në universitete në kuadër të historisë së letërsisë europiane dhe të asaj botërore. Shkencës

së albanologjisë tashmë i është shtuar një degë e re, ajo e kadareologëve, e studiuesve dhe përkthyesve të veprës së tij. Nën ndikimin e kësaj dege të re edhe vendi i gjuhës shqipe në universitete është rritur, me hapjen e katedrave dhe njësive të reja, që nga Japonia në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që nga Franca në Rusi. Sot vepra e Kadaresë përkthehet e studiohet edhe në ndonjë vend ku ka pasur kufizime.

Vepra e Kadaresë prej vitesh dhe në vazhdimësi nderohet me çmimet më të larta që jepen për merita letrare, duke u dalluar në rang botëror edhe kundrejt veprave të shkruara në kushte lirie. Ai e ka fituar "garën" me shkrimtarët homologë në Botë, me letërsinë e shkruar në demokraci. Për këtë vepër fjalën e fundit e kanë thënë dhe e thonë lexuesit e kësaj vepre, që gjenden tashmë në të gjitha kontinentet, duke u shtuar vazhdimisht bashkë me shtimin e gjuhëve të përkthimit. Vepra e Kadaresë renditet tashmë krahas kryeveprave të pavdekshme të letërsisë botërore, që nuk njohin epokë, por bëjnë epokë.

Ismail Kadare është dhe do të mbetet një autoritet moral për popullin shqiptar, një institucion krijimi dhe mendimi, një referencë themelore për jetën e tij. Vepra që ai ka krijuar është e lidhur me çështje thelbësore të botëkuptimit shqiptar e ballkanas, të ndërveprimit të kulturave dhe vlerave qytetare të rajonit, të evoluimit të identiteteve historike e kulturore. Ajo është një dritare e rëndësishme parësore për të njohur edhe psikozat dhe kompleksat e popujve të Europës Juglindore, aspiratat e vërteta të tyre.

Letërsia e Kadaresë do të lexohet e vlerësohet në vazhdimësi, pasi mesazhet e veprës që ka krijuar, fuqia e fjalës dhe e mendimit të tij, e bëjnë këtë vepër gjithnjë të kohës dhe tërheqëse për lexuesit e saj.

Për Akademinë e Shkencave të Shqipërisë Kadare ka qenë dhe do të mbetet emblemë e saj, krahas vendit që ai ka zënë me plot meritë në shumë akademi dhe universitete brenda e jashtë vendit, ku është nderuar me titullin akademik "doctor honoris causa".

Akademia e Shkencave u shpreh ngushëllimet e veta në këtë çast të rëndë familjes së shkrimtarit Ismail Kadare: Helenës dhe dy vajzave, Gresës e Besianës; lexuesve e studiuesve të panumërt të veprës së tij; bashkësisë akademike e botës universitare; përkthyesve e shqipëruarëve kudo në Botë, miqve, admiruesve dhe simpatizantëve të veprës së tij.

Emri dhe vepra e Ismail Kadaresë do të jenë përjetësisht të pranishme në jetën e shqiptarëve dhe të gjithë Botës.

Pusho në paqe miku ynë!

Tiranë, 1 korrik 2024

<https://www.lemonde.fr/.../ismail-kadare-le-grand...>

<https://www.washingtonpost.com/.../08e7bbfa-3781-11ef...>

<https://www.barrons.com/.../ismail-kadare-a-bright-light...>

Lamtumirë Ismail Kadare! - nga e gjithë bota akademike!

- U zhvillua sot ceremoni solemne në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë për t'i dhënë lamtumirën shkrimtarit e akademikut Ismail Kadare



Në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë u organizua sot më 3 korrik 2024 ceremoni solemne për t'i dhënë lamtumirën në emër të gjithë botës akademike shqiptare shkrimtarit e akademikut Ismail Kadare; kryeakademikut për nga vlera e jehona e veprës së tij me famë ndërkombëtare.

Të pranishëm ishin akad. Skënder Gjinushi, Kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë; zëvendëskryetari akad. Vasil Tole; sekretari shkencor akad. Shaban Sinani, anëtarë të Kryesisë së Akademisë së Shkencave dhe trupa akademike.

Ishin të pranishëm gjithashtu zëvendëskryetarja e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës akad. Justina Shiroka-Pula; ambasadorja e Francës në Tiranë znj. Catherine Suard, miq dhe bashkëpunëtorë të shkrimtarit Ismail Kadare.

Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Skënder Gjinushi në fjalën e tij e vlerësoi shkrimtarin Ismail Kadare si busull të përcaktimit europian të Shqipërisë, korife të përkatësisë europiane të popullit shqiptar. Kadareja është figurë identitare e popullit shqiptar, krahas Skënderbeut, Ismail Qemalit e Nënë Terezës, - tha akad. Gjinushi.

Duke e vlerësuar veprën e Ismail Kadaresë si testament qytetërimi e identiteti, akad. Skënder Gjinushi tha se humbja fizike e Kadaresë është padyshim humbja më e madhe e letrave shqipe; është një humbje shumë e madhe e kulturës dhe letërsisë europiane e botërore, e akademizmit shqiptar e atij evropian. Vepra e Kadaresë i ka kaluar me kohë kufijtë e Shqipërisë, të botës shqiptare, dhe bën pjesë në patrimuanin e letërsisë botërore, tha akad. Gjinushi.

Në fund të fjalës së tij ai shprehu dhimbjen për këtë humbje të madhe, duke i përcjellë ngushëllimet familjes së akademikut Ismail Kadare e tërë komunitetit akademik; atij të letërsisë, kulturës e arteve; tërë inteligjencës shqiptare, për humbjen e ikonës së tyre, me premtimin se ne, si akademi shkencash, do të krenohemi gjithnjë që I. Kadare ka qenë anëtar i saj dhe që vepra e tij do të ruhet si një nga thesaret e kulturës sonë e të shkencave albanologjike, do t'u përcillet brezave si një testament qytetërimi e identiteti, si një pasuri e vyer kombëtare.



Nënkryetarja e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës Justina Shiroka-Pula në fjalën e lamtumirës në emër të kryesisë së kësaj akademie kujtoi se në vitin 1991 Kadare u zgjodh anëtar i jashtëm i ASHAK për kontributin e çmuar në fushën e letërsisë. Akad. Shiroka theksoi se shkrimtari Ismail Kadare është personaliteti qendror i kulturës shqiptare në gjysmën e dytë të shek. XX, protagonist i zhvillimeve më të përparuara në letërsinë shqipe gjatë kësaj periudhe dhe do të mbetet një nga shkrimtarët më të mëdhenj të letërsisë shqipe dhe asaj europiane.

Ambasadorja e Francës në Shqipëri znj. Chatherine Suard tha se shkrimtari Ismail Kadare mishëroi me jetën me veprën dhe me personalitetin e tij pasurimin e

dialogut, forcën e shpirtit europian dhe vokacionin mikpritës të Francës. Ajo vuri në dukje shpirtin e lirë krijues të shkrimtarit duke u bashkuar me luftëtarët e rezistencës së stilit të lirisë.

Ambasadorja Suard kujtoi romanin “Pallati i ëndrrave” dhe peripecitë e shkrimtarit në diktaturë, të cilit ia ndaluan botimin e veprës. Ajo kujtoi më tej largimin e shkrimtarit nga Shqipëria drejt Francës, vendit që kishte përkthyer i pari librat e tij. Largimi i tij çoi në protestat e para studentore kundër regjimit diktatorial. Që atëherë, mes kryeqytetit të Francës dhe atij të një Shqipërie të kthyer në demokraci dhe më në fund të rikthyer në vetvete, ai ndau ekzistencën e tij mes fjalëve dhe gjërave, njerëzve dhe vendeve, tha ambasadorja Suard.

Në fund të fjalës së saj ambasadorja Suard u shprehu ngushëllimet më të thella të dashurve të shkrimtarit, lexuesve dhe popullit shqiptar.

Pirro Misha, drejtor i Bibliotekës Kombëtare, e vlerësoi Ismail Kadarenë si një nga shkrimtarët me jetën më të gjatë në krijimtari, mbi shtatë dekada, dhe shprehu falënderimet për shkrimtarin e madh për faktin që në kohë të errëta me krijimtarinë e tij dha një dritë shprese për gjithë bashkëkohësit dhe vendin e tij, e më gjërë.



Znj. Evis Kushi, zëvendëskryetare e komisionit parlamentar për edukimin dhe mjetet e informimit publik, tha se përpara madhësisë së Ismail Kadaresë jam njësoj si mijëra e miliona lexues e adhurues të tij në të gjithë botën. Padrejtësisht nuk ia akorduan çmimin Nobel, por kjo nuk ia zbeh aspak shkëlqimin. Përkundrazi, çmimi Nobri do të jetë si i cunguar pa të. Për Kadarenë asnjë çmim ndërkombëtar nuk do t'i

kishte dhënë lavdinë dhe adhurimin që ka sot, dhe jo vetëm të popullit të tij, por të miliona lexuesve në mbi 40 gjuhë të botës.

Vetë Ismail Kadare, i dha më shumë dinjitet dhe përmasa evropiane letrave shqipe dhe gjithë popullit shqiptar kudo në botë.

Znj. Kushi vuri në dukje edhe kontributin e jashtëzakonshëm të Ismail Kadaresë për Kosovën, duke u bërë zëri i saj në kancelaritë diplomatike në botë, nëpërmjet veprave të tij letrare por edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë, e duke frymëzuar kështu breza të tërë, intelektualë, politikanë, patriotë e njerëz të zakonshëm.

Akad. Shaban Sinani theksoi se vepra e Kadaresë do të jetë "buka jonë e përditshme", dhe për këtë do t'i jemi gjithnjë mirënjohës. Më tej ai theksoi disa merita përjashtimore të veprës letrare, eseistike dhe publicistike të Ismail Kadaresë, që me veprën e tij, sidomos me prozën, e nxori letërsinë shqipe përtej kufirit të ngushtë të gjuhës sonë; Ismail Kadare e bëri letërsinë shqipe letërsi metropolitane; që prej statusit të një letërsie lokale dhe të mbyllur, i dha statusin e një letërsie evropiane e botërore; letërsia e Kadaresë u bë për herë të parë pasqyrë e dukurive metafizike të botës njerëzore; me veprën e tij Ismail Kadare krijoi një Shqipëri paralele, të fisnikëruar, të denjë për familjen që i kishte takuar prej kohës kur europeizmi ishte shfaqur si ide e projekt, prej shekujve të Renesancës, etj, etj.

Botuesi i Kadaresë Bujar Hudhri, president i shtëpisë botuese "Onufri" rrëfeu kujtime nga bashkëpunimi me shkrimtarin dhe me lexuesit e tij. Ai foli për botën e tij të veçantë dhe u shpreh se ndihej shumë i nderuar që ishte i pranishëm në jetën e një shkrimtari botëror si Ismail Kadareja.



Prof. dr. Viola Isufaj theksoi se vepra e Ismail Kadaresë është më shenjuesja e originalitetit dhe e identitetit shqiptar, njëkohësisht më e plotë, më thellësorja dhe më tërheqësja - e është kjo arritje estetike e letërsisë shqipe, e vlefshme madje dhe për masivet e mëdha romanore epope të tij, të cilat, së bashku me vepra të tjera do të japin një ndriçim polihistorik të ekzistencës.

Akad. Gëzim Hoxha lexoi fjalën e lamtumirës të akad. Matteo Mandalà-së. "Mjeshtër i dashur, mik i shtrenjtë i arbëreshëve!", - e quan Kadarenë akad. Matteo Mandalà. Ai kujtoi vizitën e paharrueshme që Kadare bëri në Horën e Arbëreshëve, i shoqëruar nga e shoqja Helena dhe nga mbesa Doruntina dhe theksoi se "Kadare ka qenë një nga përfaqësuesit më karizmatikë të letërsisë botërore, ndër interpretuesit më të thellë të shoqërisë bashkëkohore, dëshmitar i pashoq i tragjedisë që ndërthen herë herës shoqërinë njerëzore duke i mohuar të drejtat më elementare. Për këtë arsye vepra k vepra e Ismail Kadaresë është tempulli i vërtetë ku ai prehet sot".

Prof. Bashkim Kyçyku tha se me veprën e Ismail Kadaresë letërsia shqipe u ngjiti në majat e letërsisë europiane e botërore ... Kështu, po për herë të parë, letërsia shpie mori dhe një funksion tjetër, të ri, funksionin në letërsi dhe kultura të tjera.

Ai theksoi se me veprën e tij nuk njëjtësohet/identifikohet vetëm letërsia shqipe në Europë dhe në vende të kontinenteve të tjerë, por edhe gjuha shqipe me të cilën është shkruar, shpirti dhe fryma shqiptare, kultura dhe traditat nga më të moçmet, të cilat janë mishëruar mjeshtërisht e gjerësisht. Dhe, mbi të gjitha, me të, shpesh njëjtësohet identiteti shqiptar.

Akademik Vasil Tole tha se vepra e Kadaresë ka zgjeruar dhe riformatuar përmasat e munguara të lirisë individuale të çdo shqiptari. Përveçse autoritet qendror artistik e kulturor i vendit, me veprën e tij Kadare ka zgjuar natyrshëm tek unë interesimin mbi lidhje të mundshme të saj me muzikën, vijoi ai.

Pesha dhe rëndësia e veprës letrare të Ismail Kadaresë ndikoi së tepërmi tek muzika skenike, opera dhe baletet shqiptare të pas Luftës II Botërore e posaçërisht tek ajo që konsiderohet si muzikë me program. Arti i Kadaresë, tha ai, ka tërhequr dhe do të tërheqë krijuesit e arteve të tjera, pasi arti i tij është komplementar dhe shumë shtresor, ashtu si kënga polifonike e popullit që ai e donte aq shumë. Te shtresat dhe përbërësit strukturorë të kësaj tradite ai gjeti larminë kulturore të njerëzve dhe të botës, se këtë larmi nuk mund ta perceptosh dot e veç e veç përmes fjalës, tingullit ose lëvizjes, as si individ i shkëputur, por vetëm si artist, pjesë e grupit, e së tërës.

Kadareja - busull e përcaktimit evropian të Shqipërisë, orifeu i përkatësisë europiane të popullit shqiptar

- Kadareja është figurë identitare e popullit shqiptar, krahas Skënderbeut, Ismail Qemalit e Nënë Terezës
- Vepra e tij - testament qytetërimi e identiteti
- Fjala e akad. Skënder Gjinushit, Kryetar i Akademisë së Shkencave, në ceremoninë solemne në nderim të Ismail Kadaresë



Jemi sot këtu për t'i dhënë lamtumirën në emër të Asamblesë së Akademisë së Shkencave, të tërë botës akademike shqiptare, anëtarit të saj të nderuar për 35-vjet me radhë, shkrimtarit e akademikut Ismail Kadare; kryeakademikut për nga vlera e jehona e veprës së tij me famë ndërkombëtare.

Humbja fizike e Kadaresë është pa dyshim humbja më e madhe e letrave shqipe; është një humbje shumë e madhe e kulturës dhe letërsisë europiane e botërore, e akademizmit shqiptar e atij evropian.

Vepra e Kadaresë i ka kaluar me kohë kufijtë e Shqipërisë, të botës shqiptare, dhe bën pjesë në patrimuanin e letërsisë botërore.

Kadareja do të lexohet e vlerësohet në vazhdimësi, pasi mesazhet e veprës së tij, stili e forca e fjalës dhe mendimit, e bëjnë veprën e tij aktuale, tërheqëse dhe

emancipuese për të gjitha kohërat.

Kadareja shkroi nën diktaturë, por vepra e tij përkthehet, lexohet e vlerësohet njëllëj nga lexuesit në të gjithë botën, pavarësisht cilës kulturë apo cilit sistem politik i përkasin. Ajo vazhdon të vlerësohet me çmimet më të larta, duke fituar garën edhe me homologët e tij, me letërsinë dhe veprat e shkruara në demokraci; duke treguar se vlera e krijimtarisë letrare çmohet me sa ajo nxit emancipimin e shoqërisë, lirinë e lexuesit e jo nga sa ka kushtëzuar lirinë fizike të shkrimtarit; çmohet kur ajo e bën mendjen e lirë të shkrimtarit pjesë të zgjimit të madh të popujve; që rrëzuan “perden e hekurt”, si do ta konfirmonte Presidenti i Francës kontributin e Kadaresë.



Fjalën e fundit e thotë lexuesi, dhe lexuesit e Kadaresë, të shtrirë tashmë në tërë botën e në të gjitha gjuhët, vijnë vetëm duke u shtuar; dhe e tillë, me lexues e admirues, do të jetë vepra e Kadaresë për dhjetëvjeçarë me radhë, krahas veprave të pavdekshme të letërsisë botërore, që nuk njohin epokë, por bëjnë epokë.

Për vlerësimin e tij e të veprës së tij letrare do të flitet në vazhdimësi në tërë botën e kulturës e të letrave shqiptare e botërore.

Ne do t'i jemi gjithnjë mirënjohës për gjithçka i la trashëgim popullit shqiptar me krijimtarinë e tij, por veçanërisht edhe për kontributin e dimensionin e tij si akademik.

Kadareja është hulumtuesi, zhvilluesi e mbrojtësi më i zjarrtë e më me influencë i gjuhës shqipe, i origjinës e lashtësisë së saj, i vlerave e pasurisë së saj. Gjuha shqipe, si një gjuhë që arriti të shfaqë talentin e gjenialitetin e Kadaresë në tërë larmishmërinë e thellësinë e tyre, rendidet tashmë në gjuhët e mëdha, të një populli të vogël.

Kontributi i tij si lëvrues i gjuhës është po aq i çmuar sa ai i Çabejt e i plejadës së tij si studiues të saj.

Kadareja qe korifeu i përkatësisë europiane të popullit shqiptar, të vlerave e karakteristikave të kulturës së tij ndër shekuj, të origjinës e lashtësisë së tij ilire e parailire, të zgjedhjes së tij perëndimore që në periudhën e mesjetës.



Kadareja ishte një busull e përcaktimit europian të Shqipërisë, avokati më me influencë i pranimit të Shqipërisë në familjen europiane, i mbështetjes së zgjidhjes së çështjes së Kosovës e pavarësisë së saj.

Kadareja është tashmë një figurë identitare e popullit shqiptar, krahas figurave të tilla si Skënderbeu, Ismail Qemali, Nënë Tereza.

Ne sot shprehim hidhërimin tonë për këtë humbje të madhe, për largimin nga jeta të anëtarit e kolegut tonë, duke i përcjellë ngushëllimet familjes së akademikut Ismail Kadare e tërë komunitetit akademik; atij të letërsisë, kulturës e arteve; tërë inteligjencës shqiptare, për humbjen e ikonës së tyre, me premtimin se ne, si akademi shkencash, do të krenohemi gjithnjë që I. Kadare ka qenë anëtar i saj dhe që vepra e tij do të ruhet si një nga thesaret e kulturës sonë e të shkencave albanologjike, do t'iu përcillet brezave si një testament qytetërimi e identiteti, si një pasuri e vyer kombëtare.

Vepra e Kadaresë do të jetë "buka jonë e përditshme", dhe për këtë do t'i jemi gjithnjë mirënjohës

Sot në akademinë solemne, akad. Shaban Sinani



Do të them pak fjalë në këtë eulogji solemne për disa merita përjashtimore të veprës letrare, eseistike dhe publicistike të Ismail Kadaresë.

1. Me veprën e tij, sidomos me prozën, Ismail Kadare e nxori letërsinë shqipe përtej kufirit të ngushtë të gjuhës sonë, një gjuhë me numër relativ lexuesish dhe pa motra apo lidhje farefisnie. Për katër shekuj gjuha e dytë për letërsinë shqipe ka qenë gjuhë burimi e garancie, gjuhë rikrijimi. Pjetër Bogdani, Giuseppe Schirò prosenior, Jeronim de Rada, Fan Noli dhe Migjeni provuan t'ia ndryshojnë statusin shqipes. Ismail Kadare e bëri letërsinë shqipe letërsi metropolitane. Kalimi prej statusit të një letërsie lokale dhe të mbyllur në letërsi europiane e botërore; prej letërsisë së provincës në letërsi të kryeqendrës, është me karakter epoke. Cilësimi si letërsi europiane apo botërore është terminologjik. Një letërsi kombëtare lartësohet si letërsi europiane jo thjesht prej numrit të përkthimeve, të lexuesve apo të tirazheve të shitura, por kur bëhet pjesë e programeve të rregullta universitare dhe e studimeve monografike. Letërsia e

Kadaresë e ka fituar këtë privilegj. Kadareologjia është tashmë një nëndisiplinë e re e albanologjisë.

2. I. Kadare e ktheu letërsinë në qytet, e shkëputi prej miteve romantike të vonuara, prej madhështimit të malit, malësorit, kullës, kanunit, duke i zëvendësuar me Gjirokastrën, Tiranën, Moskën, Parisin; qytetarin. Kthimi i letërsisë në qytet pas një shekulli e gjysmë idilizimi të jetës në fshat dhe të virtytit tradicional, tipik për shoqëritë e mbyllura, është gjithashtu një ndryshim me karakter epoke, që shenjon një nga shkëputjet progresive më të mëdha të letërsisë shqipe. Vetëm Migjeni kishte provuar ta sillte këtë ndryshim rendi në letërsi para Kadaresë.



3. Letërsia e Kadaresë u bë për herë të parë pasqyrë e dukurive metafizike të botës njerëzore. Hyri në letërsinë shqipe dhimbja, trishtimi, vuajtja e brendshme e njeriut, ndarja, vdekja, humbja, zymtësia, vjeshta, shiu, karakteri pa emër, njeriu në margina, shoqëria pa heronj klasikë - shembëlltyra të “dhjetë cilësive” që kërkoheshin nga letërsia. I. Kadare e refuzoi optimizmin pa themel, retorikën e patetizmin.

4. Ismail Kadare provoi të shkruante letërsi cilësore edhe për motive arketipale që i kishin kthyer në vepra krijuese të tjerë mjeshtra para tij, i bindur se kishte fuqi krijuese për të sfiduar me cilësi estetike. Shkroi romanin Ura me tri harqe dy dekada pasi Ivo Andrić kishte shkruar veprën “Na Drini ćuprija”, me të cilën fitoi çmimin Nobel, ndërsa Nikos Kazantzakis kishte botuar me të njëjtin motiv romanin e

mirënjohur “Krishti kryqëzohet përsëri”. Shkroi e botoi novelën “Nata me hënë” duke e shpërfillur faktin që dy shkrimtarë me njohje botërore, Gabriel Garcia Marquez dhe Hienrich Böl prej vitesh kishin marrë shijen e suksesit me novelat Kronikë e një vdekjeje të paralajmëruar dhe Nderi i humbur i Katerina Blum. Shkroi pas tyre, por i sfidoi paraardhësit me origjinalitetin dhe thellësinë e artit të tij.

5. Me veprën e tij Ismail Kadare krijoi një Shqipëri paralele, të fisnikëruar, të denjë për familjen që i kishte takuar prej kohës kur europeizmi ishte shfaqur si ide e projekt, prej shekujve të Renesancës. Shqipëria e Kadaresë është e barabartë me atdheun e “lexuesit tjetër”. Një pjesë të studimeve e të studiuesve kjo e ka shqetësuar. Në pashënien e “Dimrit të madh” botuar rakisht tri dekadash thuhet se Kadare e ka oksidentalizuar qëllimisht vendin e tij për të rritur kontrastin me vendet e kampit nga u shkëput.

6. Këto merita, që janë njohur e konfirmuar botërisht, i kanë ndryshuar rrënjësisht raportet midis letërsisë shqipe dhe asaj europiane. Për herë të parë kjo letërsi fitoi rolin dhënës në thesarin botëror.

7. Kadare nuk është më, por vepra e tij do të vazhdojë të jetë buka jonë e përditshme, dhe për këtë do t'i jemi përgjithnjë mirënjohës.

<https://observerkult.com/vepra-e-kadarese-do-te-jete.../>

<https://www.tiranadiplomat.com/.../ismal-kadare-i.../>

<https://exlibris.al/akad-shaban-sinani-vepra-e-kadarese.../>

Vepra e Kadaresë ka zgjeruar dhe riformatuar përmasat e munguara të lirisë individuale të çdo shqiptari

Kadare dhe muzika - akad. Vasil S. Tole sot në ceremoninë e lamtumirës në Akademinë e Shkencave



Përveçse autoriteti qendror artistik e kulturor i vendit, me veprën e Tij Kadare kishte zgjuar natyrshëm tek unë interesimin mbi lidhje të mundshme të saj me muzikën. Për këtë shkrova fillimisht një kapitull në librin “Muzika dhe letërsia” me titullin “Projekt për një “Music guide” nga vepra letrare e Ismail Kadaresë”, që u botua nga SHB “Onufri”, në vitin 1997, edhe pse për disa u duk e çuditshme të shkruhej për një marrëdhënie të tillë. Shumë vite me pas, më 2019 u thellova në këtë subjekt dhe shkrova librin “Kadare dhe muzika”, ku besoj se kjo marrëdhënie komplekse e natyrës polifonike mes tyre shtjellohet në shumë plane.

Vetë Kadare në një intervistë të dhënë pas botimit tha se: ... më është hapur nami që Kadareja nuk e do muzikën. Nuk është hiç fare e vërtetë. Në mënyrën time të të shkruarit, e kam ditur intuitivisht, por ma kanë thënë specialistë të muzikës që, përdor shpesh atë zhdrivillim, që quhet, atë procedim që përdor muzika, me lejtmotivet që shfaqen, që zbehen, që ridalin, që ulen, që ngirhen. Siç duket është një dukuri tautologjike e artit, tek të gjitha artet.

Pesha dhe rëndësia e veprës letrare të Ismail Kadaresë ndikoi së tepërmi tek muzika skenike, opera dhe baletet shqiptare të pas Luftës II Botërore e posaçërisht tek ajo që konsiderohet si muzikë me program. Dy emrat më të rëndësishëm të traditës së

muzikës shqiptare, kompozitorët Çesk Zadeja (1927-1997) dhe Feim Ibrahim (1935-1997) u përfshinë në kompozimin e dy veprave të rëndësishme skenike mbështetur mbi veprën letrare të Ismail Kadaresë. I pari për kompozimin e operës “Dasma” me libret të Kujtim Spahivoglit, dhe i dyti për kompozimin e baletit “Plaga e dhjetë e Gjergj Elez Alisë”, mbështetur mbi libretin e shkruar nga vetë Ismail Kadare. Një tjetër opera, “Eumenidet” e kompozuar prej meje u mbështet në tragjedinë e Eskilit me përkthimin në shqip të Ismail Kadaresë.

Sipas Kadaresë: ... në shqip mund të përkthehet çdo gjë, qoftë edhe teksti më i ndërlikuar. Për të bërë një provë, një sfidë do ta quaja, kam përkthyer një prej triologjive të Eskilit, Orestian. Duke qenë se nuk e njihja greqishten e vjetër, kam përdorur dy-tri gjuhë, madje edhe literal nga origjinali. Dhe, më duket se ia kam dalë. Shqipja ka mundësi të pazakonta në përkthim, mundësi të cilat jo të gjitha gjuhët i kanë. Regjisor i operës, ishte personaliteti me origjinë greke me banim në Paris, Yiannis Kokkos i cili shfaqte një respekt të madh për z. Kadare. Opinionin e tij për të pata rastin t’ia transmetoja z. Kadare i cili më dha në një nga takimet tona, librin e tij mbi Eskilin në gjuhën frënge me dedikim për të.



Kadare ka folur gjithëherë me respekt për krijues shqiptarë që bënin art të vërtetë: ...ne e dinim se lexuesit shqiptarë, ata që jetonin aq varfërisht e në trishtim, merrnin

herë pas here ushqim shpirtëror të klasit të lartë, njëlloj si berlinezët, njëlloj si parizienët. Nuk ishte vetëm letërsia. Ishte edhe Çabej, i konsideruar prej tij si shkencëtari më i madh shqiptar i të gjitha kohërave dhe ndër më të mëdhenjtë e Europës, ishin edhe Lasgush Poradeci, Dhimitër Pasko, Vedat Kokona, Skënder Luarasi, Abdurrahim Buza, Odhise Paskali, që të gjithë “të pranishëm në ndërgjegjen tonë, qoftë me artin, qoftë me vetminë e tyre”.

Vepra letrare e Kadaresë ka frymëzuar me dhjetëra krijime muzikore dhe jo vetëm, të shkruara nga kompozitorët shqiptarë. Ndër ta Tish Daija, poemën për kor dhe orkestër “Përse mendohen këto male”; Feim Ibrahimi, uverturën “Përse bie kjo daulle”; baleti “Tokë e pamposhtur”, mbi romanin “Gjenerali i Ushtrisë së Vdekur” me muzikë të Nikolla Zoraqi, Limoz Dizdari, romanca “Hëna mbi plepa”, mbi poezinë e Ismail Kadaresë; Vasil S. Tole, “Melodi në erë” - 1988, koha III e sonatës për violinë e piano me titull të huazuar nga romani “Nëntori i një kryeqyteti”; Edmond Buharaja, “Simfonia alpine”, 1986-1988, me katër kohë, frymëzuar nga poema e Ismail Kadaresë “Përse mendohen këto male” etj.



Arti i Kadaresë ka tërhequr dhe do të tërheqë krijuesit e arteve të tjera pasi arti i tij është komplementar dhe shumështrësor, ashtu si kënga polifonike e popullit që ai e donte aq shumë. Se te shtresat dhe përbërësit strukturorë të kësaj tradite, ai gjeti larminë kulturore të njerëzve dhe të botës, se këtë larmi nuk mund ta perceptosh dot e veç e veç përmes fjalës, tingullit ose lëvizjes, as si individ i shkëputur, por vetëm si

artist, pjesë e grupit, e së tërës.

Në vitin 2018, propozova pranë Kryesisë së Akademisë së Shkencave që akademiku dhe shkrimtari më i madh shqiptar Ismail Kadare të ishte kandidati për çmimin e “Karrierës Akademike” për vitin 2017, çmimi më i lartë që jep Akademia e Shkencave e Shqipërisë për personalitetet e artit, shkencës dhe kulturës. Ditën që dhamë çmimin, në prezencë të z. Kadare, më 14 qershor 2018, në Akademinë e Shkencave, thashë se i përkas atij brezi të cilit për të lexuar librat tuaj mbanin radhë të gjata pranë librarisë së vetme të qytetit, aty ku radha e njerëzve që prisnin ishte më e gjatë se te radhët e bukës apo tek ushqimet e tjera. Kjo sepse krijimtaria e Kadaresë ishte dhe mbetet “buka” jonë shpirtërore, e cila ushqente dhe ushqen imagjinatën, shtynte dhe shtyn, zgjeronte dhe riformatonte përmasat e munguara të lirisë individuale të çdo shqiptari.

E tillë ishte, e tillë është dhe do të jetë!

E përjetshme vepra dhe kujtimi i Tij!

Fjala e znj. Evis Kushi, zëvendëskryetare e komisionit parlamentar për edukimin dhe mjetet e informimit publik, sot në akademinë solemne në sallën

Të flasësh në sallën e Akademisë së Shkencave është gjithmonë nder e privilegj, por të flasësh në këtë sallë për mjeshtrin e madh të letërsisë shqiptare, është edhe përgjegjësi e madhe. Sepse, pavarësisht titullit apo pozicionit që mbaj në Kuvendin e Shqipërisë, përpara madhësisë së Ismail Kadaresë, unë jam njësoj si mijëra e miliona lexues e adhurues të tij në të gjithë botën.



Gjatë këtyre ditëve kam lexuar shumë tituj “shuhet në moshën 88 vjeçare Ismail Kadare”. Miq të dashur, Ismail Kadare nuk mund të shuhet kurrë. Përkundrazi, ai sot kalon në përjetësi, dhe siç ka ndriçuar mendjet e zemrat tona edhe në kohët më të errëta të historisë, do të vazhdojë të jetë frymëzim dhe krenari kombëtare, sepse arriti që me veprën e tij ta fusë Shqipërinë tonë të vogël në hartën e madhe të letërsisë botërore.

Padrejtësisht nuk ia akorduan çmimin NOBEL, por kjo nuk ia zbeh aspak shkëlqimin. Përkundrazi, çmimi NOBEL do të jetë si i cunguar pa të. Sepse Ismail Kadare nuk është i vetmi gjeni të cilit nuk iu akordua ky cmim. Të tillë janë edhe Leon Tolstoi, Mark Twain, Emile Zola, Robert Frost, Franz Kafka, etj. Ata nuk e morën një NOBEL, por emrat e tyre janë skalitur me germa të arta në letërsinë botërore.

Kështu edhe për Kadarenë, asnjë NOBEL apo çmim tjetër ndërkombëtar, nuk do ti kishte dhënë lavdinë dhe adhurimin që ka sot, dhe jo vetëm të popullit të tij, por të miliona lexuesve në mbi 40 gjuhë të botës.

Ka gjithmonë kohë që njerëzit të bëjnë diçka për popullin e tyre. Kjo është një nga thëniet e Kadaresë që më frymëzon më shumë. Jo të gjithë mund të bëjmë gjëra të mëdha, por secili prej nesh mund të ketë një talent, një aftësi, e mund të ketë një shans në jetë për të kontribuar për kombin e tij.

Vetë Ismail Kadare, i dha më shumë dinjitet dhe përmasa evropiane letrave shqipe dhe gjithë popullit shqiptar kudo në botë. Përveçse shkrimtari më i madh shqiptar i të gjitha kohërave, me një ndikim të jashtëzakonshëm kulturor dhe intelektual, ai arriti të sfidojë mjeshtërisht edhe kufizimet dhe vështirësitë e diktaturës dhe të tranzicionit, duke u kthyer në një kampion të demokracisë dhe fjalës së lirë.



Kam lexuar gjithashtu studiuesit se, me “Pallatin e ëndrrave” të Ismail Kadaresë, komunizmi pësoi një goditje të parë në mendjet e shqiptarëve, një sinjal frymëzues, që më pas mori edhe kthesën drejt shkatërrimit përfundimtar. Kjo është fuqia e fjalës, e mendjes, e letërsisë, fuqia e gjeniut Ismail Kadare.

I jashtëzakonshëm është kontributi i tij edhe për Kosovën, duke u bërë zëri i saj në kancelaritë diplomatike në botë, nëpërmjet veprave të tij letrare por edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë, e duke frymëzuar kështu breza të tërë, intelektualë, politikanë, patriotë e njerëz të zakonshëm.

Në fund kam një mesazh edhe për brezin e ri, ata që jo për zgjedhjen e tyre ndodhen sot në kurthin e internetit, rrjeteve sociale e inteligjencës artificiale, zhvillime

këto që pavarësisht vlerave dhe avantazheve që sjellin në botën ku jetojmë, përbëjnë pa dyshim edhe një rrezik social të pashmangshëm.



Të dashur të rinj e të reja, lexojeni veprën e Ismail Kadaresë, jo thjesht dhe vetëm për ta ruajtur e trashëguar atë brez pas brezi si pasuri e rrallë e kombit, por bëjeni këtë më shumë për veten tuaj. Dilni nga zbrazëtia e përditshmërisë, dhe do zbuloni një dritare të re që do t'ju rrisë më shumë, do ju ndriçojë më mirë, e do ju bëjë edhe më krenar që jeni shqiptar.

Shkrimtari franko-shqiptar u largua prej nesh!

Fjala e Sh.E. Catherine Suard, Ambasadore e Francës në Shqipëri, në ceremoninë e lamtumirës të shkrimtarit Ismail Kadare, sot në Akademinë e Shkencave



Ai mishëroi me jetën, me veprën dhe me personalitetin e tij pasurimin e dialogut, forcën e shpirtit evropian dhe vokacionin mikpritës të Francës.

Ai ishte një nga ata për të cilët shkrimi është një betejë, sepse jetoj dhe krijoi si njeri i lirë, në një vend që nuk ishte i tillë.

Zbulimi i letërsisë hapi kufijtë e një bote të re në moshë e adoleshencës.

Dhe në vend që të bashkohej me radhët e "trupës elitare të realizmit socialist", siç quhej ajo, ai u bashkua me luftëtarët e rezistencës së stilit të lirisë.

Por në vitin 1981, me romanin Pallatit të Ëndrrave, sëpata goditi: u deklarua "armik i popullit" dhe iu ndaluar të botonte.

Ai iu drejtua atëherë Francës, vendit që kishte përkthyer i pari librat e tij, në sajë të talentit të mrekullueshëm të përkthyesit të zjarrtë Jusuf Vrioni. Franca u marros e para pas punës së tij, përtej kufijve të Shqipërisë

Me botuesin e tij, Claude Durand, kreun e Éditions Fayard, ai planifikoi një arratisje të madhe në Francë në vitin 1990. Në Tiranë, largimi i tij çoi në protestat e para studentore kundër regjimit diktatorial.

Që atëherë, mes kryeqytetit të Francës dhe atij të një Shqipërie të kthyer në

demokraci dhe më në fund të rikthyer në vetvete, ai ndau ekzistencën e tij mes fjalëve dhe gjërave, njerëzve dhe vendeve. Nga shëtitjet e tij në Tiranën e rigjetur, nga ajo tavolinë në kafenenë Rostand ku çdo mëngjes vendoste bllokun dhe stilolapsin, lindën vepra jashtë çdo kohe, në udhëkryqet e miteve dhe botëve. Ata vazhdimisht na kujtojnë se si Evropa është kontinenti i përbashkët, se sa historia e saj është një histori e të gjithëve.

Presidenti i Republikës franceze Emmanuel Macron, që i dorëzoi medaljen e Grand Officier de la Légion d'Honneur gjatë vizitës së tij historike më 16 tetor 2023, ka përshëndetur një shpirt të lirë, i cili mori pjesë në këtë zgjim të madh të popujve, që shembi perden e hekurt dhe nderoi Francën duke e zgjedhur si vend strehë për krijimtarinë e tij.



Sot ju shpreh ngushëllimet e mia më të thella të dashurve të tij, lexuesve dhe popullit shqiptar.

L'crivain albano-français Ismaïl Kadaré nous a quitté.

Il incarnait par sa vie, par son œuvre et par sa personnalité, l'enrichissement du dialogue, la force de l'esprit européen, et la vocation d'accueil de la France.

Il était de ceux pour qui l'écriture est un combat parce qu'il vécut et créa en homme libre, dans un pays qui ne l'était pas.

C'est la découverte de la littérature qui lui ouvrit à l'adolescence les rives d'un monde nouveau.

Et au lieu de grossir les rangs de la « troupe d'élite du réalisme socialiste », telle

qu'on l'appelait, il rejoignit les maquisards de la liberté de style.

Mais en 1981, avec le roman « le Palais des rêves », le couperet tomba : déclaré « ennemi du peuple », il fut interdit de publication.

Il se tourna alors vers la France, le pays qui avait été le premier à traduire ses livres, grâce au formidable talent de traducteur de feu Jusuf Vrioni. La France qui fut la première, au-delà des frontières albanaises, à se passionner pour son œuvre.

Et c'est avec son éditeur, Claude Durand, patron des éditions Fayard, qu'il planifia en 1990 son exil en France. A Tirana, son départ entraîna les premières protestations étudiantes contre le régime dictatorial.

Dès lors, de la capitale de la France à celle d'une Albanie revenue à la démocratie et enfin rendue à elle-même, il partagea son existence entre les mots et les choses, les hommes et les pays. De ses promenades dans Tirana retrouvée, de cette table du café Rostand où il posait tous les matins son carnet et son stylo sont nés alors des textes hors du temps, à la croisée des mythes et des mondes. Ils nous rappellent sans cesse combien l'Europe est le continent du commun, combien son histoire est une histoire en partage.



Le Président de la République française, Emmanuel Macron, qui lui a remis les insignes de Grand Officier de la Légion d'Honneur lors de sa visite historique à Tirana le 16 octobre dernier, a salué un esprit libre, qui participa de ce grand éveil des peuples qui souleva le rideau de fer, et honora la France en la prenant pour asile de sa création.

J'adresse aujourd'hui à ses proches, à ses lecteurs, et au peuple albanais, mes condoléances émues.

Lamtumirë Mjeshtër i dashur, mik i shtrenjtë i Arbëreshëve!

Nga akad. Matteo Mandalà, sot në akademinë solemne -

Lajmi i vdekjes së Ismail Kadaresë më mbërriti papritur pardje në mëngjes pak përpara se të fillonte mbledhja e radhës e këshillit të departamentit. Brenda pak çasteve në fytyrat e kolegëve të mi u shfaq një vel trishtimi, shprehje e një pikëllimi të sinqertë për këtë humbje të madhe të shqiptarëve dhe të Shqipërisë. Të gjithë kolegët e mi e çmojnë artin e Kadaresë; disa syresh kishin pasur rast ta njihnin personalisht në vitin 2009 gjatë ceremonisë solemne të dorëzimit të titullit Laurea Honoris Causa që iu akordua nga Universiteti i Palermos. Aty për aty në atë auditor ku ishin mbledhur profesorë dhe studiues të shquar italianë u konkretizua tributi modest, por domethënës në kujtim të shkrimtarit të madh shqiptar.



Kadare ishte një mik i shtrenjtë dhe vlerësues i madh i arbëreshëve dhe i historisë së tyre kulturore dhe letrare. Të pavdekshme do të mbeten vlerësimet që ai i kushtoi Jeronim De Radës dhe Skënderbeut, imazhin historik i të cilit ai e lidhte thujtë instinktivisht me arbëreshët e Italisë. Ende sot të gjalla janë kujtimet dhe mbresat e udhëtimeve që shkrimtari ynë ndërmori në Kalabri dhe në Sicili. Gjatë këtyre vizitave ai u rrethua nga përzemërsia dhe entuziazmi masiv. Të shumtë ishin arbëreshët që donin ta takonin, t'i shtrëngonin dorën dhe t'i shprehnin mirënjohjen e tyre.

E paharrueshme mbetet vizita që ai bëri në Horën e Arbëreshëve, kur, i

shoqëruar nga e shoqja Helena dhe nga mbesa Doruntina, gjatë një momenti që edhe sot nuk mund ta përshkruaj me fjalë, të pranishmit perceptuan në fjalën e Kadaresë ndjesinë e mishërimit magjik të së vërtetës letrare.



Kadare ka qenë një nga përfaqësuesit më karizmatikë të letërsisë botërore, ndër interpretuesit më të thellë të shoqërisë bashkëkohore, dëshmitar i pasqyrtar i tragjedisë që ngërthen hera-herës shoqërinë njerëzore duke i mohuar të drejtat më elementare. Për këtë arsye vepra e Ismail Kadaresë është tempulli i vërtetë ku ai prehet sot.

Kadare thoshte shpesh se për dekada të tëra kishte jetuar si një gjysmë i vdekur mes të gjallëve: nëse ne studiuesit e letërsisë do t'ia dalim në punën tonë, mund të them me plot gojën që në të ardhmen Kadare do të jetë më i gjalli ndër të vdekurit!

Së shoqes, Helenës, vajzave Gresës dhe Besës, nipërve dhe mbesave, botuesit Bujar Hudhri, Akademisë së Shkencave, kolegëve dhe miqve të shumtë të Ismail Kadaresë u bëj ngushëllimet më të sinqerta në emër të arbëreshëve, të familjes sime dhe në emrin tim personal.

Një lamtumirë për Kadarenë nga arbëreshët

Matteo Mandalà



Lajmi i vdekjes së Ismail Kadaresë më mbërriti papritur dje në mëngjes pak përpara se të fillonte mbledhja e radhës e këshillit të departamentit. Brenda pak çasteve në fytyrat e kolegëve të mi u

shfaq një vel trishtimi, shprehje e një pikëllimi të sinqertë për këtë humbje të madhe të shqiptarëve dhe të Shqipërisë. Të gjithë kolegët e mi e çmojnë artin e Kadaresë; disa syresh kishin pasur rast ta njihnin personalisht në vitin 2009 gjatë ceremonisë solemne të dorëzimit të titullit "laurea honoris causa" që iu akordua nga Universiteti i Palermos.

Aty për aty në atë auditor ku ishin mbledhur profesorë dhe studiues të shquar italianë u konkretizua tributi modest, por domethënës në kujtim të shkrimtarit të madh shqiptar.

Kadare ishte një mik i shtrenjtë dhe vlerësues i madh i arbëreshëve dhe i historisë së tyre kulturore dhe letrare. Të pavdekshme do të mbeten vlerësimet që ai i kushtoi Jeronim De Radës dhe Skënderbeut, imazhin historik i të cilit ai e lidhte thujse instinktivisht me arbëreshët e Italisë.

Ende sot të gjalla janë kujtimet dhe mbresat e udhëtimeve që shkrimtari ynë ndërmori në Kalabri dhe në Sicili. Gjatë këtyre vizitave ai u rrethua nga përzemërsia

dhe entuziazmi masiv. Të shumtë ishin arbëreshët që donin ta takonin, t'i shtrëngonin dorën dhe t'i shprehnin mirënjohjen e tyre. E paharrueshme mbetet vizita që ai bëri në Horën e Arbëreshëve, kur, i shoqëruar nga e shoqja

Helena dhe nga mbesa Doruntina, gjatë një momenti që edhe sot nuk mund ta përshkruaj me fjalë, të pranishmit perceptuan në fjalën e Kadaresë ndjesinë e mishërimit magjik të së vërtetës

letrare. Kadare ka qenë një nga përfaqësuesit më karizmatikë të letërsisë botërore, ndër interpretuesit më të thellë të shoqërisë bashkëkohore, dëshmitar i pasqyrës së tragjedisë që ngërthen hera-herës shoqërinë njerëzore duke i mohuar të drejtat më elementare. Për këtë arsye vepra e tij letrare përbën një thesar kulturor të paçmueshëm, që në të ardhmen do të tërheqë gjithmonë e më

shumë vëmendjen e lexuesve dhe kritikëve. Të gjithë studiuesve dhe në veçanti Akademisë së Shkencave u bie barra të vlerësojnë trashëgiminë e artit kadarean dhe t'ia përçojnë atë kritikisht

pasardhësve. Kjo është një detyrë shkencore që do të na lejojë jo vetëm të përsosim paradigmen e vdekjes së autorit, temë kjo fort e dashur për teorinë letrare, por edhe të pohojmë se vepra e

Ismail Kadaresë është tempulli i vërtetë ku ai prehet sot. Kadare thoshte shpesh se për dekada të tëra kishte jetuar si një gjysmë i vdekur mes të gjallëve: nëse ne studiuesit e letërsisë do t'ia dalim

në punën tonë, mund të them me plot gojën që në të ardhmen Kadare do të jetë më i gjalli ndër të vdekurit!

Së shoqes, Helenës, vajzave Gresës dhe Besës, nipërve dhe mbesave, botuesit Bujar Hudhri dhe miqve të shumtë të Ismail Kadaresë u bëj ngushëllimet më të sinqerta në emër të arbëreshëve, të familjes sime dhe në emrin tim personal.

Lamtumirë Mjeshtër!

Matteo Mandalà

Palermo 10 giugno 2009 - Sala delle Capriate, Palazzo Chiaromonte-Steri, Sede dell'Università degli Studi di Palermo.

Il Magnifico Rettore di allora, [chiar.mo](#) prof. Roberto Lagalla, legge il decreto di conferimento della Laurea Honoris Causa in "Scienze della Comunicazione sociale e istituzionale" a Ismail Kadare

<https://www.gazetatema.net/.../fotovideo-kadare-nje...>

Lamtumirë Mjeshtër!

"Një penë kundër bunkerëve"

Shkruar nga Jean-Paul Champseix, më 5 korrik 2024, me shkas nga ndarja nga jeta e shkrimtarit dhe akademikut Ismail Kadare

- Kadare - shkrimtar kombëtar, pa qenë shkrimtari zyrtar
- Në veprat e tij heronjtë shembullorë mungojnë, fundet janë të palumtur dhe urrejtje nuk ka
- Nobeli i mungoi Kadaresë



Ismail Kadare sapo është ndarë nga jeta, në moshën tetëdhjetë-e-tetëvjeçare. Ai është autor i një numri të konsiderueshëm veprash letrare, sa të pazakonta, aq edhe të papritura. Kadare e jetoi gjithë jetën e tij në Shqipëri, një vend që provoi një nga diktaturat më të ashpra në planet, nën sundimin ultra-stalinist të Enver Hoxhës. Ai kërkoi azil politik në Francë vetëm në vitin 1990, në një kohë kur regjimi ishte në gjendje të rëndë dhe shkrimtari kishte arsye të forta për të pasur frikë për jetën e tij.

Kadare u bë i njohur kur ishte ende adoleshent, përmes poezive të tij, të cilat e ndihmuan për të shkuar në Institutin "Gorki" në Moskë, më 1958, për të mësuar si të bëhej shkrimtar socialist realist. Ai mezi e pranoi këtë mësim, që u ndërpre dy vjet më vonë, për shkak të shkëputjes së marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik.

"Gjenerali i ushtrisë së vdekur" (1963), një nga romanet e tij të parë i ndryshoi rrjedhën e fatit. Ndonëse kjo vepër në Shqipëri pati pak sukses, në Francë u prit

ngrohtësisht (1970) sepse joshi lexues dhe befasoi. Romani tregon për mbërritjen në Shqipëri të një oficeri dhe të një prifti italian, misioni i të cilëve është mbledhja e eshtrave të ushtarëve të rënë gjatë Luftës së Dytë Botërore. Aspekti modern dhe funeral i tekstit sfidoi pritshmëritë. Aksioni zhvillohet në një Shqipëri çuditërisht të shtrirë, me baltë, vazhdimisht dimërore. Dy personazhet, për të cilët nga lexuesi dihet pak, nuk shihen si armiq kapitalistë: janë individë të pakëndshëm në funksionet e tyre. Pak flitet për regjimin komunist bashkëkohor. Përsa i përket luftës, ajo shihet pa heroizëm, përmes ditarit të gjetur të një ushtari italian, i cili me rënien e Musolinit u strehua në një familje fshatarësh shqiptarë duke respektuar ligjet tradicionale të mikpritjes. Në momente të caktuara tekstin e rrethojnë ëndrrat dhe një atmosferë ëndërrimtare.

Franca, në atë kohë, konsiderohej si një qendër kulture. Vetë Enver Hoxha kishte dhënë për pak kohë mësim në liceun francez të Korçës, në jug të vendit, ku më parë kishte qenë dhe student. Kritika entuziaste e lexuesve francezë dëshmoi vlerën e kësaj vepre. Duke qenë se suksesi me lexuesin nuk do t'i mungojë përgjatë rrjedhës së viteve, Kadare do të bëhet shkrimtari kombëtar i vendit, pa qenë shkrimtari zyrtar.



The poster features the logos of the Albanian Academy of Sciences and Letters (AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË) and the Fan Noli Publishing House (SHTËPIA BOTUESE Fan Noli). The main title is 'Veprimtari shkencore-promovuese në ditëlindjen e shkrimtarit dhe akademikut I. Kadare' followed by 'Ismail Kadare, një disidencë letrare' in red. The event is scheduled for January 28, 2022, at 11:00 AM in the Aleks Buda hall. A portrait of Jean-Paul Champseix is shown next to his name and the title of his book, 'Ismail Kadare: une dissidence littéraire'. The book is noted as being nominated for the Trinia and Albanology Award (Meyer-Pedersen-Jokli) and edited by Irena Rambi and Bashkim Shehu. At the bottom, there is a red banner with Zoom meeting details: 'Me pjesëmarrje fizike dhe online në linkun: https://us02web.zoom.us/j/89230235815?pwd=UjhaNVJlTQXNlZUZYUjNzNGFwcnZ3QT09 Meeting ID: 892 3023 5815 Passcode: 889000'.

Paradoksalisht, një vend ultra-nacionalist si Shqipëria, pranoi që Kadarenë ta quante shkrimtar të madh një vend i huaj. Mund të imagjinojmë xhelozinë që ngjallte Kadare në botën e vogël letrare të vendit - të cilën ai do ta përshkruante si një det të

kripur - dhe dyshimin e përsëritur se "ka shkruar duke dashur të kënaqë borgjezinë perëndimore". Madje, më keqdashësit do të pohojnë se sukcesi i tij në Francë u provokua artificialisht, "duke qenë Kadare një spiun i shpërblyer i Parisit". Nëse akuza të bën të qeshësh sot, atëherë nuk ishte e njëjta gjë.


Sukcesi i shkrimtarit dhe vështirësitë që hasi gjatë gjithë jetës së tij erdhën nga fakti se ai mbeti i papërshkueshëm nga dogmat e realizmit socialist. Në veprat e tij realiteti është i vështirë për t'u lexuar, faktet janë të vështira për t'u vendosur, trishtimi është rend i ditës me dimrin si pasojë, heronjtë shembullorë mungojnë, fundet janë të palumtur dhe urrejtja mungon. Koha është shpesh ciklike, në kundërshtim me "marshimin e historisë", dhe pushteti konsiderohet një manifestim i së keqes. Optimizëm dhe "të ardhme të ndritur" vështirë se ka.

Kultura e Kadaresë - e cila e imunizoi atë - i ka rrënjët në universet letrare që e magjepsën atë dhe që ai nuk ishte shumë larg t'i konsideronte si të shenjta. Në panteonin e tij janë Eskili, Homeri, Shekspiri, Dante, Servantesi, Gogoli si dhe Kafka, të cilin ai mundi ta lexonte gjatë qëndrimit në Moskë. Legjendat shqiptare, të cilat regjimi komunist donte t'i zhdukte si "mbijetesa arkaike dhe supersticioze", ishin gjithashtu themelore për të, sepse ai i konsideronte ato si enë të urtësisë së madhe. Ai u frymëzua nga legjenda e kështjellës së Rozafatit për romanin e tij "Ura me tre harqe" (1978) dhe nga ajo e Konstandinit e Doruntinës për romanin "Kush e solli Doruntin?" (1980).

E kuptojmë pse romani i tij i dytë i rëndësishëm, "Përbindëshi" (1965), nuk e kaloi pengesën e censurës. Shkrimtari shkriu, në kohë ciklike, dy epoka: luftën e Trojës dhe një rrethim imagjinar të Tiranës në kohët bashkëkohore: kali i famshëm u zëvendësua nga një furgon i vjetër në dukje i braktisur, me njëfarë Ulyse K brenda. Është e vërtetë se kjo vepër mishëronte terrorin politik ... Kadare do të preket nga ndalimi i veprës, sepse konsideron se qelizat pararojë në trurin e tij ndoshta vdiqën në tronditje. Do shprehej Kadare: "Është letërsia ajo që më ka çuar drejt lirisë dhe jo e kundërta. Nuk ka qenë kurrë e lehtë për të lënë qoftë dhe dyshimin më të vogël në sy të të tjerëve. Unë e njihja letërsinë më parë, shumë përpara se të njihja lirinë".

Më pas Kadarë do të praktikojë shmangien nga bashkëkohësia duke u strehuar në të kaluarën, për të cilën ai padyshim qortohet, duke e akuzuar se ka pasur frikë për vitet gjatë "revolucionarizimit" (1967), një imitim i revolucionit kulturor kinez, i cili përshpejtoi kolektivizimin, kërkoi të zhdukë traditat dhe e bëri fenë krim kundër shtetit. Shkrimtari do të botojë atëherë "Daullet e shiut" (1970), një roman rezistence - disi të dëshpëruar - kundër forcave osmane në Mesjetë; një kështjellë që dukej e paepur. Ai botoi edhe "Kronikën e qytetit të gurtë" (1970), ku ringjalli fëmijërinë e tij në qytetin e bukur të Gjirokastrës, të pasur me shtëpi të larta të fortifikuara, ku ai u lind, ashtu si Enver Hoxha. Në rrëfimin e kujtimeve të tij, ai nuk frenohet të përshkruajë zakonet dhe ritet tradicionale që regjimi dëshiron të eliminojë.

Ndërsa Kadare u bë i famshëm, ata në pushtet sugjeruan se do të ishte e përshtatshme që më në fund të shkruante për periudhën moderne. Shkrimtari vonoi ta bënte këtë, më pas filloi veprën që do të ushqente një polemikë të përjetshme: "Dimri i vetmisë së madhe", pjesa më e madhe e të cilit u shkrua në vitet 1971 dhe 1972. Në atë kohë Shqipëria dukej se po qetësohej pas turbullirave të "revolucionizimit" dhe dobësimit të lidhjeve me Pekinin. A ishte e mundur shpresa për një kthesë drejt Europës - ashtu si Jugosllavia e Titos? Kadare e beson.



Vepra e Kadaresë bart historinë e vendit të tij, por, për fat të mirë, ajo shkon përtej saj me universin e fortë dhe poetik letrar që ajo përdor. Ai do të prodhojë një vepër komplekse, e cila nuk është as një roman i realizmit socialist dhe as një vepër gjyqësore. Ai zgjodhi si temë asgjë më pak se prishjen mes Bashkimit Sovjetik dhe Shqipërisë, me personazh kryesor Enver Hoxhën, i cili në konferencën e 81 partive komuniste në Moskë sulmoi kokë më kokë Hrushovin, duke shkaktuar një skandal të madh (1960). Romani është çuditërisht realist në përshkrimin e shoqërisë shqiptare: një

realitet i trishtuar, i paplotësuar, i nënshtruar konflikteve të brezave, borgjez në rrugën e tij me nomenklaturën, informatorin dhe policinë. Kadare shkon deri aty sa të pikturojë portretin e dy aktivistëve, njëri ish-oficer policie sadist, tjetri ëndërrimtar për të shfarosur shkrimtarët, domethënë të gjithë ata që mendojnë. Përfitoi edhe nga përçarja për të kritikuar sistemin sovjetik, kopja e të cilit ishte Shqipëria! Në këmbim, Hoxha cilësohet si një intelektual romantik, që merr përsipër luftën e përrjetshme të kombit të vogël kundër supershtetit.

Duke lexuar Eskilin, duke përçmuar botën e vrazhdë të Lindjes, ai pyet veten, në një mënyrë disi të zhgënjyer, për të ardhmen e komunizmit. Kadare më vonë shkroi: "Në robëri, po shkruaja një roman të lirë. Një libër i trishtuar si një requiem. Kundër diktaturës. Gjithçka ishte e vërtetë, përveç portretit të diktatorit". I pamatur ishte projekti i tij për t'i vendosur diktatorit një maskë eufemike në fytyrë, për ta inkurajuar atë që të ndryshonte Ai shton: Kisha përshtypjen se kjo ishte ajo që kishte bërë Eskili me Zeusin në tragjedinë e tij për Prometeun. Në të vërtetë, në fund të ciklit kushtuar atij, Prometeu vulos një pakt me Zeusin e qetësuar.

Fiaskoja e mashtrimit është totale. Romani shfaqet në një kohë kur regjimi po forcohet dhe do të inaugurojë një sërë spastrimesh kundër intelektualëve, ushtrisë dhe drejtuesve në ekonomi. Libri bëhet subjekt i një fushate denoncimesh, përfshirë edhe punëtorët brenda fabrikave. Partia komuniste dhe policia sekrete kërkojnë dënim. Gruaja e Hoxhës, e cila e urren Kadarenë, e kuptoi se shkrimtari i atribuonte spekulime filozofike dhe fjali me kuptim të dyfishtë personazhit Hoxha. Në momentin kur sëpata është gati të bjerë, Enver Hoxha ndali makinerinë burokratike. Kadare e kupton që portreti i tij i pëlqente tiranit dhe se romani do të funksionojë si një hajmali që do ta mbrojë atë. Megjithatë, shumë kundërshtarë të regjimit nuk do t'ia falin kurrë këtë vepër shkrimtarit, i cili do të pyesë veten "nëse e gjithë kjo nuk do të kishte qenë fryti i vetëm i imagjinatës sime dhe se nuk ishte me vend të justifikohesha për diçka që nuk duhej ta kisha bërë". Duke u kthyer nga iluzionet e tij për fuqinë e letërsisë, ai shkroi në vitin 1991: Të ndihmohet diktaturën të heqë qafe qoftë edhe një pjesë të së keqes që banon në të, është një ndërmarrje joproportionale.

Ne mund ta gjykonim Kadarenë dyfish, nëse vazhdimi nuk tregonte se ai do të hynte në një disidencë të vërtetë letrare ndërsa regjimi u fosilizua. Një poezi, "Pasharët e kuq" (1975), e cila sulmon burokracinë, i dha atij zbritjen në bazë për disa muaj. "Kamarja e turpit" (1978) evokon Ali pashë Tepelenën, i cili u përpoq të shkëpuste veten nga Porta e Lartë në fillimet e shekullit të 19-të. Paralelizmi me Enver Hoxhën, i cili u nda me BRSS, por mbajti një regjim tiranik, është lehtësisht i dukshëm. Pseudo-perandoria osmane planifikon, si hakmarrje, një shkatërrim të traditave që të kujtojnë zullumet e "revolucionarizimit". Kokat e prera, të shfaqura në kamaret e mureve të pallatit të sulltanit, aludojnë për spastrimet.

"Ura me tre harqe" (1978) rivlerëson një të kaluar message që ata të pushtetit kërkojnë ta fshijnë. Kadare do të flasë për dëshirën e tij për të "rivendosur ikonën". Në "Muzgu i perëndive të stepës" (1978) ironizohet me dogmat e realizmit socialist, të cilat, secila, korrespondon me një nga rrathët e "Ferrit", në mënyrën e përfytyruar nga Dante. "Koncert në fund të dimrit" (1981) - roman që do të shpërblehet me çmim dhe më pas do të ndalohet! - tallet me Maon, trafikantin e drogës dhe politikat e tij vdekjeprurëse.


Në "Pallati i ëndrrave" (1981), i cili ndoshta përbën majën e veprës së tij, Kadare imagjionon, ende në një pseudo-perandori osmane, një forcë policie ëndrrash që kërkon të zbulojë komplotet në mendjet e pandërgjegjshme të rebelëve që nuk janë në dijeni të veten e tyre. Që në fillim të romanit, sheshi kryesor, që supozohet të jetë në Stamboll, i ngjan tmerrësisht atij të Tiranës. Shkrimtari ka shkuar shumë larg; aludimet dhe "kuptimet e dyfishta" janë shumë të dukshme. Në vitin 1982, gjatë Plenumit të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, Kadare u cilësua publikisht si armik nga trashëgimtari i Enver Hoxhës, Ramiz Alia, fjalimi i të cilit u publikua në shtyp. Kadare, në një përzierje marrëzie dhe revolte të heshtur, pret më të keqen. Të nesërmen, një urdhër nga Komiteti Qendror u jep fund sulmeve ...

Në një regjim totalitar, Kadare e gjen veten të konsideruar si armik, por të toleruar nga tirani. I kthjellët dhe i hutuar, ai deklaroi në televizion në vitin 1998: Enver Hoxha më shpëtoi nga Enver Hoxha. Shkrimtari nuk e kupton pse përfitoi - dhe vetëm ai - nga një status i privilegjuar kur nuk kishte asnjë lidhje me diktatorin, të cilin e takoi vetëm një herë ballë për ballë për të diskutuar ndarjen me Moskën. Sigurisht, Stalini mbrojti Boris Pasternakun, të cilin policia politike donte ta shtypte, Hitleri bëri të njëjtën gjë me Ernst Junger, i cili megjithatë kishte miq në grupin e komplotuesve që kishin tentuar t'i vrisnin. Sunduesit duan të luajnë me privilegjin e tyre. Hoxha, i cili donte të bëhej artist, ishte padyshim krenar që nën sundimin e tij kishte një shkrimtar me pozitë ndërkombëtare, të cilin e shpëtonte me kënaqësi nga aparati i policisë. Le të theksojmë, megjithatë, se në vitet 1980 ishte e pamundur të gjendej një vepër e Kadaresë në librari, qoftë në shqip apo në gjuhë të huaj. Veprat shiteshin sapo botoheshin a ribotoheshin.

Pas vdekjes së Hoxhës në vitin 1985, në Tiranë u ndërtua një mauzoleum i madh në formën e një piramide. Më pas Kadare boton një roman, me ngjarje të vendosura në Egjiptin e lashtë, që tregon se ndërtesa që ndërtoi Keopsi nuk është menduar për nderimin e tij pas vdekjes, por për të përdorur energjinë e popullit të tij ("Piramida", e refuzuar më 1988, botuar më 1990).

Në vitin 1990 Kadare kërkoi azil politik në Francë. Largimi i tij padyshim përshpejton rënien e regjimit. Ai refuzon t'u përgjigjet kërkesave të Ramiz Lisë dhe, kur regjimi bëhet demokratik, ai nuk dëshiron të bëhet Václav Havel i Shqipërisë. Në mendjen e tij letërsia dhe politika nuk përzihen. Kjo nuk e pengon atë të flasë për aktualitetin, veçanërisht gjatë luftës në Kosovë.

Ai vazhdon punën mes Parisit dhe Tiranës. Në "Spiritus" (1996), një thashethem pretendon se policia sekrete është në gjendje të bëjë që shpirtrat e të vdekurve të rrëfehen. Mikrofonët, në fakt, ishin qepur në xhaketat e palltove të njerëzve të dyshuar nga regjimi, nën drejtimin e Enver Hoxhës, të cilët ishin bërë të çmendur dhe të verbër. Me "Lulet e ftohta të prillit (2000), Kadare përdor një përrallë që tregon historinë e një gruaje të re të martuar me një krijesë, që shndërrohet gjarpër ditën dhe burrë natën. Në këtë tregim shkrimtari denoncon, në kaosin e vendit, burrat e rremë, por tutorë të vërtetë, të cilët pretendojnë të martohen me vajza të reja për t'i prostituiuar. "Darka e gabuar" (2008), në mënyrë të këndshme, rendit fyerjet që ka pësuar Shqipëria e vogël në udhëkryqet e perandorive. "E penguar, requiem për Linda B" (2009) riaktivizon mitin e Orfeut, një vajzë e re e reduktuar duke dërguar një mik për të joshur burrin që ajo dashuron.



Në një nga tekstet e tij të fundit, si "Kukulla" (2013), Kadare evokon nënën e tij, me psikologjinë e saj shumë të veçantë, e cila luajti një rol në formimin e tij si shkrimtar.

Kundërshtarët e Kadaresë nuk pushuan kurrë të theksonin se ai shkroi poezi që shkonin në drejtim të regjimit. Shkrimtarët shqiptarë e quajtën "haraç" këtë letërsi

konformuese. Ishte e pamundur, brenda një regjimi të tillë, në të cilin nuk kishte disidencë politike, t'i shpëtohej këtij haraçi. Kadare, kur u bë i famshëm, e gjeti veten "të emëruar" deputet (në vitin 1970), një titull nderi, pasi parlamenti nuk kishte asnjë rol politik për të luajtur, i gjithë pushteti ishte në duart e Byrosë Politike. Në vitin 1982 ai padyshim e humbi këtë titull. Në vitin 1972, në moshën tridhjetë e gjashtë vjeç, ai u ftua të anëtarësohej në partinë komuniste. Gjatë rënies së regjimit, shumë nga kundërshtarët e shkrimtarit shpresonin të zbulonin dokumente komprometuese në dosjet e policisë dhe partisë, të cilat do të tregonin marrëveshjen e fshehtë të shkrimtarit me regjimin. Asgjë nuk u gjet. Kadare ishte gjithashtu një nga ata që kishte kërkuar që në fillim hapjen e të gjitha dosjeve

Kadareja pati fatin të kishte si përkthyes Jusuf Vrionin, anëtar i një familjeje pronarësh të tokave, i cili, pasi kishte studiuar në Paris, pati idenë e keqe për t'u kthyer në Shqipëri. Ai u dënua në vitin 1947 me dymbëdhjetë vjet burg dhe punë të detyruar. Pas lirimit iu ngarkua përkthimi i veprave të shumta të Enver Hoxhës dhe, për kënaqësinë e tij, filloi të përkthente edhe Kadarenë. Për më tepër, botimet e Fayard-it e mbështetën gjithmonë shkrimtarin dhe veprat e plota, të parathëna shumë mirë nga Éric Faye, u botuan në të dyja gjuhët. Në këtë vend të mbyllur, i cili, ideologjikisht, nuk u lëkund kurrë - kishte ende vend për spastrim dhe përkeqësim. Në arkiva gjejmë letra të pensionistëve të policisë sekrete, të cilët, në vend që të luanin shah, u mblodhën për të vënë në dukje të metat ideologjike dhe "domethënie të tjera të dyfishta" në vepra të Kadaresë, ndërsa Hoxha, në një çmenduri të ndyrë, mbuloi vendin e tij me një numër prej 170 mijë banorësh bunkerësh. Kadare u përpoq të bënte të njohur vendin e tij të vogël, të cilit i ndalohej hyrja, pa zbukuruar traditat si në "Prilli i thyer" (1978), i cili tregon historinë e një të riu në një hakmarrje.

Vepra e Kadaresë bart historinë e vendit të tij, por, për fat, ajo shkon përtej saj me universin e fortë dhe poetik letrar që ajo vendos. Megjithatë, ai nuk e fshehu kurrë pakënaqësinë e tij: "Që ishte një vepër e dëmtuar rëndë, ishte e dukshme. Ajo ishte shtrembëruar kryesisht nga presioni i tiranisë". Megjithëse fitoi çmime të shumta (Cino-del-Duca, International Booker, Princess of Asturias, Panairi Ndërkombëtar i Jerusalemit, International Neustadt), ai ishte në listën e atyre që kualifikoheshin për çmimin Nobel për një kohë të gjatë pa marrë kurrë çmimin suprem. Statusi i tij, i vështirë për t'u konceptuar, është sigurisht shkaku. Ndaj Nobelit i mungoi Kadare, i cili në vitin 2016 deklaroi për profesionin e tij si shkrimtar: "Nuk po them se e bëra mirë, por guxoj të them se më lëndoi".

Vepra e Ismail Kadaresë, reagime nga akademikë dhe studiues Zëri i Amerikës

Në Tiranë, studiues, akademikë dhe botues të njohur e cilësuan shkrimtarin Ismail Kadare si autorin më të rëndësishëm në historinë e letërsisë shqipe, me ndikimin më të madh kulturor tek publiku shqiptar dhe ai ndërkombëtar gjatë 70 viteve krijimtari dhe i përkthyer në disa dhjetëra gjuhë të botës.

Ata pohuan në intervista për Zërin e Amerikës se shkrimtari Ismail Kadare arriti të kapërcente kufizimet e diktaturës dhe vështirësitë e tranzicionit, duke botuar vepra, që përfaqësonin dhe interpretonin kombin shqiptar.

Anëtar i katër akademive të shkencave, me një mori botimesh dhe përkthimesh në 70 vjet krijimtari, gjysma në diktaturë e gjysma në demokraci, Ismail Kadareja shihet nga akademikët e Shqipërisë si shkrimtari më i rëndësishëm i historisë së letërsisë shqipe, të cilës i dha një përmasë europiane.



Sekretari shkencor i Akademisë së Shkencave, Shaban Sinani, thotë për Zërin e Amerikës se “Ismail Kadareja është interesues i shpirtit të shqiptarëve, ndërsa letësia e tij është zëdhënëse e botës shqiptare”, duke qëndruar denjësisht për krahas letërsive të gjuhëve të mëdha, dhe duke konkurruar me letërsitë e gjuhëve të Perëndimit dhe të

Lindjes”.

Ai theksoi se gjuha shqipe u pasurua mjaft dhe arriti maksimumet e veta në penën e Ismail Kadaresë.

“Ismail Kadareja është njëherësh edhe njeri që i dha identitetin europian popullit shqiptar, e bëri atë të pranishëm në botë dhe e paraqiti si një popull të qytetëruar. Vepra e tij është ajo që ka formuar shpirtërisht, estetikisht, moralisht dhe intelektualisht breza të tërë. Ajo vepër do të vazhdojë të jetë po kaq formuese sa është sot edhe për breza që vijnë më tej. Emri dhe vepra e Ismail Kadaresë do të jenë gjithnjë”, thotë zoti Sinani.

Studiuesit besojnë se Kadareja paraqiti në veprat e tij vlerat e denja të qytetërimit shqiptar, sidomos në dekadat e shekullit të kaluar kur për Shqipëria nuk njihej në Perëndim për shkak të izolimit, por me veprat e tij Kadareja ishte për botën një dritare me të dhëna etnografike e kulturore për popullin shqiptar.

Drejtori i Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, Piro Misha, thotë për Zërin e Amerikës se Kadareja do të jetë gjithmonë pjesë e jetës së shqiptarëve dhe sa më shumë të kalojë koha, aq më shumë do t'i ndjehet rëndësia.

“Për botën shqiptare është ndoshta figura që ka bërë më shumë se gjithkush tjetër për të bërë të njohur në botë shqiptarët dhe Shqipërinë, e sidomos në ato dekada të shekullit të kaluar kur për ta nuk dinte asnjëri asgjë. Është një shkrimtar që përbën një kontribut që ne ia japim kulturës botërore, sepse nuk është e rastit që është një autor që përkthehet në pothuajse çdo gjuhë. Kemi patur letërsi dhe autorë, që kanë qenë lokalë. Me të kapërcyem kufijtë e botës dhe miliona njerëz të lexojnë, të njohin, të bëhen kureshtarë për shqiptarët, që të njohin më shumë Shqipërinë. Nuk është e rastit, që përveç çmimit Nobel, Kadare ka marrë çdo çmim tjetër të rëndësishëm që ekziston. Është një moment për të medituuar, për të kujtuar dhe për të vlerësuar atë që kemi humbur, si dhe atë që për fat të mirë, na ka lënë pas ky shkrimtar”, thotë zoti Misha.

Prej afro 3 dekadash krijimtarinë e Ismail Kadaresë e publikon shtëpia botuese Onufri, dhe sot është një ditë e hidhur për mikun dhe bashkëpunëtorin e ngushtë të tij Bujar Hudhri. Ai thotë për Zërin e Amerikës se kjo ngjarje që duket sikur shënon një fund fizik të jetës së tij, do të përkojë me një vlerësim edhe më të madh të krijimtarisë së Kadaresë.

“Në këtë ditë shumë të trishtë për mbarë botën kulturore sikur për mua si botues është diçka që e kisha menduar shumë larg, ose që nuk do të vinte kurrë. Në mendjen time shkrimtarë të mëdhenj si ai ti nuk mund t'i inkuadrosh në një jetë të zakonshme njerëzore. Krejt vepra e tij, që është pjesë e thesarit kulturor të botës, që na flet të gjithëve, duket si diçka që ne nuk e pushtojmë dot, por jemi pushtuar prej saj, dhe njeriu që e ka krijuar këtë ty të duket sikur do ta kesh gjithmonë pranë vetes. Jam krenar si botues, që arrita të botoj vitin e kaluar krejt korpusin e tij në 7 vëllime në gjallje të tij, duke zgjedhur vet ai veprat, që ai donte nga 70 vjet krijimtari”, thotë për Zërin e

Amerikës, botuesi Bujar Hudhri.

Studiuesit pohojnë se tek vepra e Ismail Kadaresë bazohen mbi 100 teza masteri dhe doktoraturash, që zhvillohen dhe rezlizohen në universitetet e Perëndimit, duke i shtuar Albanlogjisë një dije të re, që quhet Kadarelogji.

Zoti Sinani tha se në gjithë botën ka sot studiues të Kadaresë, përkthyes, profesorë, katedra dhe departamente, që merren posaçërisht me veprën e Kadaresë, e cila është me rëndësi të madhe, pavarësisht nga koha kur u krijua.

“Siç e ka thënë vet në veprën e tij të fundit "Kur Sunduesit grinden", shkrimtari i madh, që mban drejtpeshimin e një letërsie është po aq i rëndësishëm në shoqëri sa edhe ai që qeveris, sa edhe tirani, mbreti, diktatori, princi, Kadareja është po aq i rëndësishëm në zhvillimin historik të popullit shqiptar. Ai e ka sfiduar me veprën e tij kufizimin, disiplinën, kontrollin, ia ka arritur që të japë vepra të lira edhe në kohë kur nuk kishte liri. Siç është shprehur në ditën e pranimit të tij në Akademinë e Shkencave Politike e Morale të Francës, ai krijoi një bukë të ngrënshme në kushte burgu. Dhe kur erdhi epoka e shoqërisë së lirë, i dha edhe më shumë kuptim veprës së tij”, tha zoti Sinani.

Lidhur me krijimtarinë gjatë diktaturës, studiuesit pohojnë se Ismail Kadare me veprën e tij kapërceu kufizimet e kohës dhe rrethanave të përcaktuara, duke krijuar romane sa lokale aq edhe universale.

Zoti Misha thotë se është merita e Kadaresë është që për herë të parë në letërsinë shqipe arrin të kalojë kufijtë lokalë, të nxjerrë vepra përtej kohës dhe të përjetshme si dhe të bëhet i pari shkrimtar që merr një dimension universal, edhe pse nën një regjim shtypës.

“Është si një paradoks, që duket sikur hedh poshtë ato paradigmat ekzistuese, që në një diktaturë, në një regjim shtypës, se këtu ka qenë një regjim shtypës, është e pamundur që të krijohet, ai vërtetoi që mund të krijohet. Gjenitë dalin edhe jashtë këtyre pengesave, që duken të pakapërcyeshme për të tjerët. Është produkt i terrenit tonë, i truallit shqiptar, i botës shqiptare, i të qenit shqiptar, por arriti të bëhet pjesë e botës edhe në ato kohë kur dukej e pamundur dhe kjo është është e rëndësishme. Ai ka arritur të përkthehet dhe të bëhet shumë i njohur në pothuaj gjithë vendet qysh në vitet 70 të shekullit të kaluar, në momentet më të errëta të Shqipërisë. Arriti të kapërcejë gjithë ato pengesa dhe këto janë ato përjashtimet nga rregulli, që ka gjithmonë historia, kur edhe realitete të tilla si Shqipëria e asaj kohe, totalisht e izoluar nga bota, një nga vendet më të prapambetura e më të mbyllura, arriti t’i japë botës diçka me vlera universale”, thotë zoti Misha.

Akademikët ashtu si edhe botuesi Bujar Hudhri veçuan se Ismail Kadareja krijoi shumë për shqiptarët në radhë të parë, dhe se ai ka patur një lidhje dhe ndjeshmëri të veçantë shpirtërore me Kosovën. Zoti Hudhri kujton emocionet e panairit të fundit të

shkrimtarit në Prishtinë.

“Doja të theksoja këtu gëzimin e madh të Kadaresë, që ai këtë vepër të përmbledhur e publikoi së pari në Panairin e librit në Prishtinë. Ka qenë një ngjarje e jashtëzakonshme, e gëzueshme, e mallëngjyeshme, ku Kadare ka ndjerë krejt vlerësimin përballë lexuesit të Kosovës, për të cilin ai ka patur një nderim shumë të veçantë, e ndërkohë që edhe lexuesit e Kosovës e duan shumë për arsye të shumta”, thotë zoti Hudhri.

Botuesi i Kadaresë thotë se shkrimtari arriti të botojë gjithçka para se humbte jetën sot në moshën 88 vjeçare dhe gjithçka që donte t’i tregonte botës gjendet në 7 vëllimet e sistemuara të krijimtarisë 70 vjeçare, ndërsa ai dhe akademikët besojnë se studimet mbi veprën e tij do të vazhdojnë e të thellohen më tej brenda dhe jashtë vendit me një ritëm tjetër për një kohë të gjatë.

Sot për Kadarenë, nga Università degli Studi di Palermo

La notizia della morte di Ismail Kadare è giunta inaspettata ieri mattina poco prima che iniziasse la consueta riunione universitaria. Nel giro di pochi istanti, sul volto dei miei colleghi è apparso un alone di tristezza che esprimeva sinceri sentimenti di cordoglio per tutti gli albanesi e per l'Albania.

Tutti apprezzavano l'arte di Kadare, alcuni di loro lo avevano conosciuto personalmente durante la solenne cerimonia di conferimento nel 2009 della "laurea honoris causa" che gli era stata accordata dall'Università di Palermo. Nell'immediatezza di quei pochi istanti, in quell'aula che riuniva illustri accademici italiani, si è concretizzato il modesto ma significativo tributo alla memoria del grande scrittore albanese.



Kadare è stato un leale amico e autentico estimatore degli arbëreshë e della loro storia culturale e letteraria. Immortali rimarranno le valutazioni critiche che in più occasioni riservò a Girolamo De Rada e a Scanderbeg, la cui immagine eroica quasi istintivamente associava alla comunità degli Albanesi d'Italia. Indelebili sono i ricordi dei suoi viaggi in Calabria e in Sicilia. In tutte le sue visite fu circondato da affetto ed

entusiasmo. Erano tanti gli arbëreshë che vollero incontrarlo, stringergli la mano e tributargli la loro gratitudine. Memorabile rimane la visita a Piana degli Albanesi, quando accompagnato dalla moglie Elena e dalla nipotina Doruntina, durante un momento che ancora oggi non saprei descrivere a parole, i presenti percepirono nel discorso di Kadare la sensazione della magica incarnazione della verità letteraria.

Kadare è stato uno dei più carismatici rappresentanti della letteratura mondiale, tra i più profondi interpreti della controversa società contemporanea, impareggiabile testimone della tragedia che ciclicamente colpisce l'umanità privandola delle libertà più elementari. Per questo la sua opera letteraria costituisce un patrimonio culturale inestimabile, che nei tempi a venire attirerà sempre più l'attenzione degli studiosi. A noi tutti e, in particolare, alla nostra Accademia delle Scienze spetterà l'onere di valorizzare la pesante eredità dell'arte kadareana e di trasmetterla criticamente ai posteri. È un dovere scientifico che ci permetterà non solo di inverare il paradigma della morte dell'autore, tema assai caro alla teoria letteraria, ma anche di affermare che l'opera di Isamil Kadare è la vera tomba in cui Egli oggi riposa. Kadare amava affermare che per decenni era vissuto come un mezzo morto tra i vivi: se riusciremo nella nostra impresa, come mi auguro, a buon diritto potremo dire che da oggi e per i tempi a venire Kadare sarà il più vivo tra i morti!

Alla moglie Elena, a Gresa e a Besa, ai nipoti, all'editore Bujar Hudhri e ai tanti amici ed estimatori di Ismail Kadare, rivolgo un saluto di conforto, a nome degli arbëreshë, della mia famiglia e mio personale.

<https://www.facebook.com/matteo.mandala.3/videos/479359571249080/?app=fb>

La scomparsa dello scrittore Ismail Kadare: un grande vuoto nella letteratura mondiale, nel mondo albanese e nella memoria degli italo-albanesi

Prof. Francesco Altimari, Presidente di Fondazione Universitaria "Francesco Solano"

La scomparsa di Ismail Kadare lascia un grande vuoto nella letteratura mondiale contemporanea, nella vita culturale e sociale degli albanesi e nella memoria degli arbëreshë.

Il grande scrittore, originario della città di Argirocastro, dov'era nato 88 anni fa, ha riservato una costante attenzione alla civiltà letteraria sviluppata dalla comunità albanese insediata in Italia sul finire del secolo XV, non nascondendo di considerarla una testimonianza dell'autentica identità degli albanesi.



Più volte e in occasioni diverse - segnaliamo, in particolare, tra quelle significativamente più vicine al mondo arbëresh, la cerimonia a Palazzo Steri per il conferimento della "laurea honoris causa" da parte dell'Università di Palermo nel 2009 e quella dell'assegnazione del premio Mediterraneo da parte della Fondazione CARICAL al teatro Rendano di Cosenza nel 2017 - Kadare espresse la sua ammirazione per la letteratura degli arbëreshë e, in particolare, di Girolamo De Rada, che ammise di considerare il padre della letteratura moderna albanese.

A dare concretezza a questa sua convinzione sono i molti suoi romanzi ("I tamburi della pioggia", "Il ponte a tre archi", "Chi ha riportato Doruntina" ecc.) nei quali il riferimento alla storia, alla cultura e alle tradizioni antropologiche albanesi è la cifra narrativa caratterizzante. Affascinato al pari di altri grandi estimatori albanesi e italiani della cultura arbëreshe, Kadare non ha esitato a condividere le battaglie ideali e culturali che gli arbëreshë hanno combattuto in nome dei diritti spettanti a una minoranza di storico insediamento.

Memorabile fu il suo discorso tenuto nel 2003 nella Badia di Grottaferrata (cf. foto) in occasione del centenario della scomparsa di Girolamo De Rada. Le parole di Kadare ebbero un grande effetto sui presenti che gremivano l'austera aula e che ebbero modo di ascoltare dalla viva voce di una grande interprete della letteratura contemporanea quanto geniale, innovativo e talentuoso fosse stato l'estro artistico dell'intellettuale e scrittore arbëresh di Macchia Albanese.

Il ricordo di quell'evento nel corso dell'ultimo ventennio è venuto rafforzandosi anche grazie ai contatti, numerosi e sempre più calorosi, intrattenuti sia con Kadare e la moglie Helena, sia con le istituzioni scientifiche, accademiche e istituzionali albanesi in tutte le occasioni solenni dedicate all'opera e alla figura del grande scrittore albanese. Nel nome di queste relazioni la Fondazione Universitaria "Francesco Solano" dedicherà le proprie energie affinché l'eredità letteraria di Ismail Kadare, specie quella che riservata al mondo arbëresh, trovi un'adeguata valorizzazione e una opportuna forma di trasmissione alle generazioni future.

La Fondazione Universitaria "Francesco Solano" esprime a nome dei suoi organi di gestione, dei propri collaboratori e amici le più sentite e affettuose condoglianze alla famiglia Kadare, alla moglie Helena, alle figlie Gresa e Besiana, all'Accademia delle scienze, all'editore Bujar Hudhri e ai numerosi estimatori dell'opera del grande scrittore albanese.

Il Presidente della Fondazione Universitaria "Francesco Solano"

Prof. Francesco Altimari

Rende, 2-7-2024

Akademik Dragan K. Vukčević, Kryetar Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Malit të Zi, letër ngushëlluese Kryetarit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Skënder Gjinushit, Kryesisë së ASHSH dhe familjes së shkrimtarit Ismail Kadare



Largimi i shkrimtarit të madh nuk është humbje vetëm për letërsinë e tij kombëtare, por edhe për kulturën botërore. Është nder për ne që Ismail Kadare ishte anëtar ndërkombëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Malit të Zi. Më vjen keq që Kadare nuk jetoi të shihte publikimin e romanit të tij "Kur sunduesit grinden" në gjuhën tonë, që është dhe një homazh për të, vepër që po këto ditë hyri në shtyp, si publikim i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Malit të Zi, shkruan Kryetari Vukčević.

**Projektet e Albanologjisë /
Enciklopedia shqiptare**

“Enciklopedia shqiptare”: gjendja e sotme e punës për përgatitjen dhe dorëzimin e fjalësit (deri në fund të muajit qershor) përmes të dhënave të raportuara nga redaksitë e fushave



Në mbledhjen e redaksisë qendrore të “Enciklopedisë shqiptare” qendra e botimeve enciklopedike dhe albanologjike pranë Akademisë së Shkencave (QBEA) informoi për gjendjen e deritashme të punës për përgatitjen e fjalësit të çdo fushe dhe të fjalësit të përbashkët (për rastet e arritura).

Në këtë mbledhje, që u drejtua nga kryeredaktori akad. Skënder Gjinushi, me praninë e zëvendëskryeredaktorit akad. Mehmet Kraja dhe të anëtarëve të redaksisë nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut, dr. Arian Leka, përgjegjës i sektorit të enciklopedisë në QBEA, paraqiti të dhëna të statistikuara nga kjo qendër për rezultatet e deritanishme dhe prirjet e procesit për përgatitjen e fjalësit të përbashkët të projektit madhor të “Enciklopedisë shqiptare”.

Mbështetur në analizimin e të dhënave nga sektori i enciklopedisë rezulton se:

I. Redaksitë që janë dakordësuar për fjalësin e përbashkët të fushës janë 15 (nga 27 gjithsej për Shqipërinë dhe për afërsisht aq edhe për Kosovën). Redaksitë që e kanë përfunduar këtë proces dhe kanë tashmë fjalësin e bashkuar janë:

- Komunikimi dhe mjetet e komunikimit;
- Gjeologjia dhe minierat;

-
- Matematika, fizika dhe informatika;
 - Energjitë dhe energjetika;
 - Religjionet;
 - Sistemet politike dhe drejtësia;
 - Kimia dhe biologjia;
 - Mjekësia;
 - Industritë dhe teknologjitë;
 - Mjedi;
 - Shkencat shoqërore;
 - Arsimimi;
 - Bujqësia dhe blegtoria;
 - Gjeografia sociale;
 - Gjuhësia.



II. Gjashtë redaksi të tjera i kanë shkëmbyer reciprokisht fjalësit që kanë hartuar në mënyrë të pavarur dhe janë në proces pune për unifikimin e këtij regjistri:

- Historia ushtarake dhe Lufta e Dytë Botërore-nga ana ushtarake;
- Trashëgimia kulturore dhe identiteti kombëtar;
- Gjeografia fizike;
- Ekonomia dhe financat;

-
- Redaksia e posaçme e Maqedonisë së Veriut;
 - Sportet.

III. Tri redaksi e kanë shkëmbyer vetëm në një kahje fjalësin e tyre dhe pritet shkëmbimi nga kahja tjetër:

- Letërsia;
- Artet skenike, pamore dhe multimediale;
- Historia e shek. XX).

IV. Redaksi që nuk e kanë shkëmbyer ende fjalësin janë dy:

- Arkeologjia dhe lashtësia;
- Inxhinieritë, ndërtimtaria, arkitektura.

V. Dy redaksi janë në proces pune për hartimin e fjalësit paraparak:

- Mesjeta, Bizanti, periudha osmane e Rilindja;
- Ngulmimet historike dhe diasporat.

VI. Nga të dhënat administruara nga sektori i enciklopedisë shqiptare pranë QBEA vërehet se shkalla e pavarësimit nga fjalorët enciklopedikë ekzistues (FESH dhe FEK) është e dukshme.

- Numri i artikujve sipas klasifikimeve (artikull i ri, i modifikuar, i pandryshuar) kundrejt FESH, FEK etj., ndaj totalit prej 10 mijë njësive paraqet këto të dhëna:

- Fjalësi i përbashkët i 15 redaksive (në numër njësish) - 5.548.

Nga këto:

- Artikuj tërësisht të rinj, që nuk janë në FESH dhe FEK, shprehur në numër njësish janë 2.960;

- Artikuj ekzistues në FESH dhe FEK, por që propozohen të zgjeruar/ modifikuar/ rifreskuar janë 1.813;

- Artikuj ekzistues të pandryshuar nga FESH dhe FEK janë 775.

VII. Raporti në përqindje (ndaj totalit të parashikuar të numrit të artikujve sipas marrëveshjes ndërqeveritare dhe asaj ndërakademike, gjithsej 10 mijë) është 55,48 përqind.

- Totali i numrit të përgjithshëm artikujve propozuar nga të gjitha redaksitë e fushave deri tani është 12.991, ose, shprehur në përqindje - 127,9 përqind.

Nga analizimi i të dhënave të administruara, prirja e procesit është për t'i qëndruar pranë kufive të përcaktuara në rekomandimet dhe aktet rregullatore të miratuara.

Mbledhje e redaksisë qendrore të "Enciklopedisë shqiptare"

- Të pranishëm anëtarët e kësaj redaksie nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut



Mbledhja u drejtua nga kryeredaktori i "Enciklopedisë shqiptare" akad. Skënder Gjinushi.

Për veprimtarinë e dy redaksive vendore, të ngritura në Tiranë dhe në Prishtinë, informuan akad. Mehmet Kraja, zëvendëskryeredaktori i RQ e drejtues i redaksisë vendore të Kosovës dhe akad. Shaban Sinani, drejtues i redaksisë vendore të Shqipërisë.

Një informim të tabelizuar me të dhëna statistikuara për prirjet që shfaqen gjatë takimeve dhe komunikimit midis redaksive të fushave për përgatitjen e fjalësit të përbashkët të "Enciklopedisë" paraqiti dr. Arian Leka, përgjegjës i sektorit të enciklopedisë në QBEA.

Kësaj mbledhjeje iu paraqitën për miratim rekomandimet për zgjidhje të unifikuar të problemeve që dolën gjatë punës së redaksive të fushave. Këto rekomandime qenë diskutuar e miratuar edhe në takimin e datës 3 qershor 2024 të dy redaksive vendore. Rekomandimet u miratuan dhe do t'u bëhen të njohura redaksive të fushave si zgjidhje instruktive.

Gjithashtu u diskutua dhe u miratua kalendari për gjashtëmujorin e dytë për redaksitë e të tre niveleve

Deri në fund të vitit do të përfundojë hartimi i regjistrit (fjalësit) të njësuar të

"Enciklopedisë shqiptare", që, me miratimin nga redaksia qendrore, do të shërbejë si projekt për zbatim.



**Redaksia e gjuhësisë (Tiranë) dhe redaksia e albanologjisë (Prishtinë)
miratojnë fjalësin e përbashkët të fushës për "Enciklopedinë shqiptare"**

- Në përfundim të punës për njësimin e fjalësit edhe redaksitë e arkeologjisë dhe lashtësisë -

<u>Albanian in 1635</u>	<u>Albanian now</u>
Arch	Hark (Arch)
Bucuria	Bukuria (Beauty)
Chiel	Qiell (Sky)
Chien	Qen (Dog)
Cunora	Kunora*(Crown)
Fund	Fund (End)
Gramaticha	Gramatika
Lecura	Lëkura (Skin)
Lule	Lule (Flower)
Mich	Mik (Friend)
Pesch	Peshk (Fish)
Sciu	Shiu (Rain)
Spella	Shpella (Cave)
Stepia	Shtëpia (House)
Viersca	Vjersha (Poem)
Vone	Vonë (Late)

*Kunora is in Gheg dialect, in standard Albanian is "Kurora"

Në mbledhjen e fundme të redaksisë qendrore (9 korrik 2024) u njoftua se 16 redaksi (nga 27 të tilla të ngritura simetrikisht në Tiranë dhe në Prishtinë) kanë realizuar fjalësin e përbashkët.

Redaksia e letërsisë po shkon drejt përfundimit të këtij procesi. Pritet një ritëm më i shpejtë nga redaksitë e historisë.

Fjalësi i përbashkët i gjuhësisë/albanologjisë u arrit të miratohet pas dy

mbledhjeve të përbashkëta dhe diskutimeve konstruktive të drejtuesve dhe anëtarëve të dy redaksive.

Ndonëse jopërfundimtar, sepse shumë çështje janë ende të hapura (madhësia e artikujve për çdo njësi enciklopedike sipas shkallës së përfaqësimit, adresimi i disa njësive tek artikujt përmbledhës, entet dhe subjektet apo tek njësia tematike etj.), fjalësi i përbashkët, aktualisht me rreth 600 njësi, mundëson diskutime më të thelluara, në mënyrë që deri në fund të vitit të ketë përfunduar e të jetë miratuar fjalësi themelor i gjithë "Enciklopedisë shqiptare", që më pas do t'u shpërndalet redaksive të të tri niveleve: qendrore, vendore dhe të fushave.

Në fjalësin e përbashkët të fushës dy redaksitë kanë integruar edhe pjesën përkatëse të njësive enciklopedike nga fjalësi i propozuar prej redaksisë së posaçme që është ngritur në Maqedoninë e Veriut.

Albanologjia, bota shqiptare, me redaksitë e ngritura për artet, trashëgiminë, identitetin etj. mbajnë një peshë cilësore e numerike në "Enciklopedinë shqiptare".

Gati fjalësi i njësuar i redaksive të arkeologjisë dhe lashtësisë: bashkëpunim i suksesshëm i arkeologëve në Tiranë e në Prishtinë

- Drejtuesit e dy redaksive, profesorët Gëzim Hoxha e Arianit Buqinca, integrojnë njësitë enciklopedike. Akad. Adem Bunguri - koordinues i ndërveprimit -

- Kultura e nëntokës "flet" shqip në "Enciklopedinë shqiptare"; "polis et necropolis" dëshmojnë tipologjinë e qytetërimit dhe identitetit -

- Më shumë se gjysma e njërive enciklopedike promovohen për herë të parë, nuk kanë referencë në FESH (2008) dhe "FEK" (2018) -

- Çdo pasuri e trashëgimi e ruajtur në hapësirën historike shqiptare e parashqiptare ka vendin e vet të merituar -

- "Enciklopedia shqiptare" në fazën e vlerësimit paraparak dhe të projeksioneve për realizimin si vepër -




Fjalësi përmban në gjendjen e përtashme 882 njësi, të përzgjedhura nga mbi 1500 që rezultuan në fazën e fillimit.

Fjalësi përmban një lëndë enciklopedike nga më cilësoret e përfaqësueset: vendbanime historike e prehistorike ilire e protoilire, emërtime të fiseve e mbretërive ilire; të miteve dhe shenjtorëve në formën gjuhësore parashqipe; të vendeve të kultit; të

kulturës së besimit (manastire, kodikë, epitafë); forma të lashta të emrave të lumenjve, maleve, zonave, shpellave, kështjellave; histori të qyteteve që janë zhdukur në rrjedhë të kohërave, të mbretërve e sundimtarëve.

Fjalësi i arkeologjisë dhe lashtësisë, tashmë i përbashkët, përfaqëson një shtresë dëshmitare parësore për hershmërinë e popullit, vendin e formimit, vazhdimësinë gjuhësore në harmoni me atë të kulturës materiale. Nëntoka ka folur e do të flasë edhe më fort në "Enciklopedinë shqiptare".



Do të promovohen në këtë botim qytetërimi ilir e parailir, prania kulturore e anështresave dhe shtresa të mundshme jovendëse, tipologjia e identitetit shprehur në stoline zbukurime, armë e veshje, rite të momenteve kryesore të jetës, sidomos rite të varrimit ("polis et necropolis"). Më shumë se gjysma e njërive enciklopedike propozohen për herë të parë (nuk kanë referencë në "Fjalorin Enciklopedik Shqiptar"

(2008) dhe në "Fjalorin Enciklopedik të Kosovës" (2018). Parim pune në redaksi ka qenë që çdo pasuri e ruajtur brenda hapësirës shqiptare të ketë vendin e vet në "Enciklopedi".

Fjalësi i përbashkët, shprehje e një vullneti shkencor konstruktiv, mbetet një "punë në progres". Prandaj shumë njësi janë të pajisura me shenjime orientuese për diskutim nga anëtarë të dy redaksive (E. Hobdari) për mundësinë e bashkimit të dy a më shumë njësive në një, për nevojën e bashkëpunimit me historianë të gjuhës dhe të këshillimit të autorëve të rinj të rëndësishëm; për bashkautorësi të rekomanduara me redaksitë e afërta (religjioni, gjeografia urbane etj.); për njësimin teknik të paraqitjes së fjalës / togfjalëshit referencë (G. Hoxha, A. Buqinca). Disa nga këto probleme mbetet të marrin zgjidhje teknike të njësuar në redaksi të dy niveleve më të larta.

Pritet së afërmi edhe miratimi i fjalësit bazë të letërsisë. Kolegët E. Paci e N. Krasniqi i kanë këmbyer listat e miratuara nga dy redaksitë më vete.

Përgëzime kolegëve gjuhëtarë dhe arkeologë.

Redaksia e ekonomisë, financave dhe tregtisë bashkëbisedim me specialistë të fushave që mbulon

- "Enciklopedia shqiptare" drejt përmbylljes së fazës së dakordësimit për fjalësin e përbashkët

- Profesorati i universiteteve, specialistët e institucioneve kryesore të ekonomisë, bankave dhe tregtisë dhe studiues të lirë ftohen për bashkëpunim për realizimin e artikujve enciklopedikë



Redaksia e fushave ekonomi - financë - tregti, pas stabilizimit të fjalësit të përbashkët, në një proces bashkëpunimi të suksesshëm me drejtuesit dhe anëtarët e redaksisë gjegjëse në Kosovë, tashmë ka nisur këshillimin me grupet e ekspertizës, duke synuar përfshirjen e tyre në procesin e hartimit të artikujve për lëndën e zgjedhur enciklopedike, menjëherë pas miratimit të fjalësit të integruar.

Në funksion të këtij qëllimi këto ditë në sallën "Akademikët" u organizua një takim i kësaj redaksie me ekonomistë, financiarë, specialistë të bankingut e të tregtisë; të ftuar nga universitetet dhe institucionet e specializuara.

Akad. Anastas Angjeli i njohu të pranishmit me punën e deritashme të redaksisë; me rezultatin e arritur që shprehet në identifikimin e lëndës përfaqësuese enciklopedike në fushën që ajo mbulon; me raportet strukturore të artikujve (personalitete, ngjarje,

terma) dhe me kalendarin për më tej. Ai ftoi profesorët e studiuesit pjesëmarrës në takim të ofrohen për bashkëpunim në procesin e realizimit të artikujve.



Në vijim, drejtuesi i redaksisë vendore Shaban Sinani foli për disa zgjidhje që redaksitë e fushave duhet t'i ofrojnë vetë për autorët dhe bashkëpunëtorët e tyre. Rregulloret, parimet bazë, kriteret themelore, janë miratuar prej më shumë se një viti nga redaksitë e dy niveleve më lart, vendore e qendrore.

Zgjidhjet priten në formën e shembujve ilustrues, sipas specifikës së fushës; përmes shembujve gjejnë përgjigje kërkesat që kanë dalë për pragje të njësuara pranimi e hierarkie; për krahasimin dhe njësimin a për afrimin e titujve të nderit dhe gradave e titujve shkencorë në Shqipëri e në Kosovë; për njësitë administrative dhe raportet mes tyre.

Redaksia vendore tashmë ka si detyrë themelore koordinimin e punës së redaksive në grupfusha; zgjidhjen e problemeve për njësitë enciklopedike në kufijtë mes tyre; sinkronizimin e punës për respektimin e niveleve të njëjtë në përzgjedhjen dhe pranimin e trashëgimisë dhe për kalendarin e përbashkët. Shumë redaksi të fushave, dy redaksi vendore dhe një e posaçme, një redaksi qendrore; qindra e ndoshta mijëra autorë realizues, por një enciklopedi, një disiplinë, një kalendar, një prag, kriteret e parime të njëjta.



Të pranishmit, profesorë të universiteteve publike e jopublike, të sistemit bankar e të qendrave kërkimore, shprehën interes e vlerësim për ftesën e pjesëmarrjes si realizues të artikujve të "Enciklopedisë shqiptare" në fushën e tyre (ekonomi, financë, banking dhe tregti).

Redaksitë e gjuhësisë, letërsisë dhe arsimit bashkëvendosin për njësitë enciklopedike në kufi të njëra-tjetrës

- Procesi i njësimimit sipas kriterëve themelore kërkon kalimin nga puna e pavarur në redaksi në një disiplinë të përbashkët në redaksitë e grupfushave, si hap i ndërmjetëm për një enciklopedi kombëtare, për një enciklopedi të botës shqiptare



Në takim morën pjesë drejtuesit e këtyre tri redaksive, gjegjësisht prof. dr. Anila Omari, prof. asoc. dr. Evalda Paci dhe dr. Geron Kamberi. Dy nga këto redaksi (gjuhësia dhe arsimi) kanë rënë dakord me të njëjtat e tyre në Kosovë për fjalësin e përbashkët. Redaksitë e letërsisë në Tiranë e në Prishtinë kanë këmbyer fjalësit e tyre dhe janë në fazën e diskutimit për njësimin e tyre.

Të pranishëm në takim edhe dr. Arian Leka (QBEA) dhe Shaban Sinani (redaksia vendore).

Me përfundimin e fjalësve të fushave dhe këmbimin e njësimin e tyre vendimmarrja në grupfusha nuk është më një çështje vullneti të mirë, por e vetmja mënyrë për të realizuar detyrën e stabilizimit të tyre si fjalës themelor. Prandaj detyra kryesore e anëtarëve të redaksisë vendore sot është koordinimi i punës së redaksive të fushave të afërta (grupfushave) me iniciativën e tyre.

Në takim u këshilluan një për një listat e njësive të tri redaksive dhe u bënë 28 riadresime njësisish në redaksinë adekuate referuar parimit që ajo të përfaqësojë dominanten e veprimtarisë. Po ashtu u vendos se cilës redaksi do t'i takojnë disa njësi të propozuara dy apo tri herë.

U theksua nevoja e vijimit të punës për seleksionimin, duke qenë se shifrat flasin për tejkalim përpjesëtimor referuar projeksioneve kundrejt numrit të përgjithshëm të njësive (10 mijë) të "Enciklopedisë" sipas marrëveshjes ndërqeveritare; për ruajtjen e raporteve midis emërtimeve të përveçme (personalitete, vende, male, lumenj; subjekte, ente, institucione) dhe emërtimeve të përgjithshme (ngjarje, dukuri, zhvillime, pasuri të tokës e nëntokës, terma), duke marrë vendime që një varg personalitësh që mund të cilësohen "të diskutueshëm" të trajtohen tek njësia tematike, tek institucioni apo në një artikull të përbashkët.



Duke krahasuar listat e redaksive të Shqipërisë e të Kosovës u vërejt se ka ende disa probleme të mosrespektimit të pragjeve të njëjtë qoftë në pranimin e lëndës enciklopedike, qoftë në shkallëzimin e saj në madhësi artikujsh. Për këtë do të komunikohet me redaksitë gjegjëse në Prishtinë duke diskutuar e rekomanduar zgjidhje.

Projekti “Fjalori i madh i shqipes”

"Fjalori i madh i shqipes" dorëzohet si vepër tërësore për redaktim deri në fund të muajit gusht

- Mbledhje e kryesisë së redaksisë së "Fjalorit": pjesët e përfunduara nga hartuesit të bashkohen si një vepër e njësuar (gjendje paraprake) në periudhën e shkurtër që mbetet



Në këtë mbledhje morën pjesë akad. J. Thomai (kryeredaktor); prof. dr. Shezai Rrokaj (zëvendëskryeredaktor), akad. Valter Memisha (zëvendëskryeredaktor) dhe prof. asoc. dr. Anila Kananaj (koordinatore dhe sekretare teknike e redaksisë së "Fjalorit").

Çështje themelore për diskutim: ritmet e punës dhe përpjekjet e pjesëmarrëve në procesin përfundimtar hartues e redaktues të veprës për ta kryer atë sipas afateve të parashikuara. U kërkua të përshpejtohen ritmet e punës në të gjitha përbërëset e saj. Hartuesit do të dorëzojnë punën e kryer deri më tash, për të mundësuar njësimin paraprak pa filluar pushimet vjetore. Kurse në fund të gushtit do të bëhet bashkimi i të gjitha shkronjave në një vepër të vetme.

Vepra e përfunduar nga hartuesit dhe e redaktuar nga editorët - kryetarët e grupeve (J. Thomai, V. Memisha, Sh. Rrokaj, M. Samara, Gj. Shkurtaj, Sh. Islamaj, A. Jashari, A. Omari, A. Kananaj); me redaktim të fundmë nga kryeredaktori e dy zëvendëskryeredaktorët, deri në dorëzimin për miratim për botim, kërkon të kryhen

edhe disa procese pune shitesë, si: plotësimi me shtojcat, parathënien dhe hyrjen; leximi kritik përfundimtar i gjithë lëndës nga hartuesit e redaktorët; plotësimi me njësi të reja leksikore e semantike dhe me shembuj përdorimi për ato fjalë a kuptime që nuk kanë asnjë të tillë; njësimi teknik sipas kriterëve leksikografike të këtij fjalori; këshillimi me specialistë konsulentë (sipas fushave terminologjike) për saktësi shkencore (konceptore) të disa termave (me përzgjedhje sipas nevojës për rikonfirmim a ndreqje nga specialistët); krahasimi e verifikimi për njësi leksikore të një shkronje me shkronjat e tjera sipas lidhjeve të tyre paradigmatiche (sinonimike, antonimike, homonimike) e sipas fushave leksikore (me bashkëpunimin e hartuesve e të redaktorëve); zhvendosja e nevojshme e vargjeve sinonimike nga shkronja në shkronjë sipas kriterëve të përcaktuara; qortimi gjuhësor e teknik nga grupi përkatës; formatimi elektronik.



Njësimi i trajtimit leksikografik është kërkesë themelore për cilësinë shkencore të "Fjalorit". Kryetarët e grupeve të hartuesve-redaktorë është koha të zgjidhin problemet e kësaj faze përmbyllëse, sidomos kompaktësimin e lëndës, homogjenizimin kriterial dhe formal, redaktimin shkencor, gjuhësor e teknik.

U vërejt se numri i faqeve do të jetë mbi parashikimin, duke arritur në jo më pak se 8 mijë faqe në formatin e letrës së shkrimit (A4 word), me shkrim 12 pt, hapësira normale dhe formatim libror.

Takim pune në Institutin Albanologjik të Prishtinës për "Fjalorin e madh të shqipes"

- Anëtarë të redaksisë dhe bashkëhartues nga Shqipëria e Kosova të pranishëm -



Në kuadër të projektit "Fjalor i madh i gjuhës shqipe", që do të përmbajë rreth 110 mijë fjalë e togfjalësha të qëndrueshëm e mbi 11 mijë njësi frazeologjike, drejtuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, me bashkëpunimin e disa institucioneve, duke përfshirë Institutin Albanologjik të Prishtinës, ditën e djeshme, më 18.7.2024, u mbajt takimi i radhës për hartimin e veprës.

Grupi i punës nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë (Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë) përbëhej nga akad. Valter Memisha (sekretar shkencor i "Fjalorit" dhe hartues), prof. asoc. dr. Anila Kananaj (bashkëhartuese dhe koordinatore), msc. Engjëllushe Karaj (bashkëhartuese).

Nga Instituti Albanologjik i Prishtinës morën pjesë studiuesit: prof. dr. Shefkije Islamaj (anëtare e redaksisë së "Fjalorit"), prof. asoc. dr. Abdurrahim Maxhuni (shef i degës së gjuhësisë), prof. asoc. dr. Naim Berisha dhe prof. asoc. dr. Sejdi M. Gashi.

Takimi kishte karakter konsultativ në drejtim të përfundimit të punës hartuese në "Fjalor".

Grupi diskutoi gjerësisht dhe me përgjegjësi për punën në fazën e tanishme, kur po mbyllet procesi hartues dhe redaktimi brenda grupit, dhe kur po merr përparësi sistematizimi i lëndës së hartuar dhe unifikimi i paraqitjes leksikografike.

U konkludua se vepra, pavarësisht nivelit të arritur, nuk do të quhet e mbyllur, por secili hartues duhet të pasurojë shkronjën / shkronjat e veta me fjalë, kuptime e thënie ilustruese në vazhdimësi.

**Komisionet e përhershme pranë
Akademisë së Shkencave**

U mbajt mbledhja e parë e komisionit të përhershëm të arteve pranë Akademisë së Shkencave



Sot në datën 12 korrik 2024 u mbajt mbledhja e parë e komisionit të përhershëm të arteve pranë Akademisë së Shkencave.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i këtij komisioni akad. Vasil Tole, zëvendëskryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Ishin të pranishëm Suzana Varvarica-Kuka, Denis Bizhga, Namik Dokle, Megi Tafaruci, Befjore Qose.

Mbledhja u zhvillua në kuadër të veprimtarisë së parë të komisionit të ristrukturuar të arteve, në të cilën zëvendëskryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Vasil Tole bëri një prezantimin të shkurtër se çfarë përfaqëson komisioni i arteve si një nga 11 komisionet e përhershme që funksionojnë pranë Akademisë së Shkencave.

Pas bashkimit të instituteve të albanologjisë me Akademinë e Shkencave, ky komision u dedikohet vetëm arteve shqiptare, ashtu sikurse Qendra për Studimin e Arteve, një institucion i ri shkencor që u ristrukturua për të vënë në fokus të studimeve artin dhe artistët shqiptarë.

Akad. Tole prezantoi anëtarët e komisionit të përhershëm të arteve, që janë akademikë, ekspertë të shquar të fushave të artit, si dhe përfaqësues të disa institucioneve kryesore në vend, si më poshtë:

Vasil S. Tole, kryetar;
Stefan Çapaliku, anëtar;
Fatos Kongoli, anëtar;
Josif Papagjoni, anëtar;
Najada Hamza, anëtare;
Suzana Varvarica-Kuka, anëtare;
Altin Basha, anëtar;
Denis Bizhga, anëtar;
Namik Dokle, anëtar;
Megi Tafaruci, anëtare;
Abigeila Voshtina, anëtare;
Belfjore Qose, anëtare.



Gjatë kësaj mbledhjeje u fol për bashkëpunimet me institucionet qendrore dhe vendore që kanë në fokus të tyre artet dhe detyrat që cakton ligji dhe Statusi i Akademisë për komisionin e përhershëm të arteve në bashkëpunim me Seksionin e Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike.

Komisioni ka për detyrë:

- 1) Të bashkëpunojë me seksionet në realizimin e aktiviteteve të programuara nga ASHSH;
- 2) Të ndjekë posaçërisht zhvillimet në shkencë e kërkim shkencor brenda dhe jashtë vendit, në fushën përkatëse, me qëllim dhënien e mendimeve dhe paraqitjen e propozimeve të argumentuara, për përcaktimin e drejtë të zhvillimit, evidentimin e problematikave, ngritjen e njësive të kërkim-studimit apo komisioneve të posaçme;
- 3) Të hartojnë raporte, oponenca apo ekspertiza të kërkuara pranë Kryesisë apo Seksionit;
- 4) Të propozojë organizimin e aktiviteteve shkencore, për botime të caktuara apo për vlerësim ndihmesash studimore;
- 5) Të mbajnë lidhje me institucionet ndërkombëtare më aktive në fushat përkatëse e me njësitë kryesore të kërkimit në vend;
- 6) Të kryejnë detyrat e vëna nga Statuti, nga Seksioni apo nga Kryesia.



Aktivite

Përkujtohet 580-vjetori i betejës së Torviollit

- Të pranishëm studiues e bashkëpunëtorë të Akademisë së Shkencave -



Muzeu historik i Peshkopisë dhe qendra kulturore e bashkisë së Dibrës, në bashkëpunim me shoqatën “Çidhna dhe Kastriotët”, organizuan më datën 29.6.2024 në hollin e pallatit të kulturës të Peshkopisë një veprimtari nderimi kushtuar 580-vjetorit të betejës së Torviollit, që datohet më 29 qershor 1444.

Për këtë betejë Marin Barleti ka shënuar se “ushtria shqiptare zuri vend në Dibrën e Poshtme, 8 mijë hapa larg Krujës”, që, sipas studiuesve, është lokalizuar në fushën e Kastriotit. Është beteja e parë në front të hapur kundër ushtrisë osmane, me të cilën hapet çerekshekulli i fitoreve të ndritura arbërore të udhëhequra nga heroit kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu kundër supefuqisë më të madhe ushtarake të kohës.

Në këtë veprimtari u mbajtën tre referime. Akad. Adem Bunguri, i cili përshëndeti në emër të Akademisë së Shkencave, praraqiti temën “Rëndësia historike e betejës së Torviollit”. Prof. asoc. dr. Bernard Zoto mbajti kumtesën “Arti ushtarak i Skënderbeut në betejën e Torviollit”. Studiuesi Haki Përnezha mbajti referimin “Pikëpamjet shkencore mbi lokalizimin e betejës së Torviollit”.

Veprimtaria u përshëndet nga autoritetet vendore. Pastaj të pranishmit shkuan në Laçes të Kastriotit, pranë monumentit përkujtimor të kësaj beteje, ku u vendosën kurora me lule në emër të institucioneve të bashkisë dhe qarkut. Një kurorë u vendos edhe në emër të Akademisë së Shkencave nga studiuesit Adem Bunguri dhe Bernard Zoto.

U zhvillua simpoziumi "Monumentet e natyrës së Shqipërisë dhe vlerat e tyre natyrore, historike, kulturore, shpirtërore dhe turistike"

- Akad. Sinani: Referimet e këtij simpoziumi janë provë se studimet gjeografike janë në kërkim të disiplinave e nëndisiplinave të vjetra e të reja, me apo pa traditë, që nga historia e jetës dhe e domestikimit të popullsisë parailire e parashqiptare në mjedisin e sotëm të shqiptarëve; arkeologjia e nënujit dhe ajo e terrenit; etnobilimësia, etnofauna, flora endemike dhe ekskursioniste, antropologjia, etnobotanika, biologjia, spedologjia, ekosistemet, mjedisi dhe shkenca të tjera, madje edhe toponimia dhe etnokultura, legjendat, rrëfimet me karakter folkloristik-etnokulturor



- Akademia e Shkencave është duke përgatitur botimin e së parës enciklopedi shqiptare, si amzë e trashëgimisë kombëtare, e pasurive shqiptare: të tokës, nëntokës dhe mbitokës. Simpoziumi ka rëndësi edhe si propozues e promovues i trashëgimisë natyrore me karakter përfaqësues, që ka vendin e vet në enciklopedi

Veprimtaria u zhvillua sot me 28 qershor 2024 nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë në bashkëpunim me Universitetin "Fan S. Noli" të Korçës në dy mjedise, salla "Aleks Buda" dhe salla "Akademikët" (ASHSH).

Linku: https://fb.watch/s_Tg7SPzWg/

Në panelin e parë të këtij simpoziumi u trajtua tema "Monumentet e natyrës si burim i informacionit shkencor për qasjet kërkimore në aspektet natyrore, historike, kulturore, shpirtërore, estetike, turistike".

Prof. dr. Perikli Qiriazhi, në emër të komisionit të përhershëm të artit e trashëgimisë në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, çeli veprimtarinë.

Ai tha se monumentet e natyrës kanë vlera shkencore, ekologjike, kulturore, didaktike, estetike, edukuese e turistike. Shumë prej tyre janë pjesë e botës shpirtërore të shqiptarëve. Për këto vlera ende nuk ka studime shkencore. Hulumtimi i lidhjes së monumenteve të natyrës me legjendat, gojëdhënat, rite fetare e pagane, me ngjarje historike ndihmon njohjen e ruajtjen e historisë, traditave, botës shpirtërore, rrënjës së identitetit kombëtar, forcimin e koshiençës rajonale. Trajtimi i integruar i trashëgimisë natyrore e kulturore, si plotësuese të njëra-tjetrës, rrit interesin shkencor e turistik.



Në punimin e tij prof. dr. Perikli Qiriazhi analizoi aspekte të lidhjeve shpirtërore të banorëve me monumentet e natyrës, referuar burimeve gjeografike, historike, etnografike, kulturore, të trashëgimisë natyrore; me informacione nga dokumentimi në terren, nga bisedat me banorë e specialistë të disa fusha.

Prof. dr. Zydi Teqjai dhe Zamir Libohova paraqitën punimin për ndikimin e ndryshimeve klimatike mbi monumentet e natyrës në Shqipëri. Në mënyrë të veçantë ky ndikim mund të jetë kritik për monumentet natyrore bimore: pemë, shkurre ose masive pyjore. Në këtë studim janë marrë në analizë 721 monumente natyrore të Shqipërisë, me koordinatat gjeografike përkatëse (VKM nr. 303, datë 10.05.2019 dhe VKM nr. 187, datë 25.3.2021). Numri më i madh i monumenteve të natyrës ndodhen në qarqet e Shkodrës, Vlorës dhe Dibrës. Afro 40 për qind e monumenteve të natyrës në Shqipëri janë me karakter bimor. Studimi tregon se cilat zona dhe specie bimore mund të kërcënohen më shumë nga ndryshimet klimatike dhe rekomandon marrjen e masave për të minimizuar efektet negative.

Prof. dr. Romeo Eftimi, dr. Ermira Jashiku, dr. Ermiona Braholli dhe prof. asoc. dr. Edlira Menkshi paraqitën punimin “Zgavra e Caverit, një dëshmi e besueshme e ndryshimeve klimatike periodike”. Zgavra e Zaverit, në bregun e Liqenit të Prespës së Madhe, afër fshatit Goricë e Vogël, bashkia Pustec, është në listën e monumenteve të natyrës. Ky punim i kushtojë dëshmi që jep zona e Ujëthithësit të Zaverit për ndryshimet klimatike periodike, si shkaktari kryesor i uljes së nivelit të liqenit të Prespës. Këto përfundime përputhen me ato të cilat nxirren nga vërtetimet shumëvjeçare mbi luhajtjen e nivelit të Liqenit si dhe mbi shfrytëzimin e ujërave të liqenit për ujë.

Prof. Emil Lafa paraqiti vëzhgimet për shkrimin e emërtimeve të monumenteve të natyrës në aspektin gjuhësor dhe tërhoqi vëmendjen për shkrimin e saktë të këtyre emërtimeve.



Prof. dr. Aleko Miho paraqiti punimin “Mbështetja juridike e institucionale në Shqipëri për trashëgiminë natyrore, monumentet e natyrës në veçanti - sfidat dhe shqetësimet”. Me gjithë përpjekjet për mbrojtjen dhe me aktet ligjore përkatëse, natyra dhe burimet natyrore janë cenuar rëndë, veçanërisht në 30 vitet e fundit të tranzicionit ekonomik; këtu nuk janë kursyer as zonat e mbrojtura (ZM-të). Së fundi, Kuvendi me Ligjin nr. 21/2024, ka ndryshuar Ligjin nr. 81/2017 për ZM-të. Sipas ndryshimeve, në të gjitha kategoritë e ZM-ve, edhe në zonat e tyre kryesore, mund të lejohen ‘aktivitete infrastrukturore dhe mikpritëse, me standardet më të larta arkitekturore dhe mjedisore për mbështetjen e turizmit të ekselencës (me 5 vje) dhe infrastrukturës përkatëse’;

gjithashtu është fshirë kërkesa mbi zonimin brenda ZM-ve. Për më tepër, ndryshimet e reja sanksionojnë që monumentet e natyrës (MN-të) të mos jenë të rrethuara nga një zonë buferike deri në 200 metra nga perimetri i MN-së (fshirë pika 3, neni 17, Ligji nr. 81/2017); kjo do të thotë që zona "bufer" e një monumenti me ligj ekspozohet ndaj zhvillimit të infrastrukturës. Pavarësisht kufizimeve ekzistuese, ndër vite Monumentet nuk kanë mbetur jashtë ndërhyrjeve, nga infrastruktura turistike apo aktivitete të tjera jomiqësore (tarraca detare e Dajtit, Tiranë; Gryka e Çajës/Lapanit, Kukës; Shkëmbi i Kavajës, Kepi i Rodonit, plazhi i Shën Pjetrit, dunat dhe pylli i tij, Durrës; ujërat termale të Benjës, Përmet; burimet e Ujit të Ftohtë, Tepelenë; burimet e Syrit të Kaltër, Delvinë; burimet e Drilonit, Pogradec; liqeni i Seferanit, Dumre etj.); në të ardhmen e afërt duket se do të ketë të tjera veprimtari të mundshme të planifikuara pranë tyre (p.sh. laguna Limopuo, dunat e Nartës/Poros, kodrat molasike të Zvërnecit, Vlorë etj.). Të gjitha këto nuk janë në funksion të mbrojtjes së natyrës, të sanksionuar në aktet ligjore shqiptare dhe ndërkombëtare; por mbi të gjitha, qasja është kundër cilësisë së jetës për habitatet natyrore, botën dhe vetë njeriun, si dhe uljen e vlerave turistike të vendit. Prandaj, ekspertët dhe ambientalistët kërkojnë me forcë nga vendimmarrja të rishikojë ndryshimet e fundit në legjislacionin e ZM-ve.



Prof. emeritus. Skënder Aliu paraqiti punimin “Shpella e Trenit (Devoll) dhe shpella e Podës (Kolonjë) - vlerat e rralla natyrore dhe historike”.

Shpella e Trenit është përdorur si vendbanim shpellor gjatë epokës së neolitit 7000 vjet p. Kr., bronzit, Hllhekurit e deri ne Mesjetën e hershme e të zhvilluar. Pranë saj ruhen muret e kalasë të Trenit, Trajanit, Mokut, Ventrokut, Shuecit dhe piktura shkëmbore e Spilesë, që duhen vënë në funksion të edukimit e të ekoturizmit, përsa

kohë ato janë pjesë përbërëse e “parkut kombëtar të Prespës” midis dy shteteve Shqipëri-Greqi. Shpella e Podës ndodhet në njërin nga dy kodrat shkëmbore në jug. Gjatë survejimeve ndër vite janë zbuluar brenda tyre shumë fragmente qeramike, që datohen në periudhën e bronzit të vonë, shek. XIII-XII p.Kr., epokës së hekurit shek. XI-VI p. Kr. dhe Mesjetës së hershme shek. VII- VIII m. Kr. Pranë kësaj shpelle ndodhen rrënojat e sarajeve të Zylyftar Podës, muret e dy kishave dhe tetë postafe burimi të gdhendura në një kodër shtufore, që duhen vënë në funksion të edukimit e të agroturizmit.



Dr. Fatbardh Cena dhe inxh. Durim Kaba paraqitën punimin “Monumentet e natyrës parë si potencial turistik në zhvillimin ekonomik të bashkisë Dibër”

Sipas vendimit të vitit 2019 “Për miratimin e listës së rishikuar, të përditësuar, të monumenteve të natyrës shqiptare”, në territorin e bashkisë Dibër gjenden 40 monumente natyre, duke e radhitur ndër zonat me më shumë monumente në Shqipëri. Këto monumente paraqiten të llojeve të ndryshme si shpella, ujëvara, ujëra termale, liqene me origjinë akullnajore, forma të veçanta gjeologjike dhe gjeomorfologjike, biomonumente me forma interesante dhe moshë shekullore etj, të cilat paraqesin një ofertë gjeografiko-natyrore mjaft të pasur.

Dr. Rudina Uruçi dhe dr. Artan Lila paraqitën punimin “Zonat e mbrojtura të bashkisë Kolonjë - problematika dhe sugjerime”. Bashkia Kolonjë renditet ndër zonat me natyrën të larmishme e të pasur në vendin tonë. Nuk janë të pakta rastet kur ato janë lënë jashtë kujdesit e interesimit minimal e si pasojë objekte e me vlera janë dëmtuar,

zhdukur e rrezikohen të zhduken. Analiza e problemeve të vlerësimit të tyre përbën një detyrë të dobishme e interesante aq edhe të vështirë e me përgjegjësi pasi përbën një mundësi për të siguruar të ardhura në sajë të propagandimit dhe reklamimit të tyre për ti kthyer në zona turistike të frekuentuara.

Dr. Thoma Shkira paraqiti punimin “Religjioziteti në monumentet e natyrës”. Ai evidentoi rastet më përfaqësuese për nga bartja e shkallës së elementëve të trashëgimisë shpirtërore dhe religjioze të monumenteve të ndryshme natyrore të Shqipërisë si shpella asketike; malet, si Mali i Tomorit, i Krujës, Guri i Qytetit - Përmet etj. Shkira argumentoi praninë e shtresëzime kulturore kryesisht nëpërmjet elementëve të përhapjes së kultit të nderimit ndaj shenjtoreve të besimeve tradicionale në Shqipëri. Gojëdhënat, toponimet, objektet dhe faktet historike e religjioze dëshmojnë trashëgiminë e pasur materiale dhe shpirtërore që kanë këto monumente natyrore.

Dr. Qerim Kastrati (Prishtinë) prezantoi punimin “Resurset natyrore turistike të Kosovës; vlerësim turistiko-geografik”. Republika e Kosovës ka një numër relativisht të madh të resurseve natyrore turistike. Në përfundim të punimit dha edhe rekomandime që do e ndihmonin zhvillimin e turizmit kontinental në disa pjesë të territorit të Republikës së Kosovës.



Dr. Ermira Jashiku dhe prof. asoc. dr. Edlira Menkshi (Universiteti Fan S.Noli) paraqitën studimin për njohjen dhe vlerësimin e monumenteve të natyrës në qarkun e Korçës. Qarku i Korçës ka trashëguar një pasuri të konsiderueshme natyrore. niveli i njohurive të të rinjve rreth monumenteve të natyrës është mesatarisht i ulët dhe ka nevojë të përmirësohet.

Prof. dr. Pal Nikolli dhe dr. Ermiona Braholli paraqitën studimin për vlerat e monumenteve të natyrës të Mirditës. Me një gjeodiversitet dhe biodiversitet të pasur, Mirdita përfaqësohet me 7 gjeomonumente dhe 4 biomonumente, tashmë të mbrojtura ligjërisht. Nga rezultatet e studimit arrihet në përfundimin që monumentet e natyrës janë një mundësi e mirë për zhvillimin e turizmit në Mirditë, por nëpërmjet rritjes së investimeve në infrastrukturë dhe shërbime.

Dr. Florian Fusha (Universiteti i Firences) dhe dr. Adriatik Balla paraqitën punimin “Liqenet akullnajore: monumente natyrore dhe djepe legjendash”. Për liqenet akullnajore në Shqipëri ka një veçanti që pak ose aspak njihet deri më sot. Kjo ka të bëjë me rrëfenjat mitologjike që vijnë nga thellësia e kohës në marrëdhëniet e grupeve të caktuara njerëzore me objekte të tillë. Histori të tilla me zana, shtojzovalle, ora, që janë figura mitologjike kryesisht shqiptare, ua shtojnë më tej bukurinë dhe vlerën liqeneve. Ndaj, në këtë analizë, fokusi ynë ka qenë të sjellë në vëmendje këtë vlerë mitologjike të liqeneve që vinte e mangët ose e panjohur, por edhe për të kuptuar më mirë ndikimin që këta trupa ujqorë kanë pasur në zhvillimin ekonomik e social-kulturor të shoqërive njerëzore në territoret kryesisht malore.



Dr. Ermiona Braholli, prof. dr. Pal Nikolli dhe prof. as. dr. Edlira Menkshi, paraqitën punimin vlerat shkencore, edukuese dhe turistike të Gurit të Capit. Janë bërë vlerësime të veçuara sasiore të potencialeve shkencore, edukuese dhe turistike të gjeomonumentit të Gurit të Capit, i shpallur monument natyre në vitin 2002. Studimi

është bazuar në kriteret e studiuësit Brihla, ku për përcaktimin e vlerave shkencore janë formuluar 7 kriteret, për vlerat edukuese 12 kriteret dhe për vlerat turistike 13 kriteret. Në saj të rezultateve numerike arrihet në përfundimin se Guri i Capit ka vlera mesatare shkencore, edukuese dhe turistike.

Dr. Eriseld Kalemaj dhe inxh. Iljon Thanas paraqitën studimin “Vlerat natyrore, didaktike, historike, shpirtërore dhe turistike të disa objekteve natyrore në rajonin e Korçës që meritojnë statusin monument natyre”. Studimi është shtrirë në zonën e Oparit, Devollit, Kolonjës, Gorës, Mokrës.

Sara Muska paraqiti studimin “Vlerësimi i potencialit gjeoturistik i shpellave karstike në rajonin juglindor”. Shpellat me vlera paleontologjike arkeologjike, kulturore dhe religjioze janë shpellat në bashkinë e Pogradecit (Memlishtit, Radokalit, shpella e Baribardhës, Najazmës dhe Shën Marenës) bashkinë e Devollit (shpella e Trenit) dhe bashkinë e Kolonjës (shpella e Podës). Qëllimi i këtij studimi është vlerësimi gjeomorfologjik, estetike/skenik dhe kulturor i shpellave në funksion të zhvillimit të gjeoturizmit lokal. Eksplorimi dhe promovimi i tyre nga turistë të huaj dhe vendas të apasionuar pas sporteve ekstreme në natyre me qëllim zhvillimin e turizmit të aventurës.

Paneli II trajtoi tematikën e menaxhimit të monumenteve të natyrës për mbrojtjen e tyre dhe për qëllime studimore, kulturore shpirtërore e turistike; ndjesia e vendit dhe roli i saj në zhvillimin urban.



Prof. asoc.dr. Merita Koka Karaguni dhe prof. asoc. dr. Jostina Dhimitri në qasjen e tyre studimore evidentuan rëndësinë e stimulimit të ndjesisë së përkatësisë dhe rolin që mund të luajnë karakteristikat, elementët apo monumentet e natyrës në zhvillimin e kësaj ndjesie, duke hulumtuar teorikisht mbi konceptin dhe mbi elementë të rëndësishëm natyrore (në nivel monumentesh ose jo) në qytetet e Shqipërisë.

Prof. asoc. dr. Nevila Çinaj dhe Daniel Pirushi prezantuan studimin “Sfidat e menaxhimit të balancuar të vizitave turistike në monumentet e natyrës të Parkut Kombëtar të Vjosës bazuar në standarde dhe tregues të drejtuar nga vlera e monumenteve”. Statistikat e viteve të fundit shqiptare dhe ndërkombëtare, evidentojnë rritjen e konsiderueshme të flukseve të vizitorëve jo vetëm në zonën bregdetare por dhe në monumentet e natyrës në Shqipëri. Nga analiza e gjetjeve konstatohet se, për të siguruar efektivitet në menaxhimin e vizitave turistike, duhet që menaxherët të komunikojnë rregullat dhe rregulloret në mënyrë të qartë, me synimin që vizitorët të jenë të vetëdijshëm për to, arsyetimin pas tyre dhe sanksionet që lidhen me mosrespektimin e tyre.



Albina Sinani dhe Bilal Draçi prezantuan studimin “Probleme të vlerësimit dhe menaxhimit të hidromonumenteve në qarkun e Gjirokastrës”.

Hidromonumentet përfaqësojnë rreth 11% (9 të tillë) të numrit total të monumenteve të natyrës në qarkun e Gjirokastrës. Ai paraqiti rezultatet e hulumtimit në terren të tipareve natyrore, të lidhura me intensitetin e veprimtimit të faktorëve

antropogjenë në territorin e monumenteve natyrore, duke analizuar dhe vërtetuar me shembuj konkretë llojet e ndikimeve antropogjene dhe manifestimin e tyre në territorin e 83 monumenteve natyrore të qarkut, kryesisht të hidromonumenteve.

Akad. Neki Frashëri, prof. dr. Hajri Haska; prof. dr. Robert Damo; prof. asoc. dr. Piro Icka, dr. Eneida Haska; Joan Marko, Edlir Haska, Olsi Miraçi paraqitën studimin për biomonumentet ne qendrat e banuara dhe disa specifikime ne vlerësimin dhe menaxhimin e tyre”.

Prof. dr. Skënder Sala, prof. dr. Perikli Qiriazhi dhe prof. dr. Dhimitër Doka paraqitën një studim të zgjerua për projektin e kthimit të Shpellës së Zezë në muze gjeologo-gjeografik, paleontologjik, arkeologjik dhe turistik.



Dr. Engjëllushe Zenelaj dhe dr. Majlinda Bufi prezantuan studimin për rolin e qeverisjes vendore në menaxhimin e monumentet natyrore për zhvillimin lokal të qëndrueshëm në Shqipëri, bazuar në kuadrin ligjor të qeverisjes vendore për fushën e trashëgimisë natyrore. Hulumtimet mbi të dhënat dhe zhvillimet e kuadrin ligjor në Shqipëri evidentojnë një rritje të kompetencave ndaj monumenteve të natyrës dhe integrimin e rolit të qeverisjes vendore së bashku me aktorë të tjerë të qeverisjes qendrore. por vetë njësitë e qeverisjes vendore duhet të jenë më aktive në fushën e trashëgimisë natyrore duke kuptuar vlerat dhe rëndësinë e tyre, duke pasur në konsideratë integrimin e këtyre monumenteve me planet e zhvillimit dhe përdorimin e tyre si një aset për zhvillimin social dhe ekonomik të zonës brenda parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm.

Prof. dr. Hajri Haska paraqiti studimin “Një vështrim ekologjiko-mjedisor dhe

rivitalizimi i monumentit të natyrës pylli i përzierë Maliq”.

Dr. Fatlinda Shkurti dhe prof. asoc. dr. Albina Sinani paraqitën studimin “Shfrytëzimi turistik i shpellave në qarkun e Vlorës, vlerat e tyre si monumente natyre me të dhëna të plota dhe të hollësishme mbi vlerat e këtyre monumenteve të natyrës për shfrytëzim turistik”.

Dr. Florian Fusha paraqiti studimin “Monumentet e natyrës së Dukagjinit, njohja, ruajtja, potencialet dhe propozime të reja”. Zona e Dukagjinit e shtrirë në zemër të Alpeve Shqiptare, ka një natyrë shumë të pasur dhe këtë e shpreh më së miri prania e mbi 40 monumenteve të natyrës shqiptare të shpallura zyrtarisht dhe në shumë të tjerë, që plotësojnë kushtet për t’u shpallur në të ardhmen.

Dr. Flora Gjoni dhe prof. asoc. dr. Bresena Koplaku paraqiti studimin “Hartimi i shtigjeve tematike bazuar në monumentet natyrore në itinerarin turistik të Thethit, në funksion të turizmit të qëndrueshëm”.



Fadil Bajraktari (Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës) paraqiti studimin “Monumentet e natyrës të Kosovës, mbrojtja dhe menaxhimi i tyre”. Numri i monumenteve të natyrës të mbrojtura në Kosovë është 241 (2024) dhe përfshinë një sipërfaqe prej 6,272.8 ha.

Prof. asoc. dr. Valbona Duri, prof. dr. Niko Rogo dhe dr. Gentian Ruspi paraqitën studimin “Shpella e Skotinisë, potencialet dhe mundësitë e menaxhimit”

Prof. asoc. dr. Jostina Dhimitri, Xhuliana Zdrava dhe prof. asoc. dr. Merita Koka Karaguni paraqitën një analizë të vlerësimit të riskut të degradimit të geomorfositeve

në parkun kombëtar Divjakë-Karavasta dhe të rolit të gjeokonservimit.

Fjorentin Ismaili paraqiti studimin për rolin e sistemit të informacionit gjeografik në funksion të vlerësimit, menaxhimit dhe promovimit të monumenteve të natyrës të bashkisë Përmet.

Marcela Mele paraqiti studimin "Impakti i monumenteve natyrore në zhvillimin socio-ekonomik në bashkinë Pustec, rajoni Korçë. Në këtë punim synohet aplikimi i strategjive gjeo-konservimi në parkun kombëtar të Prespës, konkretisht për komunitetin lokal Pustec dhe grupet e tjera të interesit, me një perspektivë kritike sesi mund të zhvillohet një zonë duke ruajtur monumentet natyrore.

Sonila Gega evidentoi praktikat didaktike efektive në lëndën e gjeografisë për njohjen e vlerave të monumenteve natyrore të disa zonave të Elbasanit. Kurrikula e gjeografisë, krijon mundësi përmbajtjesore për mësimdhënien dhe nxënien e njohurive të trashëgimisë natyrore në përgjithësi, duke u ndalur dhe në monumentet e natyrës.



Në emër të Kryesisë veprimtarinë e përshëndeti sekretari shkencor akad. Shaban Sinani. Ai tha se simpoziumi për pasuritë natyrore të Shqipërisë është pjesë e programit vjetor të saj, që realizohet me bashkëpunimin e Universitetit "Fan Noli" të Korçës, me të cilin ekziston një traditë e suksesshme projektsh të përbashkëta.

Me të drejtë organizatorët, prof. Perikli Qiriazi dhe skuadra e tij, e kanë quajtur "simpoziум" këtë veprimtari, siç e ka kuptimin kjo fjalë në "Simpoziумin" e Platonit, traktat për të shpjeguar se rruga e përkryerjes së botës është një përpjekje e pafund që pjesa të gjejë pjesën më të afërme dhe të bashkëformojë me të të tërën. Ashtu dhe

referimet e këtij simpoziumi janë provë se studimet gjeografike janë në kërkim të disiplinave e nëndisiplinave të vjetra e të reja, me apo pa traditë, që nga historia e jetës dhe e domestikimit të popullsisë parailire e parashqiptare në mjedisin e sotëm të shqiptarëve; arkeologjia e nënujit dhe ajo e terrenit; etnobilimësia, etnofauna, flora endemike dhe ekskursioniste, antropologjia, etnobotanika, biologjia, pedologjia, ekosistemet, mjedisi dhe shkencat e tjera, madje edhe toponimia dhe etnokultura, legjendat, rrëfimet me karakter folkloristik-etnokulturor.



Si dije e hapur për kërkime ndërdisiplinare dhe në epiqendër të tyre, studimet gjeografike, qofshin të asaj sociale a fizike, gjithnjë e më shumë paraqiten edhe si pjesë e shkencave albanologjike. Punimet e këtij simpoziumi janë një tjetër dëshmi se sa e nevojshme është ngritja e një qendre të kërkim-studimit në këtë fushë dhe do ta përshpejtojnë vendimmarrjen për këtë.

Akademia e Shkencave është duke përgatitur botimin e së parës enciklopedi shqiptare, si amzë e trashëgimisë kombëtare, e pasurive shqiptare: të tokës, nëntokës dhe mbitokës. Simpoziumi ka rëndësi edhe si propozues e promovues i trashëgimisë natyrore me karakter përfaqësues, që ka vendin e vet në enciklopedi.

Akad. Sinani ftoi pjesëmarrësit të bashkëpunojnë me redaksitë e fushave që lidhen me gjeografinë sociale dhe atë fizike, në rastet kur diskutohet nëse një trashëgimi është pjesë apo jashtë tyre, si bujqësia, pylltaria, gjeoshkencat, pasuritë ujore etj.

Në Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës u zhvillua konferenca shkencore e përbashkët me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë "Zhvillimi i konstitucionalizmit shqiptar 1912-2024"

- Morën pjesë nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë akad. Aurela Anastasi, akad. Kosta Bajraba, prof. Ksenofon Krisafi

Konferenca u organizua nga Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë më 2 korrik 2024 në ambientet e ASHAK.

Morën pjesë personalitete të shquara nga sfera akademike si akad. Aurela Anastasi, akad. Kosta Bajraba, prof. Ksenofon Kristafi, prof. dr. Arsim Bajrami, prof. dr. Gjyljeta Mushkolaj, Iljaz Ramajli, Muharrem Shabani, prof. dr. Ismet Saliu etj.

Akad. Aurela Anastasi, një nga organizatorët e kësaj konference, mbajti kumtesën me titull: "Kontrolli kushtetues në shtetin shqiptar të pavarur deri në rënien e regjimit monist". Përmes kësaj kumtese evidentoi zhvillimet e konstitucionalizmit në vitet 1920-24 dhe ndikimin në zhvillimet e mëtejshme. Ajo sintetizoi evolucionin historiko-juridik të parimit të Konstitucionalizmit dhe të kontrollit kushtetues në Shqipëri. Përmes analizës së dokumenteve të reja arkivore, punimi arrin në gjetje e konkluzione të rëndësishme për zhvillimin e kësaj lëmie.



Për herë të parë paraqitet një periodizim i zhvillimit të kontrollit kushtetues në

Shqipëri bazuar në modelet ndërkombëtare. U shqyrtua kontrolli paraprak i kushtetutshmërisë së normave dhe roli i Këshillit të Shtetit (1929-1944) si organ kushtetues që kreu këtë kontroll. U shtruan për diskutim gjetjet mbi përpjekjet e Gjykatës së Diktimit, për të ushtruar kontroll gjyqësor të kushtetutshmërisë. U diskutua perspektiva e ndikimit të ndërsjellë të doktrinës me kontrollin kushtetues.

Konkretisht, disa nga gjetjet evidentuan se standardet e parimit të konstitucionalizmit (kushtetutshmërisë) në Shqipëri janë parashikuar shprehimisht qysh në Statutin e Shtetit Shqiptar 1922. Akad. Aurela Anastasi theksoi se studimi i zhvillimeve të konstitucionalizmit dhe kontrollit kushtetues në Shqipëri, nuk është vetëm një detyrë atdhetare e juristëve, por një veprimtari e dobishme për zhvillimin e mëtejshëm të tyre.

Akad. Kosta Barjaba dhe dr. Ilir Barjaba prezantuan temën: Zgjedhjet dhe shtetasit në Shqipëri gjatë periudhës 1912-2024. Tema u fokusua në zgjedhjet politike të zhvilluara në Shqipëri përgjatë periudhës 1912-2024 duke analizuar të drejtat dhe kufizimet e shtetasve për të zgjedhur përfaqësuesit e tyre politikë përgjatë kësaj periudhe.



U trajtuan zgjedhjet e zhvilluara duke filluar nga Kuvendi Kombëtar i Vlorës (28 nëntor - 7 dhjetor 1912), shteti shqiptar nën Princ Vidin dhe Statuti Organik i Shqipërisë, Këshilli Kombëtar i Lushnjës (27 mars 1920 - 20 dhjetor 1920), Këshilli Kombëtar (Parlamenti) (21 prill 1921 - 30 shtator 1923), Kuvendi Kushtetues (21 janar 1924 - 2 mars 1925), Parlamenti i Republikës Shqiptare (1 qershor 1925 - 7 qershor 1928), Asambleja Konstituente (Parlamenti) (dhjetor 1928 - prill 1939), Parlamenti në periudhën 1939-1944, Parlamenti pas Luftës Nacionalçlirimtare (mars 1946 - nëntor 1990), Rilindja e parlamentarizmit në vitin 1991 me zgjedhjet e para pluraliste, dhe

sistemi aktual zgjedhor.

Prezantimi u ndal edhe tek “Statuti i Lushnjës” (1920) si dhe Statuti i Zgjeruar i Lushnjës (1922) që hodhën themelet e së drejtës kushtetuese në Shqipëri. U theksua roli i Parlamentit të Republikës Shqiptare në periudhën 1 qershor 1925 - 7 qershor 1928. U analizua edhe sistemi zgjedhor aktual në Shqipëri, kufizimet e të drejtës për të votuar si dhe mundësinë që shqiptarët e diasporës të votojnë në zgjedhjet e ardhshme parlamentare prej vendeve ku banojnë, nëpërmjet votimit elektronik ose me postë. Referimi konkludoi se barazia e votës është një nga parimet bazë të zgjedhjeve dhe bazohet në parimin e barazisë së shtetasve para ligjit.”.

Prof. Ksenofon Krisafi prezantoi studimin "Gjurmë të hershme të konstitucionalizmit në trojet iliro-shqiptare". Ai theksoi se gjurmët konstitucionalizmit shkojnë shumë larg në histori, fillojnë dhe madje dokumentohen që në kohën e ilirëve. Ilirët, njëloj si fqinjët, në një etapë të caktuar të zhvillimit të tyre, kishin jetë të organizuar qytetare e politike, kishin shtet dhe të drejtë, kishin natyrisht edhe kushtetuta. Më tej, prof. Krisafi vuri në dukje se civilizimi ilir zuri fill dhe u zhvillua në antikitet, në hapësirat që shtriheshin nga Peloponezi deri në Danub, nga vargu i maleve Varnos deri në brigjet e deteve Adriatik e Jon. Kjo dëshmohej nga autorë të lashtësisë greko-romake, midis të cilëve emrat e mëdhenj Aristoteli, Platoni, Polibi, Thukididi, Straboni, Skylaki, Plutarku etj. Dëshmohej edhe nga rezultate të gërmimeve arkeologjike, nga numizmatika, epigrafia, etj. Në hapësirat ilire kishte një civilizim dhe kulture politike, institucionale e juridike, si dhe të struktura politiko-administrative dhe organe me karakter ligjvënës.



“Evidentimi realist i zhvillimit, dinamikës dhe evolucionit të akteve me karakter kushtetues, si dhe institucioneve kushtetuese në trojet iliro-shqiptare, pasqyron të vërtetën e pakontestueshme se shqiptarët, ashtu si edhe fqinjët, kanë qenë të organizuar politikisht, kanë ndërtuar dhe kanë vënë në veprim institucionet e duhura për të rregulluar juridikisht regjimin politik, formën e qeverisjes, organizimin e pushtetit dhe të administratës, jetën e përditshme, marrëdhëniet ndërmjet tyre në fusha të ndryshme të veprimtarisë shoqërore si dhe lidhjet politike me botën e jashtme”, tha prof. Ksenofon Krisafi.

Rektori i Universitetit të Tetovës prof. dr. Jusuf Zejneli prezantoi studimin e tij me temën “Vlerat themelore të rregullimit kushtetues në Republikën e Maqedonisë së Veriut”. Ai theksoi se bazuar në përcaktimin e trajtës së qeverisjes, strukturës, emërimit të institucioneve themelore kushtetuese dhe praktikës së funksionimit të tyre, hasim dallime dhe ngjashmëri në kuadër të organizimit, funksionimit të sistemit juridik-kushtetues në shtete me trajtë të njëjtë ose të ndryshme të qeverisjes. Republika e Maqedonisë së Veriut ka një periudhë të gjatë të tranzicionit kushtetues, nisur nga momenti kur ka qenë pjesë e federatës jugosllave dhe pas shpalljes së pavarësisë si shtet i pavarur. Fakti i të qenit shtet multi-etnik, e bën të veçantë zhvillimin juridiko-historik, në etapa të ndryshme, gjithmonë duke respektuar përcaktimet për të drejtat e komuniteteve. Krahas vlerave themelore veçohet parimi i përfaqësimit adekuat dhe të drejtë të qytetarëve, të cilët u takojnë të gjitha bashkësive, në organet e pushtetit shtetëror dhe institucionet e tjera publike në të gjitha nivelet dhe çështja e vendimmarrjes sipas parimit të njohur të badinterit.



Në 34 vjetorin e miratimit të deklaratës kushtetuese të 2 korrikut, deputetë të atëhershëm të Kuvendit të Kosovës kanë treguar për kushtet në të cilat ishin mbledhur

dhe se ishin të rrethuar nga forcat policore e shërbimi sekret serb. Nënkryetari i Kuvendit të atëhershëm të Kosovës, Iljaz Ramajli theksoi se deklarata kushtetuese të 2 korrikut i ka paraprirë unifikimi i plotë shqiptar. Ai theksoi se deklarata kushtetuese ishte pikënisje për kushtetutën dhe referendumin.

Për hartimin dhe miratimin e Kushtetutës së Kosovës më 7 shtator 1990, foli Ismet Salihu, i cili tha se gjatë dy muajve është punuar vetëm natën dhe në mënyrë ilegale.



Në këtë konference u trajtuan edhe tema mjaft kyçe prej fillesës së gjurmëve të konstitucionalizmit në trojet iliro-shqiptare, pikënisjet e konstitucionalizmit modern shqiptar e deri te sfidat, perspektivat dhe harmonizimi i standardeve konstitucionale konform procesit të integritimit evropian.

<https://www.youtube.com/live/LZg3izKUCzc?si=deWhpeRYCilZbZ-j>

Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë zhvilloi tryezën shkencore: “Kahe, koncepte dhe metodologji në semantikën gjuhësore - pikëvështrime të sotme”

Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë pranë Akademisë së Shkencave zhvilloi sot më 11 korrik 2024 tryezën shkencore “Kahe, koncepte dhe metodologji në semantikën gjuhësore - pikëvështrime të sotme”.



Drejtori i Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë akad. Valter Memisha u uroi mirëseardhjen të pranishmëve dhe ia tha fjalën drejtuesit të grupit organizator prof. dr. Tomorr Plangaricës.

"Ndriçimi sa më i plotë i kaheve të ndryshme të semantikës gjuhësore në etapën e tanishme, por edhe të historisë së mendimit gjuhësor në këtë fushë të dijes, do të krijojë një mbështetje edhe më të sigurt metodologjike për studime të suksesshme edhe për gjuhën shqipe në këtë fushë të dijes gjuhësore", tha prof. dr. Plangarica.

Në këtë tryezë shkencore përgjatë dy seancave u diskutua rreth problemeve të sotme të dijeve në fushën e semantikës gjuhësore nga specialistë të fushës dhe studiues të fushave të përiferarta me këtë dije. Ata nxorën në pah kahje nga më të rëndësishmet në fushën e semantikës në etapën e tanishme dhe ndikimet e ndërsjella të përfuara si pasojë e natyrës ndërdisiplinare që ka formësuar ndërkohë zhvillimi i kësaj fushe studimi.



Seanca e parë nisi me prezantimin e punimit shkencor për arritjet dhe prirjet e veçanta në studimin e dukurive semantike të shqipes nga prof. dr. Artur Lama. Më pas, prof. dr. Rami Memushaj paraqiti punimin "Pesha e përbërësit semantik në gramatikën e shqipes". Akad. Valter Memisha paraqiti studimin e tij për relacionet semantike në një fjalor shpjegues. Prof. asoc. dr. Adelina Çerpja paraqiti punimin shkencor për dinamikën e fjalëve kyç në motorët e kërkimit në gjuhën shqipe. Prof. asoc. dr. Evalda Paci paraqiti punimin shkencor "Në një sprovë të evidentimit të leksikut të sakrales e të flijimit në shqipërimet e klasikëve latinë në gjuhën shqipe". Prof. asoc. dr. Albana Deda foli për mungesën e aplikimit të kriterit semantik në "Gramatikën I". Prof. asoc. dr. Anila Kananaj paraqiti punimin "Metafora në konstruktet e strukturës argumentore".

Në seancën e dytë dr. Leonard Dauti prezantoi disa nga çështjet e semantikës që përbëjnë çështje të semantikës gramatikore. Dr. Enkeleida Shamku-Shkreli paraqiti

studimin “Kuptimi e domethënia mes funksionalizmit e variacionizmit: rasti i dokrrës në gjuhën shqipe”. Rafaela Marteta paraqiti temën e konceptualizimit gjuhësor të procesit të njohjes në perspektivën konjitiviste. Dr. Resul Telhaj paraqiti studimin për tipat kumtuesorë të fjalive dhe kufirin semantik-pragmatik (probleme për trajtimin e fjalive). Dr. Irda Dervishi-Nesimi prezantoi disa dukuri fjalëformuese në leksikun e gjuhës së shkruar të sotme shqipe. Edona Jahiu paraqiti punimin për zgjerimin semantik brendakontekstor të fjalëve me përdorim të shpeshtë. Dr. Ardita Dylgjeri prezantoi teorinë e prototipit në gjuhësinë konjitive. Prof. dr. Tomorr Plangarica paraqiti punimin shkencor për semantikën diskursive dhe natyrën shumëpërmasore të ngjizjes së kuptimit.



Në fund të kësaj veprimtarie u bënë diskutime rreth temave të prezantuara. Prof. dr. Plangarica mbylli veprimtarinë duke spikatur pikat kryesore të temave që u trajtuan në këtë tryezë shkencore.

Me referimet dhe diskutimet që u mbajtën sot në tryezën shkencore “Kahe, koncepte dhe metodologji në semantikën gjuhësore - pikëvështrime të sotme” synohet të krijohet një bazë e domosdoshme teorike për vijimin e punës në hartimin e studimeve që do të përmbliidhen në vëllimin e parashikuar në përfundim të projektit; po ashtu materialet e referuar do të jenë një mundësi më shumë për vijimin e vazhdueshëm të punës për organizmin e lektoriumeve, ku pjesëmarrësit në projekt sipas investimeve të tyre më të drejtpërdrejta do të kenë mundësinë të trajtojnë dhe diskutojnë tezat e tyre, në një kohë të mjaftueshme në referim dhe dialog me studiuesit e tjerë.

“Kërkimi shkencor në ndihmë të zhvillimit të agroturizmit në Shqipëri” dhe “Ekspozitë pomologjike autoktone”



- Veprimtaria e parë e qendrës së kërkimit shkencor "Bioteknologji dhe gjenetikë", themeluar me vendim të Qeverisë si njësi e përhershme pranë Akademisë së Shkencave -

- Organizuar në bashkëpunim me CNR të Italisë dhe me institucione të tjera partnere brenda dhe jashtë vendit -

- Më 5 korrik 2024, në bashkëpunim me qendrën e transferimit të teknologjive bujqësore, Vlorë (QTTB) -

- I pranishëm kryetari i Akademisë së Shkencave akad. Skënder Gjinushi -

Qëllimi i veprimtarisë ishte evidentimi i rëndësisë së studimit të gjermoplazmës së pemëve autoktone, si detyrë imediate për ruajtjen dhe shfrytëzimin, si pjesë e kulturës bujqësore tradicionale kombëtare dhe e zhvillimit perspektiv të pemëtarisë biologjike dhe eko-touristike në zonat malore dhe kodrinore.

Organizatorë: qendra e sapothemeluar e kërkimit shkencor për bioteknologji dhe gjenetikë pranë Akademisë së Shkencave (QBGJ) dhe Instituti IBE-CNR i Firences, në kuadër të programit të bashkëpunimit midis Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të

Shqipërisë dhe Këshillit Kombëtar të Kërkimit të Italisë (2022-2024).

Objektiva të veprimtarisë ishin: diskutimi i rezultateve, përfitimeve dhe hapave në të ardhmen për ngritjen e koleksioneve gjenetike të gjermoplazmës së pemëve autoktone me metoda të avancuara bioteknologjike “in vitro”, si dhe për ngritjen e sistemit kombëtar të certifikimit të fidanëve të drufrutorëve autoktonë; evidentimi i rëndësisë së studimit, ruajtjes dhe përdorimit të gjermoplazmës të pemëve frutore autoktone për zhvillimin perspektiv të pemëtarisë biologjike dhe eko-touristike në zonat malore dhe kodrinore, në kushtet e progresit të agrobiznesit dhe agroturizmit; konceptimi i eventit edhe si “Festë e frutave”, që ka në fokus ekspozimin e varieteteve frutore autoktone dhe të egra për arsye të ri-interesit për ushqime lokale tradicionale dhe burime ushqyese “të harruara”, të konceptit “terroir” të lidhur edhe me trashëgiminë kulturore dhe të potencialit të këtyre produkteve me vlera ushqyese dietetike mesdhetare dhe me vlera terapeutike; mbajtja gjallë e traditave në brezat e rinj.



Veprimtaria u përshëndet nga kryetari i Akademisë së Shkencave akad. Skënder Gjinushi dhe titullarë të disa institucioneve të tjera të interesuara për problemin, të cilët theksuan domosdoshmërinë e kërkimit shkencor në ndihmë të zhvillimit të frutikulturës në Shqipëri, veçanërisht të asaj të mbështetur në varietetet autoktone me vlera specifike ushqyese, pjesë e traditës materiale kombëtare.

Akad. Efigjeni Kongjika, në bashkëpunim me grupin shqiptar dhe atë italian, referoi për rezultatet e projekteve të qendrës së kërkimit shkencor “Bioteknologji dhe

gjenetikë”, duke evidentuar objektivat themelore dhe përfitimet. Kërkuesit italianë kanë ndihmuar për të realizuar pjesën shkencore të procesit të certifikimit për fidanët e pemëve frutore autoktone me rëndësi jo vetëm për ekonominë, si kusht kryesor për ngritjen e çdo koleksioni apo bankë gjenetike për ruajtjen e gjermoplazmës së burimeve bimore dhe si kërkesë ligjore dhe e tregut evropian, tani më shumë se kurrë, kur Shqipëria ndodhet në procesin e anëtarësimit për në BE.

Referimi për rezultatet e projekteve të Akademisë së Shkencave në bashkëpunim me institucione shkencore brenda dhe jashtë vendit në fushën e ruajtjes së gjermoplazmës së drurëve frutorë autoktonë për krijimin e kriobankës së parë shqiptare, të emërtuar “Akademia” me metodën e kriokonservimit in vitro në azot të lëngët (-196°C)” u realizua nga prof. asoc. dr. Valbona Sota. Referimi i prof. M. Lambardit mbi përvojën pozitive të krijimit të kriobankës së parë për ruajtjen "in vitro" të gjermoplazmës së drurëve frutorë antikë në Itali shërbeu edhe për krahasim përvojash shkencore.



Paraqitja e përvojës pozitive për aplikimin e skemave të certifikimit për të krijuar koleksione gjenetike “mëmë” të specieve autoktone të drurëve frutorë, hardhisë dhe ullirit, duke zbatuar protokollet fitosanitare bashkëkohore, si dhe për të krijuar vreshtin autokton mëmë, duke zbatuar protokollet fitosanitare bashkëkohore, u bë nga prof. Magdalena Cara.

Për përvojën 20-vjeçare për mikroshumimin e pemëve frutore në laboratorin "in vitro" të QTTB referoi dr. Elektra Papakosta, referim që u vijua me një vizitë në këtë laborator për kërkimin eksperimental për prodhimin e fidanëve të certifikuar të varieteteve autoktone dhe ruajtjen e tyre në repozitorët “mëma” dhe në koleksionin e drurëve frutorë.

Referimi i Msc. Bajram Shera, bashkëpunëtor në projektet e ndryshme me përvojën e tij në ruajtjen "on farm" të gjermoplazmës së varieteteve autoktone të drurëve frutorë, u pasua nga ekspozita pomologjike si mikropanair me fidanë të pemëve frutore autoktonë, fruta të freskëta të stinës, fruta të thata të varieteteve frutore autoktone dhe gjermoplazmës së egër, produkte të tyre të përpunuara nga varietetet autoktone, si dhe bimëza in vitro të pemëve frutore autoktonë.

Në fund të veprimtarisë u miratua një rezolutë me rekomandime për institucionet shkencore dhe arsimore, si dhe për organet legjislative e ekzekutive për vlerësimin e kësaj trashëgimie me vlerë edhe për zhvillimin e agrobiznesit dhe agroturizmin, veçanërisht në kushtet e sotme të zhvillimit të vrullshëm të turizmit në Shqipëri.

Rezolutë e veprimtarisë

“Ekspozita pomologjike autoktone: kërkimi shkencor në ndihmë të zhvillimit të agrobiznesit në Shqipëri”



Akademia e Shkencave në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës,

Universitetin Bujqësor të Tiranës, Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore - Vlorë dhe bizneset private, organizuan këtë veprimtari, me qëllim:

a). Përgatitjen e fazës shkencore në funksion të skemës së certifikimit të fidanëve, implementimi i së cilës do të garantojë rritjen e cilësisë së produkteve të fidanishteve, me bimë të sigurta nga ana gjenetike dhe shëndetësore; b). sensibilizimin për domosdoshmërinë e implementimit të një sistemi shkencor të certifikimit për prodhimin e fidanëve të drurëve frutorë autoktonë, duke përfshirë dhe hardhinë dhe ullirin.

Të pranishmit (pjesëmarrësit e projektit, si dhe përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me strukturat vartëse të saj, të Këshillit Kombëtar të Agrobiznesit) propozojnë rekomandimet në vijim për mbështetjen e procesit të certifikimit të fidanëve të fondit autokton shqiptar:

1. Mbrojtja e pasurisë gjenetike nga erozioni i fondit autokton duhet të jetë në fokus të politikave të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Urban, Entit Shtetëror të Farërave dhe Fidanëve dhe institucioneve kërkimore. Implementimi i sistemit të certifikimit të varieteteve dhe kultivarëve autoktonë sipas modeleve të vendeve të BE me referencë Italinë, vjen si një kërkesë imediate për vendin tonë dhe është në funksion të sigurisë ushqimore dhe të agroturizmit.

2. Akademia e Shkencave, mbështetur edhe nga AKKSHI, po realizon disa projekte kërkimore, në të cilët bëjnë pjesë specialistë me përvojë për të pilotuar pjesën kërkimore të skemës së certifikimit të fidanëve të drufrutorëve autoktonë dhe për ruajtjen e materialeve gjenetike me anë të teknikave të avancuara bioteknologjike. Duke u nisur edhe nga kërkesat e biznesit për ngritjen e një sistemi certifikimi të kultivarëve autoktonë (kryesisht drufrutorë, vresht dhe ullirin), propozohet ngritja e një grupi teknik (kryesisht kërkimor shkencor) me specialistë që kanë përvoja në hallka të ndryshme të certifikimit si mbështetje për Ministrinë dhe institucionet, që e kanë detyrim ligjor sistemin e certifikimit.

Qëllimi është mbështetja për ngritjen e sistemit të certifikimit për kultivarët autoktonë, në pjesën kërkimore: seleksionimi klonal, pastërtia gjenetike, pastërtia sanitare, shëndetësimi, mikroshumimi, krijimi i burimeve primare etj., për promovimin e kultivarëve autoktonë në funksion të sigurisë ushqimore dhe agroturizmit.

Objektiva: implementimi i një modeli për sistemin e certifikimit për kultivarët autoktonë; mundësimi i krijimit të burimeve primare për kulturat me rëndësi historike dhe ekonomike për Shqipërinë; mbështetja me pjesën e kërkimit shkencor për pastërtinë gjenetike, sanitare, shëndetësimin dhe mikroshumimin; krijimi i protokolleve për secilën nga hallkat e sistemit.

Anëtarët e grupit kanë punuar në projekte të ndryshme kërkimore që në vitin 2001 dhe kanë rrjetin e tyre si edhe përvojat përkatëse për hallkat e ndryshme të sistemit

të certifikimit.

Mundësia e realizimit të objektivat nga grupi:

Duke qenë se implementimi i sistemit të certifikimit është një proces teknik-legjislativ, grupi teknik do të krijojë një lidhje të ngushtë me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe me institucionet përgjegjëse për sistemin e certifikimit sipas legjislacionit në fuqi. Në përputhje me disponibilitetin, grupi do të përgatisë programin duke u mbështetur në punën e kryer deri më tani, kapacitetet ekzistuese dhe shtrirje/qasje sipas potencialeve që do të diskutohen hap pas hapi.

Rekomandime për përbërjen e grupit në fushat:

1. Seleksioner i resurseve gjenetike autoktone;
2. Specialistë pomologë për të përcaktuar karakterizimin klonal në nivel morfologjik;
3. Specialistë gjenetistë molekularë për vërtetësinë gjenetike;
4. Specialistë të analizave fitosanitare, kryesisht viruseve me metoda molekulare për të arritur një nga stadet fillestare të certifikimit "e testuar nga viruset" me fokus "e certifikuar në BE";
5. Specialistë të shëndetësimin "in vitro";
6. Specialistë të mikroshumimit "in vitro";
7. Njohës të legjislacionit Italian dhe të BE-së;
8. Njohës të gjendjes dhe legjislacionit në Shqipëri;
9. Drejtues të shoqatave të biznesit të fidanishteve;
10. Farmerë vullnetarë për të qenë pjesë e skemave të certifikimit.

Ky grup mendohet të jetë në bashkëpunim të ngushtë për të krijuar sinergji me institucionet e linjës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për të filluar me sistemin e certifikimit të fidanëve të fondit autokton (ngritjen/mirëmbajtjen e burimeve primare, pemëtoreve "mëmë" etj. sipas hapave të certifikimit).

U mbajt ligjërata “Krijuesit e ndaluar në artet pamore: Edison Gjergo (1939-1989) dhe koha e tij” me studiuesen e artit Suzana Varvarica-Kuka

- Suzana Varvarica-Kuka: Edison Gjergo, me pikturën, mendimin dhe jetën e tij shkroi disidencën e vet, të cilën do ta trashëgojmë në historinë e artit shqiptar si koha e Edison Gjergos



Komisioni i përhershëm i arteve pranë Akademisë Shkencave të Shqipërisë, sot, më 12 korrik 2024, organizoi ligjëratën “Krijuesit e ndaluar në artet pamore: Edison Gjergo (1939-1989) dhe koha e tij” me studiuesen e artit Suzana Varvarica-Kuka.

Veprimtaria u moderua nga gazetari Mentor Kikia.

Akad. Vasil Tole, zëvendëskryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, përshëndeti të pranishmit dhe falënderoi ekspertin e shquar të arteve Suzana Varvarica-Kukën, e cila ka dhënë një kontribut të madh në studimin e veprave dhe autorëve të arteve pamore.

Akad. Tole vuri në dukje se kjo është veprimtaria e parë e komisionit të ristrukturuar të arteve, dhe bëri një prezantimin të shkurtër se çfarë përfaqëson komisioni i arteve, si një nga 11 komisionet e përhershme që funksionon pranë Akademisë së Shkencave, dhe që u dedikohet vetëm arteve shqiptare, ashtu sikurse

Qendra për Studimin e Arteve, një institucion i ri shkencor, që u ristrukturua për të vënë në fokus të studimeve artin dhe artistët shqiptarë.



Akad. Tole prezantoi ndërkohë përbërjen e komisionit të artit të përbërë nga akademikë dhe specialistë të fushave të ndryshme të artit: Vasil S. Tole, kryetar; Stefan Çapaliku, anëtar; Fatos Kongoli, anëtar; Josif Papagjoni, anëtar; Najada Hamza, anëtare; Suzana Varvarica-Kuka, anëtare; Altin Basha, anëtar; Denis Bizhga, anëtar; Namik Dokle, anëtar; Megi Tafaruci, anëtare; Abigeila Voshtina, anëtare; Belfjore Qose, anëtare.

Studiuesja e artit Suzana Varvarica, në ligjëratën e saj, prezantoi disa fakte rreth Shqipërisë së viteve 1940-1990; shkollat e artit në Shqipëri në vitet 1900-1940 si paraprijëse të shkollave të artit gjatë periudhës komuniste 1945-1990; shkollat e artit në Shqipëri në vitet 1945-1990 dhe programet e tyre; liceu artistik “Jordan Misja”; shkollat e artit në Shqipëri në vitet 1945-1990 dhe programet e tyre; Universiteti i Arteve etj., si dhe bëri një pasqyrim të trysnisë politike mbi artin në vitet 1940-1990. Më pas ajo prezantoi artistët e dënuar politikisht, grupimet dhe veçimin e tyre.

Varvarica bëri një përshkrim të zgjeruar të kohës që formoi Edison Gjergon, duke përshshkruar talentin, veprat, profilin e artistit dhe kalvarin e vuajtjeve të tij në

diktaturë, si më poshtë:

Edison Gjergo u rrit në fillesat e sistemit komunist, në mesin e një shoqërie të varfër e me mendësi feudale. Prindërit, Vangjel dhe Kornelia e edukuan me pikturën, muzikën klasike, jurisprudencën dhe historinë. Kornelia Gjergo ishte mësuese dhe Vangjel Gjergo kishte qenë zyrtar, jurist e nëpunës në shërbim të mbretërisë shqiptare.

Pas çlirimit, familja Gjergo u përshi në listat e familjeve me origjinë të pasur e shtresë e lartë. Sistemi komunist i veçoi, i dallooi dhe i mbajti në survejim e përgjim.



Edison Gjergo si adoleshent e nisi jetën me guxim, plot talent në vizatim dhe në pikturë. I dashur dhe i ditur me muzikën klasike. Ai u hodh pastërtisht në botën e artit, duke kërkuar të panjohurën rreth tij. Në vitin 1958 përfundoi liceun "Jordan Misja" dhe punoi duke pikturuar reklamat e filmave që shfaqeshin në kinematë e Tiranës, ku u njoh edhe me të kundërshtarë të sistemit komunist. Në këto mjedise filloi të komunikonte me të tjerë pikëpamjet e tij të kundërta ndaj mënyrës realiste, tradicionale e populiste të krijimit, që mbështeteshin në mundësitë e kohës dhe kultura e propagandës, të cilat nuk i pranonin kurrsesi lëvizjet dhe drejtimet artistike të artit modern european e më gjerë.

Koha e studimeve të larta ishte kohë e artë për të. Pedagogët e tij në ILA e

vlerësonin pozitivisht dhe e dallonin për një talent të rrallë. Ai ishte i lirë. Krijimet e tij kishin një atmosferë figurative "modern revolucionare", që dallonte nga atmosfera e ngurtë dhe përshkruese e realizmit socialist. Këtë ai e besonte dhe nuk e parashikoi dënimin dhe persekutimin artistik.

Përndjekja e tij ka nisur nga fundi i vitit 1968, kur Edisoni kishte filluar të krijonte dhe jetonte në mënyrë liberale, i kënaqur me aftësitë e veta, por i pakënaqur nga niveli social dhe artistik i shoqërisë së mbyllur shqiptare. Ai kishte filluar të fliste hapur me disa individë, ndërmjet tyre dhe me përndjekësit e paguar të sigurimit të shtetit. Erdhi një kohë që veprat e tij nuk pranoheshin në ekspozita. Ato kritikoheshin nga anëtarët e komisioneve të LSHA.

Edison Gjergo u dënua nga gjykata popullore si fajtor për krimin e agjitacionit dhe propagandës kundër pushtetit dhe se "ka mburrur artistët e rrezikshëm modernist Frojdin, Shagallin, Sartrin, Kamy, Pikaso e tjerë ... ka bërë piktura të ndryshme me përmbajtje moderniste e dekadente".



Edison Gjergo u stërmundua disa vite në burgun e Spaçit, i cili ishte një kamp i tmerrshëm vuajtje dhe pune të stërmundishme. Edison Gjergo u lirua nga burgu më 15 nëntor 1982. Pas burgut jetoi vetëm 7 vite. Ishte një njeri tjetër nga Edisoni i viteve 1970. Punoi si punëtor mirëmbajtje, shkrues parullash. U mbyll në vetvete si një njeri i humbur, nën një disekulibër shpirtëror. Ishte i frikësuar, i pashpresë, I pafuqi. Ishte pa miq e shokë. Pas një jete të zvarritur, i martuar, me gruan shtatzënë, plot brenga sociale,

i parehabilituar, i cilësuar armik, i braktisur nga kolegët dhe miqtë, i sëmurë rëndë ndërroi jetë më 26 qershor 1989.

Në ditët e sotme, duke njohur jetën dhe krijimtarinë e tij, Edison Gjergo është produkt i besimit në vetvete, i qëndrueshmërisë krijuese, i guximit për të mos u nënshtruar, i mosbesimit në marrjen e masave të egra dhe ekstreme ndaj tij; i vuajtjeve, kërcënimeve dhe i nënshtrimit në burg; i mungesës së forcës për të shmangur degradimin psikologjik e social dhe i një shoqërie që nuk e mbështeste dhe e ndihmonte individin, nuk protestonte e kundërshtonte, por ishte e nënshtruar.

Edhe pse në ditët e sotme trashëgojmë pak vepra, sepse studio e tij u bastis dhe veprat u eliminuan gjatë procesit hetimor, përsëri në sipërfaqen e tyre shohim përmbajtje të lidhura ngushtësisht me kërkesat e temave që sugjeronte LShASH.

Ai, sipas kërkesës së kohës, pikturoi partizanë, punëtorë, fshatarë dhe heronj, por i perceptoi në mënyrën e tij si një artist që vlerësonte pavarësinë dhe individualitetin artistik të shprehjes së formës figurative. Përmes disidencës, veprave dhe qëndrimit të guximshëm për të mos e ndryshuar perceptimin figurativ modern ndaj subjektit dhe përmbajtjes socialiste dhe të 7 viteve të trishtuara të jetës së pasburgut, Edison Gjergo krijoi kohën e tij.

Ai dhe një grup artistësh të rinj dëshironin një mënyrë të ndryshme dhe rrugë të reja për zhvillimin e arteve pamore. Koha dhe sistemi nuk bënë asnjë kompromis me dëshirat e tyre dhe Edison Gjergos, Ali Osekut dhe Maks Velos nuk iu dha dora, nuk i shpëtuan dhe nuk e justifikuan rebelizmin e tyre.

Edison Gjergo në një moshë aktive dhe plot energji ishte një shpirt i lirë, karakteristikë e grupit të artistëve të rinj e të ndaluar të asaj kohe. Ai u përpoq ta pasuronte pikturën me elemente të artit të avangardës europiane dhe t'i pasqyronte figurativisht subjektet e jetës socialiste me elemente të një forme të ndryshme nga elementet e formës që sugjeronin parimet e metodës së realizmit socialist. Ai krijoi atmosferën e tij përmes imazhit ndjesor të nënvetëdijes figurative, për të cilën mendoj se është burim i qëndrueshmërisë së artistit dhe artit të tij.

Një nga deklaratimet e tij në hetuesi, zbulon personalitetin e tij artistik dhe intelektual:

“Të them të drejtën, fjalën "socialist" që vjen pas fjalës "realizmi", nuk e kuptoj; realiteti objektiv në art nuk ekziston, sepse nuk ekziston një realitet i tillë as si koncept në art. Arti është realitet i ri, që preket nga artisti dhe shijohet fortësisht nga njeriu”.

Edison Gjergo, me pikturën, mendimin dhe jetën e tij, shkroi disidencën e vet, të cilën do ta trashëgojmë në historinë e artit shqiptar si koha e Edison Gjergos.

Veprat e pakta të Edison Gjergos:

“Heroina Zonja Çurre”, 1966, GKA;

“Lavdi dëshmorëve”, para viteve 1969, vepër e humbur;

“Fonditori”, 1971, GKA;

“Portret malësoreje”, 1972, GKA;

“Epika e yjeve të mëngjesit», 1971, GKA;

Vepra e fundme “Epika e yjeve të mëngjesit», shenoi fatalitetin dhe famën në jetën e artistit. Ajo tregoi mënyrën e ndryshme dhe të guximshme të pasqyrimin vetjak gjeometriko-kubist përmes ekzekutimit të ngjyrës ekspresiviste-foviste në kohën e metodës së realizmit socialist. Një vepër që ruan befasinë kompozicionale dhe koloristike. Ajo ruan marrëdhënien e subjektit të temës së madhe të luftës (socialiste e kohës) me epikën dhe legjendën e hershme.

Vepra bënë të dukshme subjektin dhe formën figurative të lexueshme por jo realiste. Ajo është një nga veprat kryesore dhe të rëndësishme të artit shqiptar që dëshmon vitet 1969-1973, dëshmon krijimtarinë e Edison Gjergos dhe përfaqëson kulmin e artit të artistit. Ajo dëshmohet si pikturë përfaqësuese e modernizmit në periudhën më të egër të diktaturës.

Mbijetesa e "Epikës ...“ është shenja e ekzistencës së kohës së Edison Gjergos dhe e të gjithë artistëve të ndaluar e të persekutuar në të tashmen e sotme dhe në të tashmet e ardhshme.

Kjo vepër ka skalitur përpjekjet dhe përvojat e këtyre artistëve në historinë e Shqipërisë, si shenjë e providencës së shpirtit të lirë të artistëve, që nuk u nënshtruan, por të lirë sfiduan: metodën e imponuar, megamakinën kulturore mosovike, diktatorët, LShASH dhe sistemin komunist.

Në fund të ligjëratës së saj studiuesja Suzana Varavarica-Kuka bëri edhe një vlerësim kritik të pasviteve 1990 ndaj artistëve të persekutuar.

"Vendbanimet e bashkisë së Korçës: probleme dhe zgjidhje"

- Simpozium shkencor i organizuar nga Akademia e Shkencave dhe Universiteti "Fan S. Noli" i Korçës, 24 tetor 2024 -
- Nis puna për projektin "Vendbanimet urbane të Shqipërisë, që do të përmbillet me një studim monografik -
- Thirrja për pjesëmarrje u drejtohet gjeografëve, demografëve, urbanistëve, specialistëve të rregullimit administrativ dhe gjithë të interesuarve -



THIRRJE PËR PJESËMARRJE

Universiteti "Fan S. Noli" Korçë, në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, organizojnë:

SIMPOZIUMIN SHKENCOR

VENDBANIMET E BASHKISË KORÇË - PROBLEME DHE ZGJIDHJE
(24 Tetor 2024)

Në vijim të Konferencës Shkencore "Qendrat e banuara të Shqipërisë – gjendja dhe e ardhmja" (Elbasan, 17 dhjetor 2021), të organizuar nga Akademia e Shkencave dhe dy universitete: Aleksandër Xhuvani, Elbasan dhe Eqrem Çabej Gjirokastrë, do të zhvillohet Simpoziumi Shkencor "Vendbanimet e bashkisë së Korçës, problemet dhe zgjidhja", frut i bashkëpunimit të Universitetit "Fan S. Noli" Korçë me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë. Në zbatim të konkluzioneve të kësaj konference, simpoziumi shkencor, duke u fokusuar në metodologjinë e analizës shkencore të problemeve komplekse të vendbanimeve të bashkisë së Korçës, qëllim të studimit të qendrave të banuara të vendit tonë. Ai shënon fillimin e zbatimit të projektit studimor "Vendbanimet e Bashkisë së Korçës", të drejtuar nga Departamenti i Histori-Gjeografisë të Universitetit të Korçës.

TEMAT E REFERENCËS

- Pozita gjeografike si bazë për lindjen, zhvillimin, jetëgjatësinë dhe shpërndarjen e vendbanimeve në Bashkinë e Korçës.
- Roli i kushteve gjeografiko-natyrore (relievi, klima, ujërat, pasuri minerare, bota e gjallë, trashëgimia natyrore, rreziqet natyrore) në lindjen, shpërndarjen dhe evolucionin e vendbanimeve në bashkinë e Korçës; mandësitë e komunikimit, marrëdhëniet me vendbanimet e hapësirat e afërta e të largëta.
- Faktorët gjeografiko-historikë e kulturorë në krijimin e funksionimit e vendbanimeve. Historia e popullimit, lindja dhe etimologjia, fazat historike të zhvillimit dhe të evolucionit deri sot.
- Popullsia, vendbanimet dhe politikat demografike: ecuria e numrit të popullsisë, përqendrimet e saj; shtimi natyror, migrimet dhe faktorët natyrorë, socialë, politikë, shëndetësorë etj., pasnjat e tyre; strukturat sasimore e cilësore të popullsisë, grupet etnike; cilësia e jetës, gjendja sociale, shëndetësore e arsimore; kultura, traditat; trashëgimia kulturore (materiale dhe jomateriale).
- Klasifikimi i vendbanimeve sipas origjinës, vendndodhjes dhe funksioneve. Vendbanim i vjetër apo i ri, fushor, kodrinor apo malor, me funksione banimi, pushimi, prodhues, aktivitete shërbimi, kompleksi i botës së punës të qytetit/fshatit. Tipologjitë bazë të funksioneve, roli dhe perspektiva e tyre funksionale; tipi i

Në vijim të rezultateve të shenjura gjatë konferencës shkencore "Qendrat e banuara të Shqipërisë - gjendja dhe e ardhmja" (Elbasan, 17.12.2021), organizuar nga Akademia e Shkencave dhe Universiteti "Aleksandër Xhuvani" i Elbasanit e "Eqrem Çabej" i Gjirokastrës", po përgatitet simpoziumi shkencor "Vendbanimet e bashkisë së Korçës: probleme dhe zgjidhje", bashkëpunim i Akademisë së Shkencave me Universitetin "Fan S. Noli" të Korçës.

Duke u fokusuar në metodologjinë e analizës shkencore të problemeve

komplekse të vendbanimeve të bashkisë së Korçës, ky simpoziум shenjon fillimin e zbatimit të projektit studimor “Vendbanimet e bashkisë së Korçës”, projekt universitar.

Rezultatet e simpoziумit dhe në vijim të projektit do të çelin rrugën e studimit të gjitha qendrave të banuara të vendit tonë dhe përgatitjen e një botimi monografik të munguar.

Komiteti shkencor-organizues fton studiuesit e qendrave të banuara dhe të gjithë të interesuarit (gjeografë, demografë, urbanistë, specialistë të rregullimit administrativ) të japin ndihmesën e tyre me referime shkencore në këtë simpoziум, që do të zhvillohet më 24 tetor 2024.

Thirrja publike për pjesëmarrje edhe në faqen zyrtare të Universitetit "Fan S. Noli" të Korçës

Kërkimet arkeologjike në vendbanimin neolitik "Lin 3" rikonfirmojnë hershmërinë e tij: më i vjetri në llojin e tij

- Kryetari i Akademisë së Shkencave takohet me specialistët e ekspeditës së përbashkët shqiptaro-zvicerane, bashkëpunim disavjeçar midis Institutit të Arkeologjisë të ASHSH dhe Universitetit të Bernës (Zvicër)

- Profesorët Albert Hafner e Ilir Gjipali informojnë kryetarin Gjinushi për zbulimin, arritjet dhe vazhdimin e projektit



Më 26 korrik 2024 kryetari i Akademisë së Shkencave akad. Skënder Gjinushi takoi pjesëtarët e ekspeditës arkeologjike shqiptaro-zvicerane që po zhvillon kërkime prej disa vitesh në vendbanimin neolitik të Linit.

Fillimish ai u njoh nga afër nga bashkëdrejtuesi vendës i ekspeditës z. A. Anastasi me gërmimet në terren dhe më pas vizitoi vendgërmimin nënujor në liqen, kampin bazë për përgatitjen e zhytësve nënujorë, ambientet e punës dhe përpunimit të bazës materiale të nevojshme për zhytje, si dhe një pjesë të materialit arkeologjik të zbuluar.

Drejtuesit e ekspeditës e informuan akad. Gjinushin për të dhënat për përpunimin e materialit arkeologjik për të siguruar e ruajtur gjithë informacionin

shkencor nëpërmjet një dokumentacioni të standardizuar.



Gjatë vizitës pati diskutime për shumë probleme që kanë të bëjnë me teknikat e metodat e gërmimit me specifikat që ka kërkimi nënujor; me analizat laboratorike që kërkojnë bashkëpunimin e shumë specialistëve (duke filluar me specialistët për gërmimin nënujor, gjeoambientalistët për analizat e C14, dendrokronologjistët, specialistët për studimin e qeramikës e të veglave prej guri e stralli, për objektet kultike, faunën e florën, antropologë etj.), për të realizuar kështu një studim shumëdisiplinor.

Kryetari Gjinushi vlerësoi punën e rejtuesve dhe të specialistëve të përfshirë në projekt për zbulimet e rëndësishme dhe i inkurajoi ata për të vazhduar kërkimin në këtë vendbanim neolitik edhe në vitet e ardhshme. Akad. Gjinushi u shpreh se ASHSH është e gatshme për veprimtari shkencore të përbashkëta me Universitetin e Bernës jo vetëm me studiuesit arkeologë, por edhe në një rreth më të gjerë. Ai kërkoi të vlerësohet nevoja për t'ia bërë të njohura zbulimet në vendbanimin e Linit edhe publikut të interesuar.

Projekti i kërkimeve nënujore "Lin 3" është bashkëpunim midis Institutit Arkeologjik të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Universitetit të Bernës (Zvicër). Profesorët Albert Hafner (për palën zvicerane) dhe Ilir Gjipali rikonfirmuan se vendbanimi i Linit është vendbanim palafit (liqenor) dhe shtrihet kryesisht nën ujë dhe pjesërisht edhe në tokë, si rezultat i mbushjeve që kanë ndodhur gjatë mijëra vjetëve nga depozitimet e dherave të gërryera nga kodrat përreth.

Rezultatet e kërkimit të viteve të mëparshme (2021, 2022 dhe 2023) dhe analizat laboratorike të kryera në Universitetin e Bernës në Zvicër, si dhe ato në bashkëpunim

me Universitetin e Oksford-it në Angli, treguan se vendbanimi palafit (liqenor) "Lin 3" është vendbanimi më i vjetër i këtij lloji në Europë.



Gërmimet e 2024 shënojnë përfundimin e fazës së parë të projektit në "Lin 3". Gërmimet katërjavore në tokë (24 qershor - 21 korrik 2024) vlerësohen si shumë të suksesshme për sasinë dhe shumëllojshmërinë e materialit arkeologjik (palafite, qeramikë, vegla prej guri, stralli e kocke, mbetje bimore, kocka kafshësh shtëpiake e të egra etj.), të cilat janë objekt studimi në vazhdim nga specialistët e projektit. Faza e dytë e gërmimeve të këtij sezoni lidhet me gërmimet nënujore brenda në liqen, që do të vazhdojnë katër javë të tjera (deri më 18 gusht).

Gërmimet e këtij viti ekspedita shqiptaro- zvicerane po i orienton në njohjen e mëtejshme të shtrirjes së vendbanimit, kohëzgjatjen, kulturën materiale e shpirtërore të banorëve neolitikë, kompleksitetin e ndërtimeve të këtyre vendbanimeve liqenore; si dhe në aspekte të ekonomisë bujqësore e blegtorale dhe të raporteve kulturore e kronologjike me vendbanimet e këtij lloji në trevat përreth (në pellgun e Korçës, Greqinë Veriore e Maqedoninë e Veriut).

Po përgatitet ndërkaq dokumentacioni arkeologjik i nevojshëm për venien në mbrojtje dhe shpalljen e tij zonë arkeologjike nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

Marrëveshje bashkëpunimi

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Shërbimit Gjeologjik Shqiptar



Kryetari i Akademisë së Shkencave akad. Skënder Gjinushi dhe dr. Adrian Bylyku, drejtor i përgjithshëm i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, nënshkruan sot marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve.

Të pranishëm anëtarët e Kryesisë të Akademisë dhe drejtuesi i njësisë kërkimore të gjeoshkencave dhe gjeoinxhinierive akad. asoc. Rrapo Ormëni.

Para nënshkrimit u bisedua rreth mundësive që krijon marrëveshja për bashkëpunim ndërinstytucional, tashmë me një kornizë të qartë juridike. Kryetari Gjinushi theksoi se marrëveshja siguron bashkimin e kompetencave shkencore duke ruajtur secila palë autonominë e vet. Njësia e gjeoshkencave dhe gjeoinxhinierive, me rreth 80 bashkëpunëtorë nga këto fusha në Shqipëri, në Kosovë e në Maqedoninë e Veriut, ndërvepron edhe me specialistë të Shërbimit Gjeologjik, por ka rëndësi që të kalohet nga bashkëpunimi individual në atë mes institucioneve.

Ligji i ri për shkencën, tha në vijim akad. Gjinushi, që Qeveria e ka miratuar dhe tani pret diskutimin e miratimin në Kuvend, ofron më shumë mundësi për nisma të përbashkëta shkencore, për aplikime bashkërisht për projekte.

U theksua ndër të tjera hartimi i hartës së re gjeologjike të Shqipërisë dhe përmbi kufij, sepse e tillë është nëntoka; studimi i teknologjive të reja në njohjen, kërkimin dhe shfrytëzimin e pasurive minerare; zgjerimi i konceptit të gjeologjisë në përputhje me

ndryshimet që kanë ndodhur në botë, theksoi në përmbyllje akad. Gjinushi.

Drejtori i përgjithshëm i Shërbimit Gjeologjik dr. Adrian Bylyku falënderoi Akademinë e Shkencave për ftesën për bashkëpunim me marrëveshje. Dikur gjeologjia kuptohej si degë e ekonomisë për zbulimin, nxjerrjen dhe përpunimin e mineraleve, tha në vijim ai, kurse sot flitet për gjeoshkenca, ku përfshihet edhe gjeomjedisi, hidroinxhinieritë, gjeoturizmi etj. Ai vlerësoi se marrëveshja do të japë frytet e veta sepse kemi gatishmërinë të ndërmarrim nisma e projekte të përbashkëta, kemi dhe kapacitete njerëzore dhe mbi të gjitha e dimë se Akademia e Shkencave është koordinuese e suksesshme në kuadër të gjithë sistemit të kërkimit shkencor në shkallë vendi.



Me këtë marrëveshje palët i sigurojnë njëra-tjetrës shkëmbim të ndërsjellë të informacionit shkencor, të periodikëve që botojnë, të studimeve dhe monografive. Ato shkëmbejnë ekspertiza dhe mbikëqyrje të përbashkëta të veprimtarisë shkencore në ekspedita dhe në kërkime. Bashkëpunimi sipas kësaj marrëveshjeje realizohet edhe nëpërmjet projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare me interes të dyanshëm; pjesëmarrjes në konferenca, simpoziume dhe tryeza shkencore me interes të përbashkët; informimit reciprok për aplikime me interes dypalësh. Palët bëjnë bashkërisht kërkime në fushën e gjeoshkencave. Për rezultatet e veprimtarive të përbashkëta shkencore palët ofrojnë mundësi për publikimin e tyre me përparësi në periodikët shkencorë.

Vlerësime

Akademia e Shkencave e Shqipërisë uron soprano shqiptare Ermonela Jaho me famë botërore, anëtare e jashtme e saj, për dekorimin me medaljen “Kalorës i Urdhrit të Arteve dhe Letrave” në Francë

Ermonela Jaho, sopranoja shqiptare me famë botërore, anëtare e jashtme e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, dhe këngëtari italian i operës Roberto Scandiuzzi, i shquar për zërin e tij të kumbueshëm bass, janë dekoruar me medaljen “Kalorës i Urdhrit të Arteve dhe Letrave” nga Ministria e Kulturës në Francë.



“Dy karriera të jashtëzakonshme, dy artistë të mëdhenj dhe dy njerëz të mrekullueshëm, karrierën e të cilëve ne e kemi ndjekur prej dekadash!”, shkruhet në faqen zyrtare të "Backstage Opera Management".

Sopranoja shqiptare me famë botërore, Ermonela Jaho, ka performuar në operat me prestigjioze të botës, duke përfshirë "Royal Opera" në Londër, "Metropolitan Opera" në Nju Jork, "Berliner Statsoper"; Paris Champs Elysees, Teatro San Carlo di Napoli, Opera Kompania e Filadelfias, Opera e Marsejës, Arena di Verona, Teatro Verdi di Trieste, Teatro La Fenice, Teatri Capitoul de Toulouse etj.

Këngëtari italian i operës Roberto Scandiuzzi shquhet për zërin e tij të fuqishëm bass dhe interpretimet e shumta në skenat botërore, dhe një karrierë të gjatë mbi 40-vjeçare.

Botime të reja

**"Studime antropologjike në etnokulturë" nga Shaban Sinani, botim i
Akademisë së Shkencave, Tiranë 2024**



Nga vlerësimet e dy recensuesve:

1. Arian Leka:

Leximi i veprës "Studime antropologjike në etnokulturë" e ofron qartazi mendimin se kemi të bëjmë me prurje të reja, zgjerim e thellim të mëtejshëm të korpusit shkencor mbi antropologjinë, i cili prej vitesh ka marrë vëmendje të veçantë në studimet e Shaban Sinanit.

Optika e të qëmtuarit të hollësishëm edhe mbi çështje të mëhershme, të tilla si kanuni dhe statutet, historiku i Shkrimeve të Shenjta dhe gjithçka tjetër që përbën objektin e trajtimeve shkencore mbi dijen antropologjike, në këtë vepër zgjerohet si

vështrim dhe thellohet si kërkim mbi etnokulturën, antropletërsinë dhe antropogjuhësinë.

E konceptuar në tri pjesë dhe e plotësuar me një shtojcë, vepra përfaqëson një tjetër kontribut të çmuar të studiuesit, i cili trajton me kompetencë të lartë shkencore trashëgiminë e kulturës shqiptare, duke sjellë zbulime e këndvështrime të reja, si dhe plotësime më të përimtësuar mbi çështje të etnonimeve, mikrotoponimeve dhe vëzhgimeve se si është zhvilluar kultura shqiptare përkrah asaj europiane ("Chanson de Baligant" / "Këngën e Rolandit"; miti iluminist i përhapjes së dijes përmes tipografisë, njohja me "tjetrin" dhe gjuhën e tij), duke përfshirë edhe kontributet në rrafsh krahasimtar ("Naimi dhe Rumi sipas Musine Kokalarit"; "Kanoni dhe kanuni në mitologjinë e Fishtës").

Paradigma e kërkimeve në fushë të dijes albanologjike zgjerohet përmes pjesës së dytë, me studimet në etnokulturë e letërsi, që kanë në vëmendje aspekte të veçanta të personalitetit krijues të Muhamet Kuçukut, Fan Nolit, Etëhem Haxhiademit, Migjenit; apo që hedhin dritë mbi dokumente arkivore të pavëzhguara më herët (rasti i dorëshkrimeve të Santorit); si dhe interpretime mbi këngë të moçme shqiptare e prurje në fushë të historishkrimit lidhur me figura të tilla si V. Prennushi, G. Crispi, përfshirë këtu edhe qasjet krahasimtare mes Migjenit, Mekulit dhe Kosovel-it, si dukuri kulturore ndërballkanike.

Pjesa e tretë e veprës përfshin studime mbi procese të tjera, krejt specifike, brenda zhvillimeve moderne të letërsisë shqiptare, si rasti i autorecensionit në romanet e Kadaresë, dimensionin historik e dokumentar në prozën romanore të Petro Markos, vendi që zë "Saga ballkanike" e Luan Starovës në kritikën letrare franceze etj., të cilat nuk lënë jashtë vëmendjes edhe dukuri të tilla si vëzhgimi kritik mbi paraqitjen e shembëlltyrës ungjillore në letërsinë e Dhimtër Anagnostit.

Me vlerë të veçantë si qasje dhe si pasuri bibliografike e kërkimore me bazë në literaturën shkencore dhe në arkiva paraqitet shtojca mbi etnokulturën, që përmbyll veprën, ofruar përmes një dokumentimi të gjerë që autori u bën studimeve historike, bashkëkohore e të hapura për thellimeve të mëtejshme mbi ritet, festat pranverore, këngët pagane apo ato me frymëzime religjioze, si pjesë domethënëse e kulturës shqiptare.

Vepra "Studime antropologjike në etnokulturë" ka një aparat shkencor mjaft të pasur në burime, përmban argumentime të thelluara dhe është shkruar më gjuhë të zgjedhur, që jo vetëm lehtëson komunikimin me tezat dhe propozimet, por bën të mundur që edhe dija e thellë shkencore të lexohet si letërsi.

2. Gjovalin Shkurtaç:

Ky libër me studime vjen me shqyrtime të rëndësishme e me vlerë aktuale jo

vetëm për antropologjinë kulturore, po edhe për gjuhësinë, sidomos për antroponiminë dhe disa dukuri të të folmeve të shqipes si ajo e Reç-e-Dardhës së Dibrës .


Libri ka një hapësirë të gjerë tematike, por është parashtruar qartë e natyrshëm, me një sythëzim të tillë të hapët të trajtimit që lejon t’u japë përgjigje shumë problemeve të deritanishme të pazgjidhura ose të patrajtuara mjaftueshëm në antropokulturën dhe letërsinë shqiptare. Ai ka mëtimin e lakmueshëm të sjellë një përpjekje krejt të re për të rrokur një këndvështrim të ndryshëm dhe për të ndriçuar anë deri më sot të kaluara shkarazi ose të papërfillura.

Libri ka studime e artikuj të shkruar me stil të përshtatshëm e terminologji të saktë, sikundër "e ka në thua" Shaban Sinani, i cili është sa prodhimtar, aq edhe i kujdeshëm për qartësi e hijeshi ligjërimore; ndonjëherë edhe ka krijuar terma të rinj, që i shkojnë për shtat shtjellimit e synimit për ta bërë trajtimin edhe sa më aktual e të atillë që të jetë në emërues të përbashkët me monografitë studimore me profesionalizëm të theksuar e pa dyshim të lakmueshëm e të vlerësueshëm.

Në të gjitha këto shqyrtime autori ka ruajtur etikën e duhur dhe krejt vepra, përveç sa sjell me brendinë a përmbajtjen e studimeve dhe artikujve të përfshirë në të, jep gjithashtu një shembull të vlerësueshëm të seriozitetit e përkushtimit të plotë të autorit ndaj tematikës së zgjedhur, si dhe të “peshores” së drejtë që ka përdorur për pohimet e prurjet e pararendësve.

Ky libër çmohet për vlerat mirëfilli shkencore, ashtu edhe nga prurjet konkrete nga hulumtime të kujdeshme e të ngjeshura dhe me shqyrtime të gjera e të arsyetuara, si dhe për frymën aktuale të trajtimit të shumë prej dukurive të trajtuara në të.

"Publicistë të Rilindjes", nga prof. Hamit Boriçi - shtohet një botim tjetër i rëndësishëm në dobi të "Enciklopedisë shqiptare"



- Botimet enciklopedike krahinore dhe tematike, fjalorët dhe leksikonët e profesioneve dhe disiplinave - burim të dhënash për përzgjedhje për redaksitë e fushave
- Së afërmi nga i njëjti autor edhe "Shtypi i arbëreshëve"
- Personalitete të gati një shekulli në publicistikë, themelues e botues të tribunave më të hershme të shtypit shqiptar, rrjedha e zhvillime të mendimit kombëtar gjatë Rilindjes - në këtë libër të prof. Hamit Boriçit

“Nga religjioni tek letërsia”, për librin e Shaban Sinanit “Antropologji e religjionit”

Disa fragmente nga studimi në “exLibris” i prof. dr. Josif Papagjoni

Në kolanën e monografive mbi antropologjinë kulturore, e konceptuar në katër njësi monografike: “Antropologjia e identitetit”, “Antropologjia etnojuridike”, “Antropokulturë e antropogjuhësi” dhe “Antropologjia e religjionit”, veçova këtë të fundit për faktin e një lidhjeje më të drejtëpërdrejtë me letërsinë shqipe.

Vepra dhe mendja e studiuesit shkojnë fill te burimet dhe vijnë prej andej në një formë mbushamendëse. Skeptri i tij është autoritar, veçse jo dogmatik. Ja, kam në duar një strukturë argumentimi e vlerësimi që më bind në idetë e shqyrtuara, në ato që janë mish e kockë shqiptare; më tutje shijoj të shkruarit, një shqipe e krehur që i rri hijshëm argumentit. Dhe, mbi të gjitha, cilësia e të menduarit, e cila është e tëra dhe mirëfilli një hipostasi estetike e filozofike se si koncepti religjioz gjen hapësira në vetëshprehjen etnike e në letërsi, si transcendentohet dhe si shndërrohet në një idiolekt të shumëfishtë.



Libri është konceptuar në dy pjesë, në dukje si më vete e të largëta, por saora ti sheh se ato janë konvergjente dhe ushqejnë njëra-tjetrën, sidomos pjesa e parë - të dytën. Në nyjat e para antropologu Shaban Sinani epohet kah historiani dhe deri diku kah teologu i religjioneve sunduese në Shqipëri, filluar qysh nga kumtimet apostolike të

botërore. E gjitha kjo vjen përmes një emocioni të përmbajtur prej autorit, i cili ishte aktor në këtë ekspozim me njohje ndërkombëtare.

Në nënkapitullin “Et pluribus unum”, një nga nyjat që e dimensionon dukshëm brendinë e librit, autori shtjellon me një qartësi që nuk lë dyshim dukurinë unike të konvergencës fetare ndër shqiptarë, një fenomen ky aspak i shfaqur përjashtimisht nga prania e faktorit të ri kulturor dhe religjioz në Ballkan në shekullin XIV, pra, nga pushtimi osman dhe feja myslimane që u transportua aty. Toleranca ka qenë veti e brendshme e të sjellurit të shqiptarëve, jo thjesht dhe vetëm pasojë, të themi e skizmës së madhe të Krishterimit dhe “Vijës së Teodosit”, çka rezultoi, siç dihet, me ndarjen e trojeve tona në dy administrime të ndryshme.

Vetëm nga çka sheh te kodikët shqiptarë që nga shekulli IV e deri në shekullin XV vërtetohen pikërisht shpirti ekumenik dhe afeksionet e matura të shqiptarëve ndaj besimeve alternative të Krishterimit, fakt që flet për konvergencën dhe ekumenizmin e tyre si vetëdije ekzistente dhe në pjekje,

Të një rëndësie të jashtëzakonshme ishin pesë nismat e Papa Clemente XI për njohjen e arbërorëve, dikur të quajtur ilirë, epirotë e maqedonë. Kjo nyje, përveç spërndritjes dokumentare, ka dhe shumë kureshtje. Vjen si një apel për të rrëmuar më tej në arkivat e Vatikanit. Ende nën tyntajat e injorimeve, mosnjohjeve dhe konvertimeve, pesë nismat e këtij Pape të iluminuar rreken ta nxjerrin nga pluhuri i harresës kombin shqiptar.

Pjesa e dytë e librit përqendrohet në raportin midis letërsisë shqipe me Shkrimet e Shenjta. Nuk mund të thuhet se në studimet tona kjo temë është e virgjër, e pacekur nga autorë e studime të tjera, madje dhe në libra. Fjala është te mënyra e të këqyrurit. Sidomos mprehtësia për të nxjerrë në spikamë përqasjet, që nuk lidhen thjesht me subjektet e veprave dhe shtysat e tyre, as vetëm me simbolikën, lëndën mitologjike dhe metaforat biblike, të cilat risemantizohen në realitetin e fundmë shqiptar, posaçërisht dhe në atë letrar si të tillë. Fjala tanimë është për një vështrim të përimtuar, që shkon te zanafillat, zbulesat, kuptimet e fshehta dhe pushteti riciklues i universales, sikundër edhe një pranëvënie tekstesh të përkthyer siç bëhet me “Canticum Canticorum” (“Kënga e këngëve”), ku realizohen pranëvënie që nga Buzuku të “Meshari” i tij, mëpastaj te përkthimi kanonik i Dom Simon Filipajt, ku ka pak sensualitet, dhe te versioni i shpenguar i Mitrush Kutelit, ku ky sensualitet është më aktiv.

Në leximin ndryshe të poezisë së Nolit mendimi prijës i Sh. Sinanit cytet nga ideja se ajo nuk mund të identifikohet më si dukuri e retorizmit të kulturës apo thjesht si mjet i revolucionit. Klisheja këtu thyhet. Sipas tij, duhet tejkalluar “mënjanimi i heshtur i Nolit, duke ua kufizuar leximin vetjak poezive të tij; duke i shmangur prej receptimit mirëfilli estetik e duke programuar në vend të tij një lexues të gatshëm për lexim retorik, oratorik e doktrinar; ose duke ua paracaktuar rrugën e komunikimit të

tyre si poezi të shkruara për dëgjim; duke mos ia njohur njeriut politik të drejtën për të pasur një un poetik të tij”.

Pikërisht në këto pesë qasje, studiuesi argumenton dhe propozon që poezia e Nolit të lexohet ndryshe, jo në mënyrë njëlinjore, as si “dukje e parë”. I kujdesshëm në gjetjen e ekuilibrit ai propozon që shpërfillja e kontekstit social, njësoj sikurse ngujimi brenda një subjektiviteti ekstrem, duhet të shmangen që të dyja. I kthjellët dhe gjegjësisht dioptrisë estetike, studiuesi ngulmon se “Albumi” i Nolit nuk mund të interpretohet fatalisht i lidhur me kontestualizimin e qenies së tij si kryeministër i qeverisë së dalë nga i ashtupërcaktuari “revolucion i vitit 1924” apo nga kinse prirja e tij drejt së majtës politike dhe kinse simpatia për bolshevikët. Ky është produkt i qasjes politike, jo i së vërtetës. Veçanërisht poezitë biblike, shkruar në harkun kohor 1926-1932, paçka se asociacionet dhe alegoritë lidhen pazgjidhshëmrisht me realitetin shqiptar të kohës dhe ndjeshmëritë e saj politike, nga ana tjetër ato kanë brenda shpirtin, rrumbullakësinë dhe ontologjinë e tyre, tashmë si poezi, si struktura mentale, si flukse ndjesore, përputhur kodeve poetike.

Kësodore cikli bibliik i vjershërimit nolian përfton karakterin e merituar mbikohor, universal, vjen si bulb poetik zanafillor, duke tejkalluar ngjarjet konkrete politike të Shqipërisë dhe të vetë Nolit si personalitet i kohës. Ato shkëputen vetiu prej konteksteve revolucionare, shpesh të sforcuara, dhe gjykimi e vëmendja e lexuesit adresohet drejt konteksteve të mirëfillta semiologjike të “leximit të parë” dhe të “rileximit në kohë”. Kjo nënkupton pikërisht marrëdhënien ndërvepruese midis leximit kontekstual me leximin mbikohor a ndërkohor.

Studimi, ndofta, më i bukur, më interesanti, më origjinali, më i frymëzuar dhe më dijesjellësi i këtij libri, sipas meje, është ai kushtuar poezisë së Migjenit, tek i cili unë gjeta përkritje të vetvetes, por dhe një tjetër sy, që ma ngopi njohjen dhe kureshtjen. Poeti shihet tanimë përtej klishesë së dikurshme të studimeve tona si një “ateist”; përkundrazi poezia e tij vjen e kushtëzuar dhe e lidhur së brendshmi me tekstet biblike-ungjillore: “në shkallën strukturore, në atë mitologjike dhe kulturologjike, në prozodi e metrikë, në tipologjinë e figurës, në nivelin e shembëlltyrës, motivit, tematologjisë, në leksik e idiomatikë, në të gjitha shkallët e ndërtekstorësisë, duke përfshirë atë të citimit me protokoll, si në shkrimin akademik”.

Sinani e thyen korracën e njëhershme aksiologjike ndaj poetit, e cila e pat paraqitur vetëm si zëdhënës të protestës dhe rebelimit, denoncues të varfërisë dhe mjerimit, frymëzues të revolucionit, kritikizmit dhe antikonformizmit, demaskuesit të fesë, klerit dhe monarkisë, gjer dhe si pararendës të realizmit socialist. Të tjera profile, hapësira e ngjyra bujtin në vetëdijen analitike të tij. Ndikimi i Niçes në konceptimin e Perëndisë është i pranishëm në veprën e Migjenit. Ai e bën të heshtë a ta vdesë Perëndinë, por pa e mbyllur në manastir, as si Niçja në muze. Ai ishte përkrahës i

Mbinjeriut, jo si pushtet politik absolut, por si strukturë mentale iluministe, që epohet ethshëm kah liria. Migjeni ishte një shkrimtar “outsider”, para së gjithash në raport me rrymën letrare franceskane dhe atë jezuite; ca më pak ai mund të ishte një “shpirt sllav që flet shqip” (Arshi Pipa). Poeti nuk ishte ateist, ai e identifikonte Jezusin jo aq si Mesia sesa “si i vetmi i krishterë që u kryqëzua në kryq”. Pra si misionar dhe i flijuar për njeriun, siç dhe poeti kërkonte ta ngrinte nivelin e vet në këtë rang e mision, domethënë në rangun e “Mbinjeriut mesianik” si një “fe” e re, dhe jo në rangun e një “Zoti klasik”.

Mittemat e poezisë migjeniane kanë bulbe të Biblës dhe ungjijve. Në këtë rrafsh sa të rrëshqitshëm aq dhe të vërtetueshëm (falë komparacionit), studiuesi realizon përjasje sfidante midis “Vargjeve të lira” dhe Shkrimeve të Shenjta, duke i kundruar ato në shkallë strukturore, konceptuale dhe të karakterit sinoptik, në atë të mitit, të subjektivitetit të autorit, të prozodisë dhe të metrikës; më tej të pragmatikës, të ndërtekstualitetit, në shkallën e motiveve, e gjedhes figurative, e një leksikoni gjuhësor. Duke u futur e gjithë poezia në këtë shoshë analitike, selektuese, disiplinore dhe sërenditëse, tanimë shtjellimi i Sinanit bëhet më konkret, kap bulbe referenciale mbushamendëse për çdo nyje, duke gjetur afëri dhe pikëtakime të vargjeve, figurave dhe ideve me konceptet dhe shembëlltyrat burimore biblike. Të gjitha këto pasohen me shpjegime dhe shëtitje nëpër literaturën e gjerë kritike e studimore,

Me shkrimin kushtuar raporteve midis Biblës (Great Code), si kulturë kozmike imperiale dhe letërsisë popullore shqiptare, si kulturë bazike etnopsikologjike, posaçërisht eposit të kreshnikëve, autori rreket të hedhë dritë në ngjashmëritë, lidhjet e pranëvëniet mes tyre, motivet dhe figurat, duke respektuar strukturat ngjizëse, kohore e hapësinore të njërës ndaj tjetrës. Fillimisht ai operon me tezat e më pas kalon në gjasa konkrete; vë re tre elementë ku mund të gjenden afëritë: “ringjallja, shenjtërimi i sakrificës dhe heroi me fuqi mbinjerëzore e një dobësi të fshehtë”. E gjitha kjo lëndë përqaset me sivëllezërit e arealit ballkanik, ecejaket më tutje në tatëpjetat e eposeve të njohura botërore, duke u kredhur edhe më tej në kohë, te zanafillat mitologjike, pagane e të parakrishtera. Lënda poetike e sjellë si përjasje me arealin biblik “Code of Codes” krijon ca dëshmi interesante, të cilat, edhe pse në fillesa, kërkojnë studime më të thelluara nga autori nesër, a nga të tjerë, për t’i hequr velin një pronësie rapsodike që i bën nder hershmërisë etnike të shqiptarëve.


Artikulli i plotë në:

<https://exlibris.al/josif-papagjoni-nga-religjioni-te.../>

https://exlibris.al/wp.../uploads/2024/07/EXLIBRIS_293.pdf

In memoriam

Për kryetarin historik të Akademisë së Shkencave prof. Aleks Buda: in memoriam



Figurë emblematike e akademizmit në Shqipëri; themelues i Akademisë së Shkencave dhe drejtues për tri dekada i saj; historian dhe etnolog; "i martuar" me Mesjetën dhe "i dashuruar" me arkeologjinë; ideator e frymëzues i projekteve më të rëndësishme shkencore të periudhës (corpora Academiae); njohës i thellë i të gjitha periudhave të mëdha të historisë kombëtare; promovues e mbrojtës kryesor i paradigmës shkencore të albanologjisë; përfaqësues dinjitoz i shkencës shqiptare në Botë; formues e riformues i disa brezave shkencëtarësh.

Sot, në 31-vjetorin e ndarjes nga jeta.